	3.49 Bulgaria Identifikon popujt që jetojnë në vendet e Evropës Jugore. Analizon shpërndarjen hapësinore të populisë, shpjegon dallimet në dendësi, në vendet e ndryshme të Evropës Jugore. Identifikon zonat turistike më të njohura në këtë rregjion dhe vlerëson ndikimin e turizmit në ekonominë e shteteve të Evropës Jugore.	1	Diskutimi dhe të nxënët në bashkëpunim •Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e drejtar) Mësimdhënie e drejtërie. Diskutimi dhe të nxënët në bashkëpunim •Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e drejtar) Mësimdhënie e drejtërie.	•Vlerësimi me gojë (të pyeturit, diskutimi, debati etj.); •Vlerësimi me anë të dëgjimit; •Vlerësimi përmes punës praktikë;
	3.50 Maqedonia 3.51 Serbia	1	Diskutimi dhe të nxënët në bashkëpunim •Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e drejtar) Mësimdhënie e drejtërie. Diskutimi dhe të nxënët në bashkëpunim •Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e drejtar) Mësimdhënie e drejtërie.	•Vlerësimi me gojë (të pyeturit, diskutimi, debati etj.); •Vlerësimi me anë të dëgjimit; •Vlerësimi përmes punës praktikë;
	3.52 Kracia dhe Malizi 3.53 Bosna dhe Hercegovina	1	Diskutimi dhe të nxënët në bashkëpunim •Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e drejtar) Mësimdhënie e drejtërie. Diskutimi dhe të nxënët në bashkëpunim •Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e drejtar) Mësimdhënie e drejtërie.	•Vlerësimi me gojë (të pyeturit, diskutimi, debati etj.); •Vlerësimi me anë të dëgjimit; •Vlerësimi përmes punës praktikë;
	3.54 Ushtime për TESTIM	1	Diskutimi dhe të nxënët në bashkëpunim •Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e drejtar) Mësimdhënie e drejtërie.	•Vlerësimi me shkrim;
	3.55 TESTIM VP2	1	Diskutimi dhe të nxënët në bashkëpunim •Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e drejtar) Mësimdhënie e drejtërie.	•Testimi - si ecuri e matjeve sipas një qëllimi të caktuar.

	Měsimdhěnie e drejtpěrdrejtě. Diskutimi dhe tě nxénit ně bashképunim •Měsimdhěnia me aně tě pytjeve (teknička e pytjeve drejtuar nxéněsve).
	Diskutimi dhe tě nxénit ně bashképunim •Měsimdhěnia me aně tě pytjeve (teknička e pytjeve drejtuar nxéněsve).
	Měsimdhěnie e drejtpěrdrejtě. Diskutimi dhe tě nxénit ně bashképunim •Měsimdhěnia me aně tě pytjeve (teknička e pytjeve drejtuar nxéněsve). Krahasim.

		pyetjeve nxënësve).	drejtuar
		• Testimi - si ecuri e matjeve sipas një qellimi té caktuar.	

PLANI DYMUJOR Prilli-maj-qershori

Fusha e kurrikulës: *Shoqëria dhe mjedisë*

Lënda mësimore: *Gjeografi*

Klasa: VII (e shtatë)

Rezultatet e të nxënënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtyllimit të temave

1. Kompetenca komunikim dhe të shprehur - Komunikues efektiv	I-1,2,3,4,5,6
2. Kompetenca të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik	II-1,3,4,5,6,8
3. Kompetenca të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm	III-1,3,5,6,8
4. Kompetenca përfjetë, punë dhe mjedis - Kontribuues produktiv	IV-1,4,5,6,7
5. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë	V-
6. Kompetenca qytetare - Qytetari i përgjegjishëm	VI-3,5,6

Rezultatet e të nxënënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtyllimit të temave

RNF: 2. Hulumton dukuri të proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mijdisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvajjet dhe ndërveprimet reciproke
1.3. Shpjeqon hapësiën e banimit dhe veprimit, shpërndarjen dhe lëvizjen natyrore te popullsisë, migrimet, strukturën, organizimin, zhvillimin dhe transformimin e vendbanimeve dhe të ekonomisë në nivel lokal, rajonal dhe global.
2.1. Përfundon burime të natyrshme kur prezanton dallimet në mënyrën e jetesës së njëzëve në kohë dhe hapësirë, duke pat paraçysht lëvizjet dhe zhvillimet e përgjithshme historike, shoqërore dhe natyrore.
2.2. Shpjeqon orientimin në hapësirë, pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, përbëjen e gjeosferës, veçoritë e elementeve natyrore dhe socio-gjeografike të mjedisit natyror e humar.

Konceptet:

1. Individu, grupet dhe marrëdhëniat shoqërore; 2. Proseset shoqërore dhe natyrore; 3. Normat, të drejtat dhe përgjegjësítë

Burimet: *Gjeografia 7, Flotore Pune 7, Ataset*

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënënit për temë mësimore	Njësitë mësimore	Koha e	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit
4. Europa Perëndimore	Nxënësi: Vlerëson rëndësinë e pozitës gjeografike të Europës Perëndimore dhe rolin e saj për Evropën në përgjithësi. Vlerëson se çfarë ishte roli i pozitës gjeografike në ngjarjet historike të Evropës Perëndimore. Aryseton rëndësinë e detit përfjetën dhe në luftën e pjerëzve me të.	5.56 Vleroritë shqëgjore-ekonomike të Evropës Perëndimore – Popullsia 5.57 Britania e Madhe	1	Mësimdhënie e drejtperdërtejë. Diskutimi dhe të nxënët në bashkëpunim. •Mësimdhënia me anë të pyetjeve teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve). Mësimdhënie e drejtperdërtejë. Diskutimi dhe të nxënët në bashkëpunim. •Mësimdhënia me anë të pyetjeve teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve).	•Vlerësimi me gjotë (të pyeturit, diskutimi, debati etj); •Vlerësimi përmes punës praktikë; me anë të dëgjimit; •Vlerësimi përmes punës praktikë;
	Vlerëson rëndësinë e Oqeanit dhe të rrymës së Golfit në klimë dhe në jetën e njërezeve. Identifikon malet më të njohura mollore, të reja, fushat, polderet dhe luginat lumore.	5.58 Ushtrime: Britania e Madhe 5.59 Franca	1	Diskutimi dhe të nxënët në bashkëpunim. Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve.	•Vlerësimi me gjotë (të pyeturit, diskutimi, debati etj); •Vlerësimi përmes punës praktikë;
	Aryseton rolin e grykave të lumenjive në formë të hinkës (estuareve) përfundrim. Vlerëson rëndësinë e shumë kanaleve që lidhin lumenjtë mes veti.		1	Mësimdhënie e drejtperdërtejë. Diskutimi dhe të nxënët në bashkëpunim. •Mësimdhënia me anë të pyetjeve teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve).	•Vlerësimi me gjotë (të pyeturit, diskutimi, debati etj); •Vlerësimi përmes punës praktikë;
	Identifikon pesë limanet më të njohura të Evropës Perëndimore. Analizon shtrirjen gjeografike dhe rëndësinë ekonomike të vendburimeve të qymyrit, naftës, gazit, hekurit dhe metaleve të tjera.	5.60 Prezantime: FRANCA dhe BRITANIA E MADHE 5.61 Monaco	1	Mësimdhënie që nxit të menduanit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve. Diskutimi dhe të nxënët në bashkëpunim. •Të mësuarit dhe të nxënët përmes mijeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit.	•Vlerësimi përmes punës praktikë; •Vlerësimi me gjotë (të pyeturit, diskutimi, debati etj); •Vlerësimi përmes punës praktikë;

	<i>Analizon aspekte tjera të ndërlidhura me pozitën e që i kanë mundësuar zhvillim ekonomik dhe turistik këtij regjioni.</i> <i>Identifikon popujt e Evropës Perëndimore sipas shteteve.</i> <i>Radhitë shtetet e Evropës Perëndimore sipas numrit të banorëve si dhe të ardhurave për kokë banori.</i>	5.62 Belgjika 5.63 Holanda	1 1	Diskutimi dhe të nxënët në bashkëpunim •Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve). Diskutimi dhe të nxënët në bashkëpunim •Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve).	•Vlerësimi me gojë (të pyeturit, diskutimi, debati etj.); •Vlerësimi me anë të dëgjimit; •Vlerësimi përmes punës praktikë;	me anë të dëgjimit; •Vlerësimi përmes punës praktikë;
	5.64 Luksemburgu 5.65 Irlanda	1 1	Mësimdhënie e drejtپerdrejtë. Diskutimi dhe të nxënët në bashkëpunim •Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve). Diskutimi dhe të nxënët në bashkëpunim •Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve).	•Vlerësimi me gojë (të pyeturit, diskutimi, debati etj.); •Vlerësimi me anë të dëgjimit; •Vlerësimi përmes punës praktikë;	•Vlerësimi me gojë (të pyeturit, diskutimi, debati etj.); •Vlerësimi me anë të dëgjimit; •Vlerësimi përmes punës praktikë;	me anë të dëgjimit; •Vlerësimi përmes punës praktikë;
	7.66 Vezoritë shqyrrore-ekonomike të Evropës Lindore	1	Mësimdhënie e drejtپerdrejtë. Diskutimi dhe të nxënët në bashkëpunim •Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve).	•Vlerësimi me gojë (të pyeturit, diskutimi, debati etj.); •Vlerësimi me anë të dëgjimit; •Vlerësimi përmes punës praktikë;	•Vlerësimi me gojë (të pyeturit, diskutimi, debati etj.); •Vlerësimi me anë të dëgjimit; •Vlerësimi përmes punës praktikë;	me anë të dëgjimit; •Vlerësimi përmes punës praktikë;
4. Evropa Lindore	-Dallion viset e tundrave, tajgave, stepave, shtrirjen geografike dhe rolin e tyre në ekonomi. -Arsyeton hapjen e kanaleve dhe rëndësinë e tyre ekonomike në pjesën evropiane. -Identifikon në hartë vendburimet e minraleve më të njohura në hapësirën e Bashkësive së Shteteve të Pavarura dhe rëndësinë e tyre ekonomike -Dallion viset e tundrave, tajgave, stepave, shtrirjen geografike dhe rolin e tyre në ekonomi.	7.67 Federata Ruse 7.68 Popullista dhe zhvillimi ekonomik	1 1	Diskutimi dhe të nxënët në bashkëpunim •Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve).	•Vlerësimi me gojë (të pyeturit, diskutimi, debati etj.); •Vlerësimi me anë të dëgjimit; •Vlerësimi përmes punës praktikë;	•Vlerësimi me gojë (të pyeturit, diskutimi, debati etj.); •Vlerësimi me anë të dëgjimit; •Vlerësimi përmes punës praktikë;

	-Arsyeton hapjen e kanaleve dhe rendësinë e tyre ekonomike në pjesën evropiane. -Identifikon në hartë vendburimet e mineralev me të njohura në hapësirën e Bashkësisë së Shteteve të Pavarur dhe rëndësinë e tyre ekonomike -Dallion popujt më të njohur në Evropën Lindore dhe Bashkësinë e Shteteve të Pavarura sipas përkatesisë etnike e jetare. -Identifikon në hartat e punës qytetit më të njohura dhe më të madha të Evropës Lindore dhe Bashkësisë së Shteteve të Pavarura. -Analizon shtetet sipas madhësës sipërqësore, populative, nivelit të arsimit, sistemit politik, urbanizimit dhe strukturës ekonomike të tyre. Identifikon në hartë shtetet e Evropës Lindore dhe sgrün Bashkësinë e Shteteve të Pavarura. -Analizon deri ku shtrihet Europa Lindore dhe deri ku Bashkësia e Shteteve të Pavarura si dhe sgrün pozitën transitive socio-ekonomike dhe politike tektyre shtetave. -Dallion tërësitë e mëdha relievore: Ultësirën e Evropës Lindore, Ultësirën Perëndimore të Sibrit, të Turanit, vargmalet e Karpatave, Kaukazit të Madh, të Vogël, Malet e Azisë Qendrore deri te lumi Amur dhe Gadiashilli Kampatka.	1	Diskutimi i përmes punës praktikë; •Mësimdhënia me anë të pyetjeve drejtuar nxënësve).	Diskutimi i përmes punës praktikë; •Mësimdhënia me anë të pyetjeve drejtuar nxënësve).	nxënës në me anë të dëgjimit; •Vlerësimi përmes punës praktikë;
	7.69 Ushtrime: RUSIA	1	Mësimdhënie që nxit të menduanit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve. Diskutimi i përmes punës praktikë;	Mësimdhënie që nxit të menduanit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve. Diskutimi i përmes punës praktikë;	•Vlerësimi përmes punës praktikë; •Mësimdhënia me shkrimit; •Vlerësimi me gojë (të pyeturit, diskutimi, debati etj.); •Vlerësimi me anë të dëgjimit; •Vlerësimi përmes punës praktikë;
	7.70 Ukraina	1	Mësimdhënie e drjetpërdrejtë. Diskutimi i përmes punës praktikë;	Mësimdhënie e drjetpërdrejtë. Diskutimi i përmes punës praktikë;	•Vlerësimi me gojë (të pyeturit, diskutimi, debati etj.); •Vlerësimi me anë të dëgjimit; •Vlerësimi përmes punës praktikë;
	7.71 Bjellorusia, Moldavia	1	Mësimdhënie e drjetpërdrejtë. Diskutimi i përmes punës praktikë;	Mësimdhënie e drjetpërdrejtë. Diskutimi i përmes punës praktikë;	•Vlerësimi me gojë (të pyeturit, diskutimi, debati etj.); •Vlerësimi me anë të dëgjimit; •Vlerësimi përmes punës praktikë;
	7.72 Ushtrime për TESTIM	1	Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve). Krahasim.	Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve). Krahasim.	•Vlerësimi me shkrimit;
	7.73 Testim VP2	1	•Testimi - si ecuri e matjeve sipas një qëllimi të caktuar.	•Testimi - si ecuri e matjeve sipas një qëllimi të caktuar.	•Testimi - si ecuri e matjeve sipas një qëllimi të caktuar.
	7.74 Përfundim i sutsesisit	1			

	-identifikon, rrijedhjet, drejtimin e rrijedhjes dhe veçoritë specifike të lumenjve.
	-identifikon, emërtón ahe të krahason liqenet më të njohura të Evropës Lindore dhe Bushkësisë së Shteteve të Pavarura sipas veçorive të tyre.
	-identifikon në hartë shtrirjen e shkretëtirave, emrat e tyre dhe të arsyetojë praninë e tyre.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:2

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi / Lënda: Gjeografi Shkalla e kurrikulës: 3 / Klasa: 7

Tema: Pozita, kufijtë dhe madhësia e Evropës	Rezultati i të nxenit të temës: Përcakton kriteret për ndarjen e regjoneve gjeografike.	
--	---	--

Rezultatet e të nxenit për kompetencat kryesore të shkallës: I-1,2,4,6; II-1; III-3,8.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : RNF: 1. Njeh rolin e individit, strukturën e grupeve shoqërore, mënyrat e pjesëmarrjes dhe përfshirjes në to. 1.1; 1.2.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Regionet, kuptimet dhe ndarja

Fjalët kyçe: Region gjeografik, elementet natyrore, elemente shoqërore, ishuj...

Rezultati/et e të nxenit për orë mësimore:

- Shpjegon kuptimin e regionit gjeografik si tërësi e individualizuar gjeografike;
- Identifikon elementet natyrore, mbi bazën e të cilëve ndahen regionet gjeografike në hartën e botës.

Kriteret e suksesit: (formohen në klasë nga mësimdhënësi së bashku me nxënësit ose sillen të gatshme që të shfrytëzohet koha)

- Identifikon të paktën pesë regjione të veçanta gjeografike botërore;
- Përvizuan një region të njohur mbi bazën e elementeve (identifikon të paktën pesë element).

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7, Fletore Pune.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore:

PËRSHKRIMI I METODOLOGISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Diskutim (shpjegim i hartës).



Mësimdhënësi fillon orën duke paraqitur në tabelë një hartë (hartë në projektor...) në të cilën janë ndarë/përvizuan regjionet e caktuara. U drejtohen me pyetje nxënësve:

- Pse na nevojitet ndarja regionale?
- Cili është dallimi në mes Saharës dhe Amazonës?
- Cilat element i specifikojnë këto dy regjione?

Komentet (të shkurta) shënohen në tabelë si fjalë kyçe të cilave u referohemi gjatë procesit të nxenies, kryesisht elemente natyrore-gjeografike (bimësia, klima, popullsia, ujërat, shkretëtirë...), shoqëror, politik...

Kështu mësimdhënësi hap diskutimin duke u ndërlidhur me njësinë mësimore që do zhvillohet.

Mësimdhënësi së bashku me nxënësit paraqesin kriteret në tabelë ose i sjell të gatshme dhe i shënon që nxënësit ti kenë përparrë të përvizuan.



Pjesa e dytë: Pjetje dhe komente (punë individuale)

Arsintari udhëzon nxënësit që të lexojnë tekstin në heshtje dhe individualisht. Deri sa nxënësit lexojnë, arsimtari shënon në tabelë disa pyetje ku nxënësit pas leximit i plotësojnë me ato fragmente që mendojnë se e plotësojnë pyetjen e parashtruar.

(në klasë, arsimtari paraqet disa lloje të hartave dhe globin, fotografi nga revistat... edhe projektor nëse e ka në dispozicion)

Pjetje	Komente (fragmente nga teksti)
1. Cilët janë elementet natyror-gjeografike që mund të përcaktohet një region?	relievi, klima, uji, tokat, bota bimore dhe shtazore
2. Cilët janë elementet shoqërore që mund të përcaktohet një region?	Ekonomia, kultura, popullsia...
3. Çka nënkuptioni me regjione gjeografike?	Regionet janë tërësi të individualizuar natyrore ku spikatet në mënyrë të veçantë një apo disa elemente natyrore të cilat përcaktojnë fisionominë e peizazhit.
4. Përmendni disa regjione të veçanta në botë, dhe identifikoni ato në atlastet e punës?	Antarktida, Sahara, pyjet e Amazonës...
5. Identifikoni regjionet anekumenike në hartën e botës (3-4 nxënës vullnetar).	Sahara, viset polare, zonat shkretinore...
6. DETYRË: Identifikoni nga një region gjeografik duke u bazuar në kriterin e reliefit (ultësirë, region malor, rrafsh lartë...)	(Bisedo me nxënës gjatë punës së tyre me hartë)

Pjesa e tretë: Diskutim i hapur (dy grupe të mëdha).

Mësimdhënesi kërkon nga nxënësit që të argumentojnë pse janë për, ose **kundër** çështjes duke i shënuar në organizuesin grafik. Mendimet do të shkëmbohen në dyshe e në katërshe. Klasa do të pozicionohet në dy grupe, ku nxënësit do të përcaktojnë pozicionin e tyre. Bëhet një raportim para klasës për arsyet që janë zgjedhur pro ose kundër çështjes.

Për çdo paraqitje caktohet një kufi kohor prej një minute. Gjatë kohës që dy grupet raportojnë arsyet e tyre, nxënësit mund të ndryshojnë pozicion dhe të shkojnë në grupin që ka arsyet më bindëse.

A mundet që regjionet gjeografike të ndryshohen më vonë si pasojë e ndonjë dukurie?

PO JO

Argumentet PRO ose KUNDËR nxënësit i mbështhesin duke shpjeguar me hartë dhe argumentuar me shembuj, nëse ka.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënesi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënesi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Plotëso fletore pune.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Përkruaj rrjedhën e orës sipas klasave. Prajet përparësitetë dhe mangësitetë për klasat gjatë zhvillimit të orës ose ndonjë specifik të veçantë.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:3

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedis** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: **Pozita, kufijtë dhe madhësia e Evropës**

Rezultati i të nxënëtit të temës: **Përcakton kufijtë e Evropës dhe i tregon rolin e pozitës së saj.**

Rezultatet e të nxënëtit për kompetencat kryesore të shkallës: **I-1,2,3,4,6; II-4; III-3,5,8.**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : **RNF: 1. Njeh rolin e individit, strukturën e grupeve shoqërore, mënyrat e pjesëmarrjes dhe përfshirjes në to. 1.1; 1.2.**

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Emri, pozita, kufijtë dhe madhësia

Fjalët kyçe: Kontinenti i Evropës, "Botë e vjetër", "Ereb", Deti Mesdhe

Rezultati/et e të nxënëtit për orë mësimore:

- Identifikon Evropën si tërësi regionale, duke përshkuar kufijtë e saj natyror me hartë e Evropës (atlas);
- Identifikon detet, ngushticat detare, siujdhesat dhe ujdhesat e mëdha në Evropë dhe shpjegon pozitën e tyre ne hartën e Evropës.

Kriteret e suksesit (formohen në klasë së bashku me nxënës):

- Përshkruan kufijtë natyror të Evropës rrëth e qark;
- Tregon në hartë/atlas ku gjinden detet, gadishujt, ishujt kryesor;

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7 Fletore Punkte.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore: Histori

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: "Asociacion"

Arsimtari fillon orën duke formuar një asociacion në tabelë si vegës që nxënësit të gjejnë njësinë që do zhvillohet dhe të pyesin për rubrikat se çka asocojnë.

A	B	C	D
"Gadishull"	"Perëndimi i Diellit"	"ereb"	Brexit

EVROPA

Mësimdhënësi pasi që zbulohet asociacioni pyet nxënësit për fjalët kyçe:

Pse "gadishull"

"perëndimi i Diellit"

"ereb"

Brexit.

Mësimdhënësi pasi që zbulohet asociacioni pyet nxënësit për fjalët kyçe:

Çka asocojnë me Evropën?

Çka kishit shtuar ose si e kishit formuar ju?

Kështu nxënësit njihen me njësinë e re që do zhvillohet pasi që zbulohet asociacioni.


Mësimdhënësi së bashku me nxënësit paraqesin kriteret në tabelë ose i sjell të gatshme dhe i shënon që nxënësit ti kenë përpara të përshkruara.

Pjesa e dytë: Harta e të pyeturit (punë individuale).

Harta e të pyeturit mund të përdoret me mjaft sukses në këtë fazë të kësaj teme mësimore. Me këtë teknikë duhet të synohet nxitja e të menduarit dhe e interesit të nxënësve për çështjet që do të shtullohen.

Mësimdhënësi, pasi shkruan në tabelë temën dhe çështjet kryesore, vizaton hartën e të pyeturit të plotësuar

me pyetje që nxënësit gjatë leximit ti identifikojnë përgjigjet dhe pastaj në formë të organizuar dhe vullnetare ta plotësojnë tabelën dhe të përshkruhet në fletoren për detyrat në klasë.



ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:4

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedisi** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Specifikat popullatave, kulturore dhe politiko -administrative të Evropës

Rezultati i të nxënët të temës: *Dallon popujt, kulturat dhe grupet më të mëdha të popujve në Evropë, në regjone dhe në shtete.*

Rezultatet e të nxënët për kompetencat kryesore të shkallës: **I-1,2,4,6; II-1; III-3,8.**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : **RNF: 1. Njeh rolin e individit, strukturën e grupeve shoqërore, mënyrat e pjesëmarrjes dhe përfshirjes në to. 1.1; 1.2.**

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Popullsia dhe veçoritë e saj

Fjalët kyçe: "Djep i civilizimit", revolucioni industrial, migrimet, popullsia gjermane, popullsia sllave, romanët, shqiptarët, grekët, religionet

Rezultati/et e të nxënët për orë mësimore:

1. Shpjegon në formë kronologjike fazat e banimit (popullimit) në kontinentin e Evropës;
2. Identifikon grupet kryesore të popujve në Evropë dhe tregon me hartë shtrirjen e tyre.
3. Vlerëson shkallën e lartë të urbanizimit të popullsisë në kontinentin Evropian.

Kriteret e suksesis (formohen në klasë së bashku me nxënës):

1. Tregon popujt më të mëdhenj të Evropës;
2. Tregon popujt më të vjetër në Evropë.
3. Identifikon shtetet Evropiane sipas religionit (dominimit të besimit).
4. Identifikon në hartë të paktën pesë qendra të banimit me mbi 1 milion banorë.


Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore: HISTORI

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Diskutim dhe përshkrim i hartës politike të Evropës.

Mësimdhënësi paraqet një hartë politike të Evropës, ku kërkon nga nxënësit të identifikojnë së paku nga pesë shtete (territore sovrane) sipas ngjyrave përkatëse dhe të tregojnë se cilët popuj dhe grupe të popujve jetojnë në ato shtete. Si ndihmë, formon një tabelë ku shkruan grupet e popujve dhe kërkon që nxënësit ti plotësojnë sipas njohurive paraprake që kanë por popullsinë në Evropë.



Popullsia gjermane	Popullsia sllave	Popullsia romane	Të tjere.
Gjermania	Rusia	Franca	Shqipëria
Austria	Serbia	Italia	Kosova
Holanda...	Kroacia...	Spanja...	Greqia...

Pjesa e dytë: Grupet e ekspertëve (punë në grupe).

Nxënësit ndahen në pesë grupe. Mësuesi i 'u jep secilit grup nga një detyrë (pyetje) të caktuar dhe punojnë duke u bërë ekspertë të çështjes për të cilën janë caktuar. Mësimi ndahet në pesë paragrafë duke i 'u referuar pyetjeve përkatëse.

Grupi 1

- Në të kaluarën e lashtë, cila pjesë e Evropës filloj të bëhet djepi i civilizimit dhe kulturës Evropiane?
- Gjatë mijëvjeçarit të dytë cila popullsi ishte vendosur në Evropë?
- Tregoni fazat e popullimit të Evropës nga popullsia indoevropiane?

Grupi 2

- Renditni kontinentet sipas popullsisë nga më i madhi deri tek më i vogli?
- Sa ka zgjatur periudha e tranzicionit demografik në kontinentin e Evropës?
- Në cilin shekull kishte filluar Revolucioni Industrial në Evropë

Grupi 3

- Identifikoni shtetet me dendësinë më të madhe të popullsisë në Evropë?
- Tregoni shkaqet e shtimit natyror të ngadalshëm të popullsisë?
- Në cilën pjesë të Evropës norma e shtimit natyror të popullsisë është më e ulët?

Grupi 4

- Rreth sa popuj jetojnë sot në Evropë?
- Identifikoni nga pesë popuj sipas grupeve: Sllave, gjermane dhe romane?
- Identifikoni popujt që bëjnë pjesë në tri grupet e mëdha dhe tregoni cilët janë popujt më të vjetër në Evropë?

Grupi 5

- Identifikoni nga pesë shtete sipas dominimit të besimeve (krishtere katolike, ortodokse dhe besimit islam)?
- Cilat ishin shkaqet e emigrimeve të mëdha në Evropë?
- Sa është shkalla e urbanizmit në Evropë?

Pjesa "me rëndësi të dihet" të lexohet nga të gjithë dhe reflektojnë gjatë shpjegimit.


Përfaqësuesit e grupeve u përgjigjen pyetjeve dhe debatojnë lidhur me to.

Pjesa e tretë: Reflektim i punës nga grupet e ekspertëve.

Në pjesën e tretë, arsimtari së bashku me nxënës në formën e diskutimit, shpjegojnë hartën e shtrirjes së gjuhëve, besimeve dhe popujve sipas grupeve të punës, duke i identifikuar edhe shtetet.

Detyre: Identifikoni nga tre shtete ku dominojnë popujt sllavë, gjerman, roman dhe popujt tjerë. Për shenjim vendosni letra ngjitëse me ngjyra.

Detyrat e punuara i dorëzohen mësimdhënësit ku nxënësit bashkëngjisin edhe emrat e tyre. Mësimdhënësi i vlerëson dhe u dorëzon që ti mbani në dosje (njëri nga ta).



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

DETÝRAT DHE PUNA E PAVARUR

☞ Plotëso

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:5

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedisi** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Specifikat populatave, kulturore dhe politiko -administrative të Evropës

Rezultati i të nxënësit të temës: *Analizon mënyrën e organizimit shtetëror unitar, federal, republikan dhe mbretëritë.*

Rezultatet e të nxënësit për kompetencat kryesore të shkallës: I-1,2,4,6; II-1; III-3,8.

Rezultatet e fushës së kurrikulës: RNF: 1. Njeh rolin e individit, strukturën e grupeve shoqërore, mënyrat e pjesëmarrjes dhe përfshirjes në to. 1.1; 1.2.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Rregullimi shtetëror i vendeve evropiane

Fjalët kyçë: Republika, monarki (mbretëri), shtete federale

Rezultati/et e të nxënësit për orë mësimore:

- Identifikon në hartën e punës shtetet Evropiane sipas madhësisë dhe organizimit shtetëror të tyre dhe kategorizon ato në grupe.

Kriteret e suksesisit (formohen në klasë së bashku me nxënës):

- Identifikon nga pesë shtetet e mëdha, të mesme dhe të vogla të Evropës;
- Identifikon nga tre shtetet mbretëri, republika, shtete federale... për nga rregullimi/organizimi shtetëror.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore: HISTORI

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Vërejtje: Me që njësia si materialështë e shkurtër, mësimdhënësi planifikon orën që të bëhet edhe një formë përsëritje duke u ndërlidhur edhe me njësitet që janë zhvilluar.

Pjesa e parë: Përsëritje e njësisë së kaluar dhe ndërlidhje me njësinë e re.

Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që të përsëritet njësia e kaluar në formën e diskutimit. Ai u parashton pyetje për mësimin e kaluar.

Çfarë pozite gjeografike ka Evropa?


Cilët janë popujt më të mëdhenj në Evropë?

...

Gjatë diskutimit, mësimdhënësi i njofton nxënësit me njësinë e re e cila do të zhvillohet **"Rregullimi shtetëror i vendeve evropiane"** duke kërkuar nga ata që të identifikojnë në hartën politike shtetet e mëdha, të vogla dhe të mesme. Si ndihmë, në dërrasën e zezë formon tabelë të kategorizuar sipas pikave që kërkohen.

Të mëdha	Të vogla	Federale	Mbretëri
Suedia	Lihtenstajni	Zvicra	M. e Bashkuar
Ukraina	Monako	Belgjika	Spanja
Rusia...	Vatikani...	Rusia...	Holanda...

Republikat: Franca, Shqipëria, Italia...



Pjesa e dytë: Punë individuale (pyetje dhe komente).

Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që të lexojnë tekstin individualisht "Rregullimi shtetëror i vendeve evropiane" dhe në heshtje. Gjatë kohës që nxënësit lexojnë, mësimdhënësi shënon disa pyetje në tabelë.

Pasi të lexohet teksti, nxënësit, në formë vullnetare, plotësojnë me përgjigje tabelën. Mësimdhënësi miraton përgjigjet nëse janë të sakta.

Pyetje	Komente (fragmente nga teksti)
1. Sa shtete ka kontinenti Evropian?	
2. Çka paraqet sistemi republikan?	
3. Çka paraqet sistemi monark?	
4. Cilat vende kanë sistem mbretëror?	
5. Në cilin grup të shteteve bën pjesë Kosova sipas formës së organizimit të pushtetit?	
6. Cilat janë disa karakteristika për sistemin republikan të organizimit të shtetit?	

Pjesa e tretë: Pjesa e tretë të përmblidhen dy njësítë e fundit (punë në dyshe).

Detyrë:


Mësimdhënësi i pajis nxënësit me nga një fletë A4 në të cilën është paraqitur harta memece e Evropës. Nxënësit duhet të plotësojnë detet, shtetet, oqeanin dhe pikat kyçë që janë si kufi natyror i Evropës ndaj kontinenteve tjera me anën e letrave ngjitëse ose ngjyra.

Shtetet: *Portugalia, Moldavia, Islanda, Sllovakia dhe Lituania.*

Detet: *Marmara, Jon, Baltik, Barec dhe Azov.*

Kanali: *La Mansh, Ng. e Gjibraltarit, ngushtica Kategat, Otranto.*

Identifiko: *Një mbretëri, një shtet federal, një republikë dhe një shtet të vogël.*



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

DETÝRAT DHE PUNA E PAVARUR

Plotëso fletore pune si detyrë shtëpie. **Pyetja numër 2 deri te 12.**

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Përshkruaj rrjedhën e orës sipas klasave. Paraqit përparrësitetë dhe mangësitë për klasat gjatë zhvillimit të orës ose ndonjë specifikë të veçantë.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:6

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi / Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 / Klasa: 7

Tema: Aspektet e përgjithshme fiziko-gjeografike të Evropës	Rezultati i të nxenit të temës: Identifikon njësitë kryesore morfolologjike (gadishujt dhe ishujt më të njojur te Evropës, sistemet malore- vargmalet, malet e vjetra, ultësirat, fushat dhe luginat lumore më të njoitura).
---	--

Rezultatet e të nxenit për kompetencat kryesore të shkallës: I-1,2,4,6; II-1; III-3,8.

Rezultatet e fushës së kurrikulës: RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvorjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.1; 2.2.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përthyeshmëria e bregdetit

Fjalët kyçë: Gadishuj, bregdet, fjorde, ishull, kepe, gjire

Rezultati/et e të nxenit për orë mësimore:

1. Përshkruan format bregdetare të Evropës dhe identifikon ato sipas regionit të caktuar në hartë.

Kriteret e suksesit (formohen në klasë së bashku me nxënës):

1. Identifikon katër gadishujt kryesor (më të mëdhenj) të Evropës;
2. Identifikon me hartë të paktën pesë ishujt më të mëdhenj të Evropës;
3. Përshkruan 4 karakteristika të një fjordi;
4. Identifikon tre shtetet me përthyeshmérinë më të madhe bregdetare.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore:

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXENËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Diskutim duke analizuar hartën (punë individuale).

Mësimdhënësi para nxënësve paraqet hartën e Evropës dhe të kontinenteve tjera. Ai u drejtohet me pyetjen:

Cili nga kontinentet ka vijën bregdetare më të përthyer?


Cila vijë bregdetare paraqet më shumë forma?

Cilat forma janë të njoitura për ju?

A mundeni të më tregoni se në cilën pjesë të Evropës janë paraqitur fjordet?

Komentet më të sakta, shënohen në tabelë dhe diskutohet në detaje.

Mësimdhënësi së bashku me nxënësit paraqesin kriteret në tabelë ose i sjell të gatshme dhe i shënon që nxënësit ti kenë përpara të përshkruara.



Pjesa e dytë: Lexim i drejtuar (punë individuale).

Mësimdhënësi drejton nxënësit të lexojnë paragrafin e parë, individualisht. Kur nxënësit ta përfundojnë leximin e këtij paragrafi mbyllin tekstin.

- Pas këtij leximi, nxënësve u shtrohen pyetjet varësisht nga natyra e përbajtjes:

Ç 'kuptoni me përthyeshmëri bregdetare?

Nga cilat ujëra (oqean, dete...) laget Evropa?

Cilët janë katër gadishujt më të mëdhenj të Evropës?

...

- Për dallim nga DRTA që jemi mësuar deri më sot, mundeni që mendimet/komentet më të logjikshme të shënohen në tabelë (një koment përbledhës).

- Hapa të njëjtë merren edhe tek leximi i pjesës 2, 3... Para leximit të fundit shtohet edhe pyetja:

Çfarë mendoni, a është bregdeti Evropian më i përthyeri ndër kontinentet tjera?

...


Pjesa e tretë: Të nxënët (përbledhja e mësimit) bëhet sipas duke performuar në role. Mësimdhënësi ndan nxënësit në grupe me nga 3 pjesëtar/nxënës. Pyetjet (maksimumi 5 pyetje) mund të formohen vetë ose të merren nga fletore pune.

A-Intervistuesi

B-Shënuesi

C-Personi që intervistohet

Intervistuesi formon 4 pyetje (përdor edhe Fletoren e punës) të cilat ia drejton personit që do intervistohet (nxënësit C). Deri sa këta të dy kryenin aktin e tyre, nxënësi B nxjerr shënime në një fletë dhe i dorëzon tek arsimtari si detyrë e grupit në bashkëpunim.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Plotëso

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:7

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedis** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Aspektet e përgjithshme fiziko-gjeografike të Evropës

Rezultati i të nxenit të temës: *Identifikon njësit kryesore morfolologjike (gadishujt dhe ishujt më të njohur te Evropës, sistemet malore- vargmalet, malet e vjetra, ultësirat, fushat dhe luginat lumore më të njohura).*

Rezultatet e të nxenit për kompetencat kryesore të shkallës: *I-1,2,4,6; II-1; III-3,8.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës: *RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.1; 2.2.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Veçoritë e reliefit të Evropës

Fjalët kyçe: Sistemet malore, Ultësira e Evropës Lindore, Ultësirës Gjermano-Polake, malet e reja dhe të vjetra.

Rezultati/et e të nxenit për orë mësimore:

Sqarim: Rezultati/et e të nxenit për orë mësimore nuk paraqiten, nëse të njëjtat janë përfshirë te "Rezultatet e të nxenit të temës". Kjo bëhet me arsyen që të mos përsëriten/riplëshkruhen dhe të ngarkohet planifikimi. Nëse mësimdhënësi mendon që i duhen edhe rezultate shtesë për të specifikuar aktivitetin dhe punën e nxënësve gjatë orës, atëherë ai paraqet "Rezultatet e të nxenit për orë mësimore".

1. **Shpjegon me hartë format kryesore të reliefit të Evropës dhe identifikon ato sipas regjioneve gjeografike.**

Sqarim: Kriteret duhet të përpilohen së bashku me nxënësit në klasë. Mësimdhënësi mund t'i përpilojë edhe në shtëpi dhe t'i sjellë të gatshme atëherë kur njësia është e gjatë dhe dëshiron të kursejë kohën. Kriteret duhet t'i shërbejnë rezultateve të orës mësimore.

Shembull:

Kriteret e suksesit (formohen në klasë së bashku me nxënës):

2. Përshkruan ultësirën nga Evropa Perëndimore drejt maleve Urale;
3. Identifikon sistemet malore të Evropës;
4. Tregon tri dallimet në mes maleve të reja dhe të vjetra.
5. Identifikon majën më të lartë në Evropë dhe majën më të lartë në Evropën Perëndimore.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore:

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: "Asociacion"

Arsimtari formon një asociacion në tabelë si vegës që nxenësit të gjejnë njësinë që do zhvillohet dhe të pyesin për rubrikat se çka asocojnë.

A	B	C	D
Sipërfaqe	Modelim	malet	ultësirat
RELIEVI			

Mësimdhënësi pasi që zbulohet asociacioni pyet nxenësit përfjälët kyçe:

Pse sipërfaqe, modelim, malet (përmendni disa male të Evropës), ultësirat (përmendni disa ultësira të Evropës)? Çka asocojnë me reliefin?


Kështu nxenësit njihen me njësinë e re që do zhvillohet pasi që zbulohet asociacioni.

Pjesa e dytë: Klaster "pema e mendimeve".

Mësimdhënësi udhëzon nxenësit të lexojnë pjesën (tekstin) e njësisë mësimore që do të zhvillohet. Pasi që lexohet, në tabelë formohet KLASTERI, dhe në qendër të tabelës së zezë shënohet (Relievi i Evropës) ku nxenësit formojnë degët me anën e informacionit që kuptojnë nga leximi i pjesës. Informacioni i shënuar përcillet me eksplikim me hartë.

Mësimdhënësi luan rolin e "arbitrit" duke cilësuar njohuritë e shprehura si të përshtatshme ose të pa- përshtatshme për njësinë. Puna që zhvillohet në tabelë të përshkruhet edhe në fletoret e klasës.

Nxenësit aktivizohen vullnetarisht ose i angazhon mësimdhënësi.



Pjesa e tretë: Puna me fletoren e punës (punë individuale).

Plotëso fletore pune së bashku me mësimdhënësin si ndihmës (detyrat 14-22).

P.sh. Detyrë:

Duke ditur pikën më të lartë dhe më të ulët të kontinentit evropian, llogarit dallimin hispometrik ndërmjet tyre?

Së pari identifiko elementet në hartë dhe pastaj realizo detyrën.

- Maja më e lartë e Evropës është Elbrusi me 5.641 m
 - Maja më e ulët ndodhet në depresionin e Liqenit Kaspik ku toka është 28 m nën nivelin e detit botëror.
- Puna të zhvillohet individualisht në klasë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

DETÝRAT DHE PUNA E PAVARUR

Plotëso:

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Përshkruaj rrjedhën e orës sipas klasave. Paraqit përparrësitë dhe mangësitetë për klasat gjatë zhvillimit të orës ose ndonjë specifik të veçantë.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:8

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedis** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Aspektet e përgjithshme fiziko-gjeografike të Evropës	Rezultati i të nxënëtit të temës: Dallon tipat kryesore klimatike që dominojnë në Evropë.
---	---

Rezultatet e të nxënëtit për kompetencat kryesore të shkallës: I-1,2,4,6; II-1; III-3,8

Rezultatet e fushës së kurrikulës: RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvorjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.1; 2.2.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Klima e Evropës: faktorët, karakteristikat dhe tipat e klimës

Fjalët kyçë: Klima kontinentale, klima mesdhetare, klima atlantike, gradienti termik

Rezultati/et e të nxënëtit për orë mësimore:

1. Shpjegon llojet e klimës dhe shtrirjen e tyre në aspektin horizontal dhe vertikal në kontinentin Evropian.
2. Shpjegon rolin e faktorëve që kushtëzojnë llojulloshmérinë klimatike në kontinentin e Evropës.

Kriteret e suksesit (formohen në klasë së bashku me nxënës):

1. Dallon llojet e klimës dhe shtrirjen e tyre në Evropë;
2. Shpjegon procesin e gradientit termik;
3. Tregon faktorët kryesor që ndikojnë në klimën e Evropës.
4. Dallon klimën mesdhetare nga ajo kontinentale.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore:

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Mësimdhënësi në tabelë shkruan: Evropa, reshjet, temperatura e ajrit, erërat, presioni atmosferik, rrezatimi diellor... pasi që i shkruan këto fjalë në tabelë, ai i 'u drejtohet nxënësve se si do i kishit përbledhur të gjitha këto me pak fjalë?

Biseda hapet dhe komentet shënohen në tabelë. Kështu nxënësit duhet të zbulojnë vetë njësinë që do zhvillohet – KLIMA E EVROPËS

Pjesa e dytë: Mësimdhënësi drejton nxënësit të lexojnë paragraft i parë, individualisht. Kur nxënësit ta përfundojnë leximin e këtij paragrafi mbyllin tekstin.

- Pas këtij leximi, nxënësve u shtrohen pyetjet varësisht nga natyra e përbajtjes:

-Cilët janë faktorët kryesorë të cilët ndikojnë në klimën e Evropës?


-Çfarë klime mbizotëron në vendin tonë?

-Cili është roli i Rrymës së Golfit për Evropën?

- Për dallim nga DRTA që jemi mësuar deri më sot, mundeni që mendimet/komentet më të logjikshme të shënohen në tabelë (një koment përbledhës) dhe ti përdorni si referencë gjatë zhvillimit.

- Hapa të njëjtë merren edhe tek leximi i pjesës 2, 3... etj. Para leximit të fundit shtohet edhe pyetja: Çfarë mendoni, cili brez klimatik është më i përshtatshëm dhe ku gjendet (tregoni me atlas ose hartë)?

Pjesa e tretë: Në çdo hapësirë të dhënë në formë të katërkëndëshit shëno tipin e klimës duke i lidhur ato me vëçoritë e tyre dhe në cilat pjesë të Evropës dominojnë.




Mjegullat e shpeshta dhe reshjet e shumta;
Verërat e freskëta dhe dimrat e butë

Verërat e gjata të mxehta e të thata
Dimrat e shkurtë, të butë dhe të lagësht

Verërat e mxehta, dimrat e ftohtë,
Reshje të pakëta

Verërat e shkurta dhe të freshkëta
Dimrat e gjatë dhe me borë

Dimrat e gjatë dhe të ftohtë
Verërat e shkurta, të freskëta, me pak reshje



Detyre: Tregoni elementet dalluese të klimës kontinentale dhe asaj mesdhetare.

Klima kontinentale

Klima mesdhetare

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

DETÝRAT DHE PUNA E PAVARUR

Plotëso: Detyra 26-27 për detyrë shtëpie në Fletore Pune.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:9

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedis** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Aspektet e përgjithshme fiziko-gjeografike të Evropës

Rezultati i të nxënët të temës: *Analizon përhapjen e lumenjve dhe të liqeneve ne kontinentin e Evropës.*

Rezultatet e të nxënët për kompetencat kryesore të shkallës: I-1,2,4,6; II-1; III-3,8.

Rezultatet e fushës së kurrikulës: *RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvorajet dhe ndërveprimet reciproke; 2.2.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Hidrografia e Evropës - lumenjtë dhe liqenet

Fjalët kyse: Lumenjtë e Evropës, liqenet, pellgu i Oqeanit Atlantik, pellgu i detit Mesdhe, Detit të Zi, Kaspikut.

Rezultati/et e të nxënët për orë mësimore:

1. Identifikon ujëmbledhësit dhe tregoni se cilët lumenj evropianë derdhen në atë ujëmbledhës;
2. Vlerëson rolin e klimës dhe reliefit në natyrën dhe sasinë e ujërave rrjedhëse në Evropë;
3. Identifikon liqenet kryesorë të Evropës dhe kategorizon ato për nga mënyra e krijimit.

Kriteret e suksesit (formohen në klasë së bashku me nxënës):

1. Përshkruan pesë ujëmbledhës në hartë.
2. Identifikon pesë lumenjtë më të mëdhenj të Evropës.
3. Identifikon liqenet më të mëdha në Evropë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore:

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Stuhi mendimesh (diskutim).

Mësimdhënësi fillon orën e mësimit me pyetje. Për të ngallur diskutim në klasë për temën mësimore, parashtron pyetje me përgjigje të shumta:

Cilat janë lumenjtë që ju i njihni në Kosovë?

Cilët lumenj të Evropës njihni?

Përdorni hartën dhe tregoni cilët liqene po i identifikoni në Evropë.

Çka paraqet HIDROGRAFIA?

Si paraqiten elementet hidrografike në hartë (diskutoni)?

Komentet shkurtimisht përshkruhen në tabelë dhe diskutohen së bashku me mësimdhënësin (2 ose 3).

Pjesa e dytë: Grupet e ekspertëve (punë në grupe).

Nxënësit ndahen ne pese grupe, ku secili nxënës ka një numër 1,2,3,4

Pas nxënësít kanë përcaktuar numrat bashkohen njëhat bashkë, dyshat bashkë, treshat bashkë, katrat bashkë, pesat bashkë dhe kështu me radhë...

Mësuesi iu jep secilit grup nga një detyrë të caktuar dhe punojnë duke u bërë ekspertë të çështjes për të cilën janë caktuar

Grupi 1

-Cilëve pellje u takojnë lumenjtë e Evropës?

-Cilët janë elementet dalluese të lumenjve të Evropës?

-Cili është lumi më i gjatë në Evropë?

Grupi 2

-Cili është lumi i dytë më i gjatë në Evropë?

-Cilët lumenj i takojnë pellgut të Atlantikut?

-Cilët lumenj derdhën në pellgun e detit Mesdhe?

Grupi 3

- Cilët lumenj derdhën në pellgun e detit Kaspik?
- Cilët lumenj derdhën në pellgun e detit të Zi?
- Numëro 3 liqenet më të mëdhenj në Evropë?

Detyrë: Identifikoni shtetet nëpër të cilat kalon Danubi.


Grupi 4

- Në cilat shtete kalon Danubi?
- Cilët liqene akullnajore janë krijuar në Alpe?
- Cilat janë specifikat e liqeneve Bajkal dhe liqenit Kaspik sa i përket pozicionit vertikal të tyre?
- Për nga origjina e krijimit sa lloje të liqeneve kemi në Evropë?

Përfaqësuesit e grupeve u përgjigjen pyetjeve dhe debatojnë lidhur me to.

Pjesa e tretë: Pjesa e tretë është reflektim i aktivitetit në pjesën e dytë. Pasi kryejnë detyrën në grupet e reja që janë krijuar me njëshat, dyshat treshat e kështu me radhë kthehen dhe riformohen përsëri grupet bazë në të cilët çdo nxënës ka një detyrë specifike të cilën do ta prezantojë. Të gjithë se bashku marrin pjesë me pyetje dhe komente duke e qartësuar problemin deri në fund dhe duke e përcjellë me eksplikim në hartë.

Me pyetje u drejtohet mësimdhënësi por edhe nga grupet tjera ku lypet sqarime.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Plotëso:

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:10

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedis** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Aspektet e përgjithshme fiziko-gjeografike të Evropës	Rezultati i të nxenit të temës: <i>Analizon përhapjen e lumenjve dhe të liqeneve ne kontinentin e Evropës. -Dallon tipat kryesore klimatike që dominojnë në Evropë.</i>
---	---

Rezultatet e të nxenit për kompetencat kryesore të shkallës: I-3,4,6; II-5,6,7; III-3,5,8.

Rezultatet e fushës së kurrikulës: RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvorjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.1; 2.2.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrime - Klima dhe hidrografia

Fjalët kyçë: Breza klimatik, ujëmbledhësit, lumenjtë, liqenet, gradient vertikal

Rezultati/et e të nxenit për orë mësimore:

1. Shpjegon hidrografinë e Evropës sipas hartës dhe tregon ndikimin e klimës në hidrografinë e Evropës.

Kriteret e suksesis (formohen në klasë së bashku me nxënës):

1. Tregon ujëmbledhësit në hartë;
2. Shpjegon me hartë zonat ku dominon klima oqeanike, mesdhetare...
3. Identifiko në hartë pesë lumenjtë më të mëdhenj të Evropës;
4. Identifikon liqenet më të mëdha në Evropë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7, atlasi

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore:

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXENËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Mësimdhënësi njofton nxenësit për punën që do zhvillohet. Me qëllim që të gjithë nxenësit të përfshihen, mësimdhënësi i ndan nxenësit nga tre nxënës në grup (i përzien) që të mësojnë nga njëri tjetri (i lartë, i mesëm dhe pasivët).

Pjesa e dytë: Mësimdhënësi ndan nxenësit në grupe (3 nxënës) dhe u jep një mision për të përfunduar sipas tabelës. Nxenësit duhet të orientohen nga libri dhe atlasi.

Misioni	Përshkrim dhe fakte	Pozicioni
Oqeani Atlantik	(fakte nga libri)	(përshkruan pozicionin)
Deti Mesdhe		
Deti i Veriut		
Deti Adriatik		
Danubi, Volla		
Klima Atlantike		
Liqeni Kaspik		
3 liqene të Ballkanit		
Pellgu i Atlantikut		
Detet e Ballkanit		
Klima Kontinentale		

Pjesa e tretë: Nxënësit në grupe bëjnë prezantimin para klasës (për kohë të caktuar) duke shpjeguar me hartë. Pas shpjegimit, nxënësit dorëzojnë fletën te mësimdhënësi e plotësuar edhe me emrat e grupit. Mësimdhënësi në bazë të shpjegimit dhe përshkrimit në fletë i kontrollon dhe i vlerëson me notë. Nëse klasa është e madhe, mësimdhënësi e kryen kontrollin në shtëpi dhe i sjell orën e ardhshme.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:11

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedisë** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Aspektet e përgjithshme fiziko-gjeografike të Evropës	Rezultati i të nxënësit të temës: <i>Analizon përhapjen e botës bimore dhe shtazore ne kontinentin e Evropës.</i>
---	---

Rezultatet e të nxënësit për kompetencat kryesore të shkallës: **I-1,2,4,6; II-1; III-3,8**

Rezultatet e fushës së kurrikulës: *RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.1; 2.2.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Tokat, bota bimore dhe shtazore

Fjalët kyçe: Tundrat, tajgat, bimët mesdhetare, stepat, makiet, ariu, ujku, çernoziomet, humusi.

Rezultati/et e të nxënësit për orë mësimore:

1. Identifikon zonat bimore dhe të tokave më të përhapura në kontinentin e Evropës;
2. Shpjegon shtrirjen e zonave bimore në hartën e Evropës nga veriu drejt jugut;
3. Gjykojnë rolin e njeriut në ndryshimin e fisionomisë dhe përmasave të formacioneve bimore dhe shtazore.

Kriteret e suksesit (formohen në klasë së bashku me nxënës):

1. Përshkruan zonat bimore sipas specifikave;
2. Shpjegon shtrirjen e bimësisë në formën vertikale;
3. Tregon specifikat e tokave Çernoziome.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore: BIOLOGJI

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Përsëritje (punë individuale).

Arsimtari kërkon nga nxënësit që të reflektojnë nga mësimet e klasës së gjashtë.

Cili ishte roli i njeriut në mbrojtjen dhe shkatërrimin e pyjeve?

A mundet që në secilin vend të botës të kemi bimësi të njëjtë? Nëse jo, pse?

A janë tokat e njëjtë në të gjithë rruzullin tokësorë?

Kështu hapet biseda rrëth Tokave, botës bimore dhe shtazore dhe nxënësit njoftohen me temën.

Pjesa e dytë: Realizohet me teknikën e "Ditari dypjesësh" (punë individuale).

Në pjesën e dytë të orës, mësimdhënësi ndan tabelën në dy shtylla. Në shtyllën e parë, mësimdhënësi shënon disa fjalë kyçe dhe kërkon nga nxënësit që duke lexuar njësinë mësimore "**Tokave, botës bimore dhe shtazore**" të bëjnë përshkrimin në shtyllën e dytë për këto fjalë

Citatit	Komenti që ipet nga nxënësit
Zonaliteti horizontal	Shtrirja e botës bimore nga kushtëzimi i gjërësisë gjeografike
Biosferë	Është sferë e re e cila përfshinë tërë jetën e gjallë në Tokë. Është e lidhur ngush me sferat tjera
Tajga	Formacion i pyjeve halore që shtrihen në jug të tundrave (Rusi, Suedi, Kanada...)
Zonaliteti vertikal	Shtrirja e bimëve varësisht lartësisë mbidetare
Stepa	Zonë shume e përhapur në të gjithë kontinentin. Përfaqësohet nga formacione të barërave ku mbizotëron klima kontinentale.
Tundra	...paraqet përhapjen e botës bimore në zonat polare në të cilën mbizotërojnë temperature të ulëta...më së shumti rriten: Myshqet, likenet dhe shkurret e ulëta..
Makiet	Nga degradimi i pyjeve të dikurshme janë krijuar makiet të cilat sot paraqesin bashkësinë bimore më të përhapur në këtë region....



Shpyllëzimi	Rrezikohet zhdukja e shtazëve që jetojnë në këto habitate...
Çernozem	Toka të zeza, të përhapura në zonën e stepave, humus të theksuar, mbillen drithërat dhe bimët industriale.

Pjesa e tretë: Demonstrim dhe ushtrime me hartë dhe fletore pune.

Arsimtari paraqet hartën ku janë të paraqitura zonat gjeografike të bimëve. Ai kërkon nga ata që të identifikojnë zonat dhe të shpjegojnë specifikat.

Stepat, tajgat, tundrat, makiet, pyjet e përziera...

Plotësoni së bashku Fletoren e punës nga pyetja 29-31.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Plotëso: Detyra 27-31 për detyrë shtëpie në Fletore Pune.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

»Pëershkrat rrjedhën e orës sipas klasave. Paraqit përparësitetë dhe mangësitetë për klasat gjatë zhvillimit të orës ose ndonjë specifik të veçantë«

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:12

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedis / Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 / Klasa: 7

Tema: Aspektet e përgjithshme fiziko-gjeografike të Evropës	Rezultati i të nxënët të temës: Analizon specifikat natyrore, popullative, kulturore, ekonomike dhe politike të Evropës.
---	--

Rezultatet e të nxënët për kompetencat kryesore të shkallës:

Rezultatet e fushës së kurrikulës: RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.1; 2.2.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Pasuritë natyrore dhe zhvillimi ekonomik

Fjalët kyçe: Revolucioni Industrial, peshkimi, resurset natyrore, burimet energetike, bujqësi intensive.

Rezultati/et e të nxënët për orë mësimore:

1. Analizon zhvillimin ekonomik të Evropës dhe arsyetojnë zhvillimin e ndryshëm në disa pjesë të saj.
2. Shpjegon rëndësinë Revolucionit Industrial dhe atij shkencor në zhvillimin ekonomik të Evropës.
3. Arsyeton ndikimin e resurseve natyrore në zhvillimin ekonomik në disa vende të Evropës.

Kriteret e suksesit (formohen në klasë së bashku me nxënës):

1. Identifikon vendet me bujqësi dhe lavërtari të zhvilluar dhe intensive;
2. Identifikon vendet më të pasura me thëngjill në Evropë;
3. Tregon të paktën pesë përparësi të Revolucionit Industrial.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore:

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Stuhi mendimesh (pyetje për diskutim).

Mësimdhënësi për të ngjallur diskutim në klasë për temën mësimore, parashton pyetje që nxënësit të japid shumë përgjigje "stuhishëm".

Cilat janë burimet energetike?

Ç kuptioni me ekonomi?

Cilët janë sektorët kryesorë të ekonomisë (sektori primar, sekondar, terciar...?)

Tregoni disa veprimtari ekonomike që bëjnë pjesë në sektorin sekondar (prodhues) të ekonomisë.

Cilët janë shtetet më të zhvilluara në Evropë?

Komentet shkurtimisht përshkruhen në tabelë dhe diskutohen së bashku me mësimdhënësin (2 ose 3).

Pjesa e dytë:

Nxënësit ndahen ne pese grupe, ku secili nxënës ka një numër 1,2,3,4

Pas nxënësit kanë përcaktuar numrat bashkohen njëhat bashkë, dyhat bashkë, treshat bashkë, katrat bashkë, pesat bashkë dhe kështu me radhë

Mësimdhënësi iu jep secilit grup nga një detyrë të caktuar dhe punojnë duke u bërë ekspertë të çështjes për të cilën janë caktuar

Grupi 1

- Në cilat Ultësira të Evropës janë zhvilluar lavërtaria dhe kultivimi i drithërave, perimeve e kulturave industriale?

- Në cilat pjesë të Evropës ofrohen kushte të volitshme për vreshtari dhe për prodhimin e agrumeve?

Grupi 2

- Në cilat pjesë të Evropës ofrohen kushte të volitshme për blektori dhe çfarë karakteri ka ajo?

- Në cilat pjesë të Evropës është e zhvilluar Peshkataria?

Grupi 3

-Cilat janë basenet më të mëdha në Evropë të pasura me thëngjill?

-Cilat janë resurset energjetike?

-Roli dhe rëndësia e energjisë nukleare dhe përdorimi i saj?

Grupi 4

-Në cilat shtete/zona/regjione është më i zhvilluar turizmi?


-Në sa grupe ndahen shtetet sipas të ardhurave kombëtare për kokë banorin në Evropë?

Përfaqësuesit e grupeve u përgjigjen pyetjeve dhe debatojnë lidhur me to.

Pjesa e tretë: Reflektim i grupeve (punë në grupe).

Pjesa e tretë është reflektim i aktivitetit në pjesën e dytë. Pasi kryejnë detyrën në grupet e reja që janë krijuar me njëshat, dyshat treshat e kështu me radhë kthehen dhe riformohen përsëri grupet bazë në të cilët çdo nxënës ka një detyrë specifike të cilën do ta prezantojë. Të gjithë se bashku marrin pjesë me pyetje dhe komente duke e qartësuar problemin deri në fund dhe duke e përcjellë me eksplikim në hartë.

Me pyetje u drejtohet mësimdhënësi por edhe nga grupet tjera ku lypet sqarime.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

DETÝRAT DHE PUNA E PAVARUR

Plotëso:

Reflektimi përrnjedhëni e orës mësimore

»Pëershkrat rrnjedhëni e orës sipas klasave. Paraqit përparrësitë dhe mangësitë përrnjedhëni e orës ose ndonjë specifik të veçantë«

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:13

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedis / Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 / Klasa: 7

Tema: Aspektet e përgjithshme fiziko-gjeografike të Evropës	Rezultati i të nxenit të temës: Përcakton kufijtë e Evropës dhe dallon regionet mbi bazën e kushteve të ndryshme fiziko-gjeografike.
---	--

Rezultatet e të nxenit për kompetencat kryesore të shkallës: I-1,2,4,6; II-1; III-3,8.

Rezultatet e fushës së kurrikulës: RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvorjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.1; 2.2.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ndarja regionale dhe politike e Evropës

Fjalët kyçë: Republika, shtete federale, monarki, regjoni perëndimor, regjoni i Mesdheut...

Rezultati/et e të nxenit për orë mësimore:

1. Shpjegon me hartë ndarjen regionale të Evropës duke qartësuar specifikat fiziko-gjeografike të regjionit.

Kriteret e suksesit (formohen në klasë së bashku me nxënës):

1. Dallon pesë regjione kryesore të Evropës;
2. Identifikon shtetet sipas regjoneve të caktuara në hartë;
3. Tregon elementet dominuese të regionalizimit për regjione;
4. Identifikon shtete e mëdha, të mesme dhe të vogla në Evropë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore: HISTORI

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXENËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Arsimtari paraqet para nxenësve hartën (hartë në projektor) politike të Evropës.

Pyet nxenësit:

Çfarë paraqesin njyrat në hartën politike?

Cilat shtete kanë territor më të madh (shëno në tabelë)?

Në formën e diskutimit, vlerësohet stadi i njohurive të nxenësve për njësinë që do zhvillohet. Shembujt dhe shënimet interesante dhe logjike shënohen në tabelë të përdorën gjatë orës si referencë për nxenësit dhe nga nxenësitet.

Pjesa e dytë: Lexim i drejtuar (punë individuale).

Mësimdhënësi drejton njërin nga nxenësitet ose lexon vetë me zë pjesën e njësisë (mësimin). Kur përfundon leximi, analizohet harta politike e Evropës.

- Pas këtij leximi, nxenësve u shtrohen pyetjet varësish nga natyra e përbajtjes:

-Tregoni nga pesë shtete të mëdha, të mesme dhe të vogla të Evropës?

-Cilat janë regjionet kryesore të Evropës?

Nxenësitet gjatë kësaj kohe përdorin atlastet e tyre.

- Fjalët kyçë ose ato referenca interesante, shënohen në tabelë (shtet federal, monarki, regjioni...)

- Hapa të njëjtë merren edhe tek leximi i pjesës/paragrafit 2, 3... para leximit të fundit shtohet edhe pyetja:

Në cilin nga regjionet ndodhet Kosova dhe Shqipëria?...

- Pas leximit të fundit, nxenësve mësimdhënësi duhet të jap mundësi që ata të flasin me njëri tjetrin e jo përmes ti. Këtë e arrin duke dhënë pyetjet dhe duke miratuar përgjigjet me lëvizje të kokës.

-Si mendoni, ky numër prej 45 shtetesh në Evropë a mund të rritet?

-Sa shtete tjera i dini në Evropë që nuk njihen nga Kombet e Bashkuara?

-Në cilin regjion ndodhet Gjermania?

-Në cilin regjion ndodhet Gadishulli Skandinav?

Pjesa e tretë: Pyetje dhe përgjigje (punë në bashkëpunim, dyshe).

Arsintari kërkon nga nxënësit të punojnë në dyshe sipas bankës ku janë ulur ose në grupe deri në katër persona.

Secili grup pajiset me nga një glob/harte si mjet pune gjatë aktivitetit.

Pyetjet e parashtruara nga arsimtari, nxënësit i shënojnë në fletore dhe i përgjigjen duke bashkëpunuar dhe ilustruar në album ose fletë A4.

Nëse është e mundshme, mësimdhënësi pajis grupet me një fletë A4 në të cilën është paraqitur harta memece e Evropës.



Pyetje	Përgjigje
•Çka paraqet regjioni?	
•Tregoni karakteristikat e Evropës Veriore?	
•Tregoni karakteristikat e Evropës së Mesme?	
•Tregoni karakteristikat e Evropës Jugore?	
•Tregoni karakteristikat e Evropës Perëndimore?	
•Tregoni karakteristikat e Evropës Lindore?	
•Identifikoni pesë regjionet gjeografike të Evropës?	
•Identifikoni shtetet Evropiane që nuk njihen nga OKB.	

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

DETÝRAT DHE PUNA E PAVARUR

☞ Plotëso:

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

»Përshkruan rrjedhën e orës sipas klasave. Paraqit përparësitë dhe mangësitë për klasat gjatë zhvillimit të orës ose ndonjë specifik të veçantë«

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:14

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedisi** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Evropa Jugore, veçoritë natyrore	Rezultati i të nxënët të temës: <i>Identifikon gadishujt, ishujt, objektet tjera natyrore dhe shtetet që e përbëjnë Evropën Jugore.</i> <i>-Analizon pozitën e Evropës jugore dhe ndikim historik të saj.</i> <i>-Vlerëson ndikimin e Detit Mesdhe përmes rritjes së bimëve mesdhetare dhe jetës së njerëzve.</i> <i>-Dallon në hartë sistemet malore, fushat, rrafsh lartat dhe luginat lumore më të njohura dhe të arsyetojë pse rrëth Mesdheut ka tërmete dhe vullkane (Etna, Vezuvi etj.).</i> <i>-Analizon faktorët klimatik që ndikojnë në klimën e vendeve të Evropës Jugore.</i> <i>-Aryeton rrjetin e varfër lumenjave, sasia e vogël e ujut gjatë verës dhe varfëria e liqeneve në Evropën Jugore.</i>
--	---

Rezultatet e të nxënët për kompetencat kryesore të shkallës: **I-1,2,4,6; II-1; III-3,8.**

Rezultatet e fushës së kurrikulës: **2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke 2.1; 2.2**

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Evropa Jugore – Veçoritë natyrore

Fjalët kyçe: Evropa Jugore, deti Mesdhe, Gadishulli Apenin, Pirinej dhe Ballkanik.

Rezultati/et e të nxënët për orë mësimore:

1. Vlerëson rëndësinë e Detit Mesdhe për klimën dhe botën bimore e shtazore në këtë regjion;
2. Identifikon malet më të njohura të reja, fushat, polderët dhe luginat lumore në hartën fiziko-gjeografike të Evropës Jugore;
3. Aryeton rolin e grykave të lumenjve në formë të hinkës (estuareve) për lundrim dhe në ekonomi.

Kriteret e suksesit (*formohen në klasë së bashku me nxënës*):

1. Identifikon ishujt më të mëdhenj në Evropën Jugore;
2. Identifikon gadishujt në Evropën Jugore;
3. Tregon të paktën pesë male të reja dhe pesë të vjetra në hartën e Evropës Jugore.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore:

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Foto galeri (diskutim për flamujt e shteteve).


Mësimdhënësi prezanton disa fotografi të flamujve që përfaqësojnë shtetet e Evropës Jugore dhe kërkon nga nxënësit t'i identifikojnë se cilët janë këta shtete.

-Në cilët gadishuj pozicionohen këto shtete?

-Cilit region gjeografik të Evropës i takojnë këto shtet?

-Cilët gadishuj ndahen në Evropën Jugore?

-Cilët nga shtetet e paraqitura në foto janë ishuj?



Pjesa e dytë: Lexim i drejtuar (punë individuale).

Mësimdhënësi drejton njërin nga nxënësit ose lexon vetë me zë pjesën e njësisë (mësimit).

- Pas leximit (paragrafëve), nxënësve u shتروhen pyetjet varësish nga natyra e përbajtjes:

-Prej cilëve gadishuj përbëhet Evropa Jugore?

-Cilat shtete shtrihen në Evropën Jugore?

Nxënësit gjatë kësaj kohe përdorin atlasët e tyre.

- Fjalët kyçë ose ato referanca interesante, shënohen në tabelë (Gadishull, klimë mesdhetare, Kosova, Shqipëria...).

- Hapa të njëjtë merren edhe tek leximi i pjesës/paragratit 2, 3... Para leximit të fundit shtohet edhe pyetja:

-Cila është rëndësia e Kanalit të Suezit?

-Çfarë klimë dominon në E.J?

-Cilët janë ishujt më të mëdhenj të E.J...?

- Pas leximit të fundit, nxënësve mësimdhënësi duhet të jap mundësi që ata të flasin me njëri tjetrin e jo përmes ti. Këtë e arrin duke dhënë pyetjet dhe duke miratuar përgjigjet me lëvizje të kokës.


Pse quhet "Bota e vjetër"?

Pjesa e tretë: Klaster – Pema e mendimeve (punë individuale).

Mësimdhënësi drejton nxënësi të formohet në tabelë KLASTERI, dhe në qendër të tabelës së zezë shënohet (Evropa Jugore) ku nxënësit formojnë degët me anën e informacionit që kanë kuptuar nga informatat e fituara gjatë mësimit.

Mësimdhënësi luan rolin e "arbitrit" duke cilësuar njohuritë e shprehura si të përshtatshme ose të përshtatshme për njësinë. Puna që zhvillohet në tabelë të përshkruhet edhe në fletoret e klasës.

Nxënësit aktivizohen vullnetarisht ose i angazhon mësimdhënësi.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

DETÝRAT DHE PUNA E PAVARUR

Plotëso:

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:15

Fusha kurrikulare: Shqëria dhe mjedis / Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 / Klasa: 7

Tema: Evropa e Mesme, veçoritë natyrore	<p>Rezultati i të nxënët të temës:</p> <p><i>Analizon pozitën gjeografike të Evropës së Mesme dhe rëndësinë e saj për regionet e tjera të Evropës.</i></p> <p><i>Identifikon në hartë shtetet e Evropës së Mesme dhe fajnjët e tyre.</i></p> <p><i>Analizon shtrirjen e vargmaleve, malet e vjetra, ultësirat dhe fushat e rëndësishme të këtij regjioni.</i></p> <p><i>Dallon dhe arsyeton tipat e klimës mes pjesëve perëndimore dhe lindore, viseve të larta dhe të ulëta të Evropës së Mesme.</i></p> <p><i>Identifikon lumenjtë më të rëndësishëm dhe i përshkruan veçoritë specifike të tyre.</i></p> <p><i>Dallon ne hartën fiziko-gjeografike liqenet më të njohura në Evropën e Mesme.</i></p>
---	--

Rezultatet e të nxënët për kompetencat kryesore të shkallës:

Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvartjet dhe ndërveprimet reciproke 2.1; 2.2

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Evropa e Mesme—veçoritë natyrore-Pozita gjeografike, kufijtë dhe madhësia
Fjalët kyçe: Evropa e Mesme, Alpet, ultësira gjermano-polake.

Rezultati/et e të nxënët për orë mësimore:

1. Analizon pozitën gjeografike të Evropës së Mesme dhe rëndësinë e saj për regionet e tjera të Evropës.
2. Identifikon në hartë shtetet e Evropës së Mesme dhe përshkruan pozitën e tyre në Evropën e Mesme.
3. Analizon shtrirjen e vargmaleve, malet e vjetra, ultësirat dhe fushat e rëndësishme të këtij regjioni.

Kriteret e suksesit (formohen në klasë së bashku me nxënës):

1. Identifikon malet e reja dhe të vjetra;
2. Tregon vendet më të pasura me thëngjill në Evropën e Mesme;
3. Identifikon në hartë të paktën pesë lumenj të rëndësishëm të regjionit.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.



Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore:

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Puna me hartë (punë individuale) përshkrim i hartës.

Mësimdhënësi prezanton hartën e Evropës së Mesme (projektor ose hartë të rëndomtë) dhe kërkon nga nxënësit t'i identifikojnë se cilët shtete pozicionohen në këtë regjion.

Pasi që nxënësit së bashku me mësimdhënësin identifikojnë shtetet, mësimdhënësi paraqet hartën fiziko-gjeografike dhe pyet nxënësit se cilët element fiziko-gjeografike dominojnë në këtë hapësirë.



Mësimdhënësi së bashku me nxënësit paraqesin kriteret në tabelë ose i sjell të gatshme dhe i shënon që nxënësit ti kenë përpala të përshkruara.

Pjesa e dytë: Mësimdhënësi drejton njërin nga nxënësit ose lexon vetë me zë pjesën e njësisë (mësimit).

- Pas këtij leximi, nxënësve u shtrohen pyetjet varësish nga natyra e përbajtjes:

- Prej cilëve shtete përbëhet Evropa Jugore?
- Cilët element natyrore dallohen në relievin e E.M (shëno referenca)?
- Shpjegoni shtrirjen gjeografike të Evropës së Mesme (shpjegim me hartë)
- Sa është sipërfaqja e Evropës së Mesme?

...

Nxënësit gjatë kësaj kohe përdorin atlasët e tyre.

- Fjalët kyçë ose ato referenca interesante (*Alpet, Ultësira Gjermano-Polake, klima kontinentale, Karpatet, Panonia*) shënohen në tabelë që të shërbehen si referencë.

- Hapa të njëjtë merren edhe tek leximi i pjesës/paragrafit 2, 3... Para leximit të fundit shtohet edhe pyetja:

- Cila është rëndësia e Alpeve?
- Çfarë klime dominon në E.M?
- Cilët janë malet kryesore në E.M?
- Cilët janë lumenjtë më të gjatë?

...

- Pas leximit të fundit, nxënësve mësimdhënësi duhet të jap mundësi që ata të flasin me njëri tjetrit e jo përmes ti. Këtë e arrin duke dhënë pyetjet dhe duke miratuar përgjigjet me lëvizje të kokës.

Pjesa e tretë: Klaster (perma e mendimeve) punë në dyshe.

Mësimdhënësi drejton nxënësi të formohet në tabelë KLASTERI, dhe në qendër të tabelës së zezë shënohet (Evropa Jugore) ku nxënësit plotësojnë të dy pjesët (natyrore dhe shoqërore) me degët me anën e informacionit që kanë kuptuar nga informatat e fituara gjatë mësimit.

Mësimdhënësi luan rolin e "arbitrit" duke cilësuar njohuritë e shprehura si të përshtatshme ose të pa-përshtatshme për njësinë. Puna që zhvillohet në tabelë të përshkruhet edhe në fletoret e klasës.

Puna realizohet në dyshe.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:16

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi / Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 / Klasa: 7

Tema: Evropa e Mesme, veçoritë shoqërore	Rezultati i të nxënët të temës: <i>Radhitë popujt e Evropës së Mesme sipas numrit të popullsisë.</i> <i>-Analizon specifikat natyrore, populitative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngashmëritë dhe dallimet mes tyre.</i>
--	---

Rezultatet e të nxënët përkompitet kryesore të shkallës:

Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke 2.1; 2.2

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Veçoritë shoqërore-ekonomike të Evropës së Mesme

Fjalët kyçe: Evropa e mesme, Ruri, Sari, Shlezia, gjermanët, polakët, lufta e dytë botërore

Rezultati/et e të nxënët për orë mësimore:

1. Përkufizon hapësirën Evropës së Mesme duke identifikuar shtetet që shtrihen në këtë region.
2. Njeh popujt që banojnë në hapësirën e Evropës së mesme dhe tregon se cilit grup të madh të popujve i takojnë.
3. Arsyeton ndikimin e resurseve natyrore në zhvillimin ekonomik të Evropës së Mesme.

Kriteret e suksesit (formohen në klasë së bashku me nxënës):

1. Identifikon shtetet e Evropës së Mesme;
2. Identifikon popujt kryesor të këtij regjioni;
3. Tregon tri zonat/vendet me dendësinë më te madhe të popullsisë;
4. Tregon besimet kryesore sipas shteteve.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore: HISTORI

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Në hartën politike të Evropës, mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që të tregojnë grupet më të mëdhenj popujve të Evropës dhe ku shtrihen.

Në cilën pjesë shtrihen popujt sllav (identifiko shtetet)?

Në cilat shtete shtrihen popujt gjerman (identifiko shtetet)?

Cila është rëndësia e Evropës së Mesme në hapësirën Europeiane?

Kështu nxënësit njihen me njësinë e re që do zhvillohet (popullsia dhe ekonomia).


-Në hartë përfshihet edhe Rumania.



Mësimdhënësi së bashku me nxënësit paraqesin kriteret në tabelë ose i sjell të gatshme dhe i shënon që nxënësit ti kenë përparrë të përshkruara.

Pjesa e dytë: Harta e të pyeturit (punë individuale).

Ars. kërkon nga nxënësit të lexojnë tekstin në heshtje dhe individualisht. Pasi shkruan në tabelë temën dhe çështjet kryesore, vizaton hartën e të pyeturit në formën e diagramit. Gjatë leximit që bëjnë nxënësit, mësimdhënësi shënon disa pyetje në hartën e të pyeturit ku nxënësit pas leximit duhet ti jepin përgjigje/plotësojnë hapësirat.



Pjesa e tretë: Përbledhje e përbashkët.

Merret një letër dhe një laps, nxënësit ulën në mënyre rrethore në grupe ose në një grup të madh. Zgjidhet krahu nga do të lëvizë letra dhe lapsi. Para së gjithash nga nxënësit kërkohet që kjo të jetë një rezyme e artikuluar por duke i përfshirë dy pjesët, NATYRORE dhe SHOQËRORE.

Arsimtari kërkon që nxënësit të shkruajnë një koment për mësimin e realizuar.

Çdo nxënës pasi e shkruan idenë e tij, vendos firmën e tij (emrin). Dalë nga dalë formohet një letër në formë fizarmonike.

Mund të përdoren edhe lapsa me ngjyra të ndryshme... në fund pasi ka mbaruar edhe nxënësi i fundit së shkruari komentin e vetë, arsimtari lexon komentet para nxënësve duke bërë një rezyme të asaj se çka mësuan.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:17

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedis** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Evropa Mesme, veçoritë shoqërore	Rezultati i të nxënëtit të temës: ashëno:
--	--

Rezultatet e të nxënëtit për kompetencat kryesore të shkallës: **ashëno:**

Rezultatet e fushës së kurrikulës: *RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.2.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrime-Evropa Jugore dhe Evropa e Mesme (veçoritë natyrore)

Rezultati/et e të nxënëtit për orë mësimore:

1. Krahasohen të dy regjionet sipas elementeve fiziko-gjeografike dhe identifikohen pjesët e përbashkëta.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: **Atlaset, fletore klase, harta...**

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore: Histori

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Punë në dyshe (bashkëpunuese).

Arsimtari pajis të gjithë nxënësit me tabelën e strukturuar nga ai dhe kërkon nga nxënësit që të plotësojnë tabelën (të vizatojnë ose ju sjellë arsimtari të gatshme) sipas elementeve që kerkohen për tu krahasuar në mes dy regjioneve gjeografike (veçoritë natyrore).

Pas çdo përshkrimi të elementeve me specifikat e tyre të veçanta, nxënësit në shtyllën me shkronjën "V" jepin vlerësimin me 1 ose 2 pikë për elementin e caktuar. Në fund gjatë vizitës së mësimdhënësit nëpër banka, nxënësit arsyetojnë punën e tyre dhe vlerësimin që kanë dhënë duke e arsyetuar.

Evropa Jugore	V	elementet	V	Evropa e Mesme
		←Pozita gjeografike→		
		←Relievi→ Ultësirat, malet		
		←Klima→ Përkruaj dhe vlerëso klimën		
		←Ujërat→ Lumenjtë, liqenet, detet...		
		←Shtetet→ Shtetet sipas pozitës, ekonomisë dhe turizmit		
		←Komenti juaj→ Komente të nxënësve për regjionet		

Gjatë orës nxënësit duhet të punojnë pa ndihmën e teksteve, vetëm me fletore klase dhe atlas.

Arsyetim: Lejimi i përdorimit të fletoreve të klasës bëhet që nxënësit gjate zhvillimit të orës mësimore të përkruajnë se cilën njësi mësimore e të mos mbesin pasiv gjatë orës.

Mësimdhënësi përzgjedh tre dyshe vullnetare që ta paraqesin punën e tyre para klasës, kurse punimet tjerat i merr me veti që ti ketë si dëshmi të punës së nxënësve dhe i kontrollon.

Punimi duhet të ketë identitet dhe klasën si dhe datën se kur është realizuar.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**No:18**Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedisë / Lënda: Gjeografi**Shkalla e kurrikulës: **3 / Klasa: 7**

Tema: Evropa Mesme, veçoritë natyrore dhe shoqërore të shteteve	Rezultati i të nxënëtit të temës: <i>Analizon specifikat natyrë popullative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve e veç, duke gjetur njashmëritë dhe dallimet mes tyre.</i>
---	--

Rezultatet e të nxënëtit për kompetencat kryesore të shkallës: ashëno:

Rezultatet e fushës së kurrikulës: <i>RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.2.</i>

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Gjermania

Fjalët kyçe: Industria e makinave, Ruri dhe Sari, Bavaria, lugina e Rajnës,

Rezultati/et e të nxënëtit për orë mësimore:
--

1. Përkufizon hapësirën e Gjermanisë dhe identifikojnë shtetet që kufizohen me të në atlas.
2. Përshkruan regionet gjeografike të Gjermanisë sipas specifikave natyrore dhe shoqërore.
3. Identifikon faktorët e zhvillimin ekonomik të Gjermanisë dhe tregojnë zonat më të zhvilluara ekonomike dhe qendrat kryesore.

Kriteret e suksesit (formohen në klasë së bashku me nxënës):
--

1. Identifikon regionet e Gjermanisë;
2. Tregon dy qendrat më të njohura të secilit regjion;
3. Tregon në hartë shtrirjen e lumenjve më të njohur të Gjermanisë;
4. Tregon shtetet që kufizohen me Gjermaninë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.
--

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore: HISTORI
--

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**Pjesa e parë: "Asociacion"**

Arsimtari formon një asociacion në tabelë si vegës që nxënësit të gjejnë njësinë që do zhvillohet dhe të pyesin për rubrikat se çka assocojnë.

A	B	C	D
"Pastori"	Bavaria	J.S.Bah	Federal
Gjermania			

Nëse klasa është a pajisur me projektor dhe internet, identifikon elementet e asociacionit që nxënësit ti shohin se për çfarë bëhet fjalë. Ose formon sipas dëshirës një asociacion.

"Pastori"- Pastori gjerman (racë e qenve me origjinë në Gjermani).

Bavaria- Shtet i Lirë në jug të Gjermanisë Federale

"J.S.Bah" – Kompozitor gjerman i muzikës klasike

Federal- Gjermania është shtet federal

Në fund mësimdhënësi i pyet se si do ta formonit ju një asociacion për Gjermaninë? Diskutim 2 min.

Pjesa e dytë: Grupet e ekspertëve (punë në grupe).

Nxënësit ndahen ne grupe, ku secili nxënës ka një numër 1,2,3,4

Pas nxënësit kanë përcaktuar numrat bashkohen njëhat bashkë ,dyhat bashkë, treshat bashkë, katrat bashkë, pesat bashkë dhe kështu me radhë

Mësimdhënësi iu jep secilit grup nga një detyrë të caktuar dhe punojnë duke u bërë ekspertë të çështjes për të cilën janë caktuar

Grupi 1

- Në sa dete ka dalje Gjermania. Cilët dete?
- Në sa tërësi gjeografike ndahet Gjermania?
- Përshkruaj specifikat natyrore të Gjermanisë veriore dhe të mesme?
- Sa është sipërfaja e Gjermanisë

Grupi 2

- Përshkruaj specifikat natyrore të Gjermanisë jugore?
- Cilët janë lumenjtë më të njojur të Gjermanisë?
- Cilat dete lidh kanali i Kilit?

Grupi 3

- Nga e mori emrin Gjermania?
- Sa shqiptar mendohet që sot jetojnë në Gjermani?
- Cilat janë trevat më të banuara të Gjermanisë?

Grupi 4


- Gjermania është shteti ekonomikisht më i fuqishëm Evropian. E sata radhitet në botë?
- Gjermania është shtet tejet i fuqishëm industrial. Me cilat industri shquhet, përmend disa?
- Cila është treva më e zhvilluar në Gjermani dhe cilat janë qendrat e koncentruar në këtë trevë?

Përfaqësuesit e grupeve u përgjigjen pyetjeve dhe debatojnë lidhur me to.

Pjesa e tretë: Reflektim i grupeve të ekspertëve (punë në grup).

Pjesa e tretë është reflektim i aktivitetit në pjesën e dytë. Pasi kryejnë detyrën në grupet e reja që janë krijuar me njëhat, dyshat treshat e kështu me radhë kthehen dhe riformohen përsëri grupet bazë në të cilët çdo nxënës ka një detyrë specifike të cilën do ta prezantojë. Të gjithë se bashku marrin pjesë me pyetje dhe komente duke e qartësuar problemin deri në fund dhe duke e përcjellë me eksplikim në hartë.

Me pyetje u drejtohet mësimdhënësi por edhe nga grupet tjera ku lypet sqarim.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

DETÝRA

Detyrë shtëpie: Punim për Gjermaninë në ½ hamer ose A3 (Puna me katër nxënës).

Mësimdhënësi u jep nxënësve kriteret e shënuara (shtypura) në letër.

Kriteret:**Tema: Gjermania**

Pjesët e punimit: Pozita gjeografike, reliivi, klima, ujërat, ekonomia, popullsia.

Punimi të dorëzohet në letër.

Shtatë ilustrime ose fotografi, bashkangjitur harta dhe flamuri për Gjermaninë.

Të paraqiten burimet të besueshme dhe edukative.

Artikulimi të jetë sipas standardit gjuhësor.

Shpjegim i rrjedhshëm dhe i qartë me gojë, shpjegim me hartë dhe interpretim i ilustrimeve.

Rregull estetik.

Emrat e nxënësve që punuan.

Për mësimdhënësin: Kriteret duhet të bazohen në rezultatet e kompetencave që synohen të arrihen këtë vit shkollor.

I-5: Shkruan tekst deri në 500 fjalë, sipas detyrës së dhënë, si: letër, kërkesë, ese etj., duke respektuar rregullat e organizimit/strukturimit të shkrimit dhe standardin gjuhësor.

I-6: Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalarin adekuat dhe të saktë.

III-1: Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalarë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon përmes detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë përmes.

III-6 Përdor programet softuerike adekuate përmes zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe jo shkollore në fusha të ndryshme të dijes.

IV-5 Përdor programet kompjuterike përmes përgatitjen e materialeve të nevojshme (si: grafikë, ilustrime të nevojshme, dizajnim të ftesave, pamfleteve, njoftimeve apo publikimeve të tjera) përmes nevoja të klasës dhe të shkollës.

IV-7 Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) përmes realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:19

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedisë** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Evropa Mesme, veçoritë natyrore dhe shoqërore të shteteve

Rezultati i të nxënët të temës: *Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.*

Rezultatet e të nxënët për kompetencat kryesore të shkallës: ~~ashëno~~:

Rezultatet e fushës së kurrikulës: *RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.1; 2.2.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: GJERMANIA (Përforcim dhe prezantim)

Fjalët kyçe: Industria e makinave, Ruri dhe Sari, Bavaria, Iugina e Rajnës,

Rezultati/et e të nxënët për orë mësimore:

1. Përshkruan hapësirën gjeografike të Gjermanisë dhe identifikon shtetet që kufizohen me Gjermaninë.
2. Përshkruan regionet e Gjermanisë sipas specifikave natyrore dhe shoqërore.
3. Arsyeton zhvillimin ekonomik të Gjermanisë si dhe ndikimin e tij në rritjen e popullsisë.

Kriteret e suksesit (formohen në klasë së bashku me nxënës):

1. Identifikon regionet e Gjermanisë;
2. Tregon nga dy qendrat më të njohura të secilit region;
3. Identifikon lumenjtë më të njohur të Gjermanisë.
4. Tregon zonat më të banuara në Gjermani.


Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore: HISTORI

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e pare: Të formohet një galeri për prezantim 5' dhe nxënësit pasi që i shikojnë punimet, etiketojnë pesë punimet më të mira duke vendosur ngjitet.

Punimet e përzgjedhura prezantohen. Nëse ka me shume, mësimdhënësi i merr me vete për ti vlerësuar, kurse prezantimin mund ta kryej edhe orën e radhës.



Pjesa e dyte: Prezantim i punimeve në dyshe, në PowerPoint.

Punimi duhet t'u përbahet kritereve që mësimdhënësi i ka paraqitur me detyrën, disa orë (dy javë) më herët.

Vlerësimi i punës

Për të nxjerrë notën veprojmë kështu (shembull):

$$3 \times 0.20 + 5 \times 0.20 + 4 \times 0.10 + 5 \times 0.30 + 3 \times 0.20 = 0.60 + 1 + 0.40 + 1.5 + 0.60 = 4.1 \text{ pra nota është 4}$$

Emri i nxënësít	Ilustrimet 20%	Burimet 20%	Artikulimi 10%	Shpjegim 30%	Bashkëpunimi 20%	Nota
1	3	5	4	5	3	4
2						
3						
4						

Mësimdhënësi mund të formojë një instrument sipas kritereve të veta ose t'i paraqesë kriteret së bashku me nxënësit.

Instrumenti 3 - Prezantim me gojë (30%). Nxënësi vlerësohet sipas standardeve të vlerësimit, të përshkruara në: UA, Kurrikulen bërthamë dhe Udhëzuesin për vlerësim.

Nota 5. Nxënësi i cili bashkëbisedon me arsimtarin dhe ofron fakte, argumente dhe e analizon detyrën para se të përgjigjet. Ka shprehje të rrjedhshme dhe logjike. Bashkëbisedimin e përcjell me gjestikulacion për eksplikim të rasteve. Oftron faktet gjeografike, njeh objektet gjeografike; shpjegon dukuritë dhe proceset gjeografike si dhe raportet që janë në lidhshmëri me njësitë e përpunuara hapësinore; analizon lidhshmëritë dhe ligjshmëritë gjeografike që shprehen dhe veprojnë brenda këtyre njësive; paraqet aftësitë, shkathtësitë e shprehët, të dinë të shërbehen me to dhe të përvetësojnë mënyrën e të menduarit gjeografik.

Nota 4. Nxënësi i cili bashkëbisedon me arsimtarin, ofron fakte dhe e analizon detyrën para se të përgjigjet. Ka shprehje të rrjedhshme dhe logjike, me ngecje në informacion. Bashkëbisedimin e përcjell me gjestikulacion për eksplikim të rasteve, jo në formë shumë të saktë. Oftron faktet gjeografike, njeh objektet gjeografike; shpjegon dukuritë dhe proceset gjeografike si dhe raportet që janë në lidhshmëri me njësitë e përpunuara hapësinore; analizon lidhshmëritë dhe ligjshmëritë gjeografike që shprehen dhe veprojnë brenda këtyre njësive; paraqet aftësitë, shkathtësitë e shprehët, të dinë të shërbehen me to dhe të përvetësojnë mënyrën e të menduarit gjeografik jo shumë të saktë.

Nota 3. Nxënësi i përgjigjet pyetjeve të arsimtarit, por jo mjaftueshëm. Ka shprehje të rrjedhshme dhe deri diku të logjikshme, me ngecje në informacion. Bashkëbisedimin e përcjell më me ngecje nga mungesa e leximit të mjaftueshëm. Oftron faktet gjeografike, njeh disa objekte gjeografike; shpjegon dukuritë dhe proceset gjeografike (ato që i di) si dhe raportet që janë në lidhshmëri me njësitë e përpunuara hapësinore; Paraqet aftësitë, shkathtësitë e shprehët, të dinë të shërbehen me to.

Nota 2. Nxënësi mundohet të bisedojë, ofron fakte gjatë bisedës, por shumë pak. Vërehet mungesa e leximit, nuk i plotëson as 30% të kritereve të lartpërmendura.

Nota 1. Nxënësi nuk u përgjigjet pyetjeve, nuk bashkëbisedon. Nuk i plotëson kriteret e lartpërmendura as 20%.

Pjesa e tretë: Kërkohet nga nxënësit të votojnë për tri punimet më të mira.

Nxënësit me letra ngjitëse me ngjyra, vlerësojnë punimet me pikët 3- e kuqe, 2- e gjelbër dhe 1- e verdhë.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:20

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedisë** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Evropa Mesme, veçoritë natyrore dhe shoqërore të shteteve

Rezultati i të nxënët të temës: Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.

Rezultatet e të nxënët për kompetencat kryesore të shkallës: ~~ashëno~~:

Rezultatet e fushës së kurrikulës: RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.1; 2.2

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Polonia

Fjalët kyçe: Liqenet glaciale fushore, emigracioni, Lufta e dyte botërore, ndryshimet territoriale.

Rezultati/et e të nxënët për orë mësimore:

1. Përkufizon hapësirën e Polonisë dhe identifikojnë shtetet që kufizohen me të në hartë.
2. Përshkruan regionet e Polonisë dhe tregojnë vlerat natyrore dhe shoqërore për ekonominë e vendit.
3. Tregon ngjashmëritë dhe dallimet e popullsisë së Polonisë me popujt përreth.

Kriteret e suksesisit (formohen në klasë së bashku me nxënës):

1. Identifikon regionet e Polonisë;
2. Identifikon pesë qendrat më të njohura të Polonisë;
3. Identifikon lumenjtë më të njohur të Polonisë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore: HISTORI

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Përshkrim dhe identifikim me hartë.

Mësimdhënësi njofton nxënësit me orën e re duke e hapur diskutimin në formën e një pyetje. *Paraprakisht, mësimdhënësi paraqet një hartë të printuar të Polonisë (hartë fizike të pa shkruar).*

-Përdorini atlastet dhe më tregoni se cila hartë është kjo?

-Cili është shteti më i madh që kufizohet me Gjermaninë?


-Nga cili vend vjen Levandovski?

-Kryeqytet i cilit vend është Varshava?

Pasi identifikohet njësia (shteti), nga nxënësit kërkohet të shprehin se çka dinë për Poloni. Kjo bëhet me arsyen për të vlerësuar stadin e njohurive për njësinë mësimore.

Komentet shënohen në tabelë shkurtimi.

Mësimdhënësi së bashku me nxënësit paraqesin kriteret në tabelë ose i sjell të gatshme dhe i shënon që nxënësit ti kenë përpara të përshkruara.



Pjesa e dytë: Arsimtari udhëzon nxënësit që të lexojnë tekstin në heshtje.

Derisa nxënësit lexojnë, arsimtari shënon në tabelë disa pyetje ku nxënësit pas leximit i plotësojnë me ato fragmente që mendojnë se e plotësojnë pyetjen e parashtruar.

Pyetje	Komente (fragmente nga teksti)
1. Sa është sipërfaqja e Polonisë?	312.697km ²
2. Me cilat shtete kufizohet Polonia?	Gjermaninë, Çekinë, Sllovaninë, Rusinë, Bjellorusinë, Ukrainën, Lituaninë

3. Nga e mori emrin Polonia?	Emri Poloni rrjedh nga fjala "pole" që në gjuhën shqipe do të thotë fushë.
4. Pse bregdeti i Polonisë nuk është i përshtatshëm për lundrim?	Ky bregdet është i ulët, pak i përthyer prandaj si i tillë nuk është i përshtatshëm për lundrim.
5. Çfarë klime mbizotëron në Poloni dhe pse?	Kontinentale (tregoni pse?)
6. Cili është lumi kryesor në Poloni?	Vislla është lumi nacional (autokton) i Polonisë, me gjatësi 1.059 km.
7. Në cilin grup të popujve bëjnë pjesë Polakët?	Sllave
8. Me cilat xehe është e pasur Polonia?	Reservat e mëdha të qymyrgutit, qymyrit të murrmë, xeheve të hekurit, kripës së gurit, bakrit, plumbit, zinkut etj. <i>shpjegoni në hartë/atlas zonat</i>

Pjesa e tretë: Punë me fletore pune (detyrë për kohë të caktuar dhe individuale).



Gjej dhe shëno në hartën memece të Polonisë:

- a) Kryeqytetin e Polonisë
- b) Shtetet me të cilat kufizohet
- c) Detin ku del
- d) Lumenjtë Vislla dhe Odra
- e) Malin Tatra

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

DETÝRAT DHE PUNA E PAVARUR

Plotëso fletore pune: 51, 52, 53

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Përkruaj rrjedhën e orës sipas klasave. Paraqit përparësitetë dhe mangësitë për klasat gjatë zhvillimit të orës ose ndonjë specifik të veçantë.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:21

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedisi** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Evropa Mesme, veçoritë natyrore dhe shoqërore të shteteve

Rezultati i të nxënësit të temës:

-Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.

Rezultatet e të nxënësit për kompetencat kryesore të shkallës: **I-1,2,4,6; II-1; III-3,8.**

Rezultatet e fushës së kurrikulës: *RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvorjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.1; 2.2*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Çekia dhe Sllovakia

Fjalët kyçe: Rrafshnalta Çeko-Moravase, Moravia, Karpatet, popullsia sllave, klima kontinentale

Rezultati/et e të nxënësit për orë mësimore:

1. Vlerëson pozitën gjeografike të dy shteteve dhe rolin e saj në zhvillimin e të dy vendeve;
2. Analizon veçoritë natyrore të Çekisë dhe Sllovakisë dhe shpjegon ndikimin e tyre në zhvillimin demografik;
3. Krahason dy shtetet, identifikon të përbashkëtat dhe përshkruan dallimet/specifikat mes tyre.

Kriteret e suksesisit:

1. Identifikon malet kryesore të dy vendeve;
2. Identifikon lumenjtë më të rëndësishëm të dy vendeve;
3. Përshkruan të paktën pesë elemente të përbashkëta për të dy shtetet.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore: HISTORI

PËRSHKRIMI I METODOLOGISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE


Pjesa e parë: Identifikimi i hartave.

Mësimdhënësi paraqet një hartë memece para nxënësve dhe kërkon që të identifikojnë shtetet për cilët bëhet fjalë. Gjithashtu, pasi i identifikojnë shtetet, kërkohet që ti përkufizojnë ato.

Cilat janë këto dy shtete?

Po shtetet që këto dy vende kufizohen, i dini?

Gjeni në atlas faktet dhe statistikat për shtetet.



Kjo formë e punës mund të bëhet kur mësimdhënësi sjell hartën memece në fletë A4 dhe u ndan nxënësve që të punojnë në grupe.

Nxënësit plotësojnë emrat e shteteve dhe me cilat shtete kufizohen ato.

Shtetet përkatëse i etiketon me numër dhe kërkon nga nxënësit që të tregojnë me cilat shtetet kufizohen, gjithnjë duke paraqitur kufizimin sipas anëve të horizontit.

Në pjesën e pasme të fletës, nxënësit shënojnë emrat e tyre që të identifikohen se cilët anëtar (nxënës) ishin.

Pjesa e dytë: (Punë në dyshe) Diagrami i Venit.

Mësimdhënësi ndan nxënësit në grupe dyshe (sipas bankës), ku për secilin e ndan nga një njësi mësimore (shtet) dhe kërkon që të lexojë dhe të nxjerr shënimë sipas elementeve gjeografike:

Pozita, Klima, popullsia dhe ekonomia si dhe të dhëna nga atlati.

Në fazën e dytë kërkohet nga nxënësit ti shpjegojnë pjesën e tyre njëri tjetrit dhe të krahasohen dhe të gjejnë të përbashkëtat në mes të këtyre tri shteteve në formën e diagramit të venit ose në formën e shtyllave vertikale ku në fund të ketë një hapësirë horizontale që të shënohen të përbashkëtat.



Pjesa e tretë: Punë individuale (vlerësim kritik)

Mësimdhënësi formon një tabelë sipas elementeve gjeografik për të tre shtetet dhe kërkon nga nxënësit që në mënyrë individuale të vlerësojnë elementet për shtetet duke u bazuar nga informacionet që fituan nga mësimi. Nxënësit vlerësojnë vendet sipas të dhënavë të nxjerra gjatë krahasimit (fletore e klasës), atlasët dhe hartat. Votimi individual.

Mësimdhënës gjatë votimit, gjithnjë duke respektuar kohën, pyet nxënësit se pse mendoni kështu?

Çka të bënë të vlerësosh kështu?

Në fund pasi del rezultati: A pajtoheni me rezultatin që fituam (diskutim 1-2min)?

Cekia	Relievi-	Klima-	Pasuritë-	Popullsia-	Ekonomia-
Slovakia	Relievi-	Klima-	Pasuritë-	Popullsia-	Ekonomia-

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

DETÝRAT DHE PUNA E PAVARUR

Plotëso fletore pune: 54-63

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:22

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedis** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Evropa Mesme, veçoritë natyrore dhe shoqërore të shteteve

Rezultati i të nxënësit të temës:

-Analizon specifikat natyrore, populitative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur njashmëritë dhe dallimet mes tyre.

Rezultatet e të nxënësit për kompetencat kryesore të shkallës: shëno:

Rezultatet e fushës së kurrikulës: RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvaret dhe ndërveprimet reciproke; 2.1; 2.2

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Sllovenia

Fjalët kyse: Alpet, lumenjtë Sava dhe Drava, sllovenët, "Kryeqytetit të Gjelbër", Jugosllavia

Rezultati/et e të nxënësit për orë mësimore:

1. Vlerëson pozitën gjeografike të Sllovenisë dhe rolin e saj në lidhje me vendet tjera në zhvillimin e vendit;
2. Analizon veçoritë natyrore të Sllovenisë dhe shpjegojnë ndikimin e tyre në zhvillimin demografik;

Kriteret e suksesit:

1. Identifikon qendrat kryesore të Sllovenisë;
2. Identifikon lumenjtë më të rëndësishëm të vendit;
3. Tregon në hartë se me cilat shtete kufizohet.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore:

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: "Asociacion"

Arsintari formon një asociacion në tabelë si vegës që nxënësit të gjejnë njësinë që do zhvillohet dhe të pyesin për rubrikat se çka asocojnë.

A	B	C	D
Alpinë	Shpella e Postonjës	Lubjana	Triglav
SLLOVENIA			

Nëse klasa është a pajisur me projektor dhe internet, identifikon elementet e asociacionit që nxënësit ti shohin se për çfarë bëhet fjalë. Ose formon sipas dëshirës një asociacion.

Alpinë – Shtet alpin

Shpella e Postonjës- Shpellë në Slloveni, rreth 24,340 m gjatësi e sistemit karstik të shpallës.

Lubjana – Kryeqyteti i Sllovenisë

Triglav- Park Nacional i Triglavit(i vetmi në Slloveni)/ maja më e lartë në Alpet Julike 2,864m.

Në fund mësimdhënësi i pyet se si do ta formonit ju një asociacion për Spanjën? Diskutim 2 min.

Pjesa e dytë: Lexim i drejtuar (punë individuale).

Lexohet paragrafi i parë. Kur nxënësit ta përfundojnë leximin e këtij paragrafi mbyllin tekstin.

- Pas këtij leximi, nxënësve u shtrohen pyetjet varësisht nga natyra e përbajtjes:

-Cila është pozita gjeografike e Sllovenisë?

-Cilat tërësi të reliefit i ndanë fusha e Lubjanës?

-Sa është sipërfaqja e Sllovenisë?

-Gjeni në hartë kryeqytetin slloven.

-A mendoni se i përshtatet të thuhet se Sllovenia është shtet alpin?

- Hapa të njëjtë merren edhe tek leximi i pjesës 2, 3... etj.

Para leximit të fundit shtohet edhe pyetja:


- Cila është maja më e lartë në Slloveni?
- Përmend lumenjtë më gjatë të Sllovenisë?
- Pse Sllovenia e ka të zhvilluar industrinë e drurit dhe të mobileve?
- Pse Lubjana quhet "Qyteti i gjelbër"?
- Tregoni të paktën pesë qendra kryesore të Sllovenisë.

Pjesa e tretë: Klaster – pema e mendimeve (puna në dyshe).

Mësimdhënësi në tabelë formon një KLASTER, dhe në qendër të tabelës së zezë shënohet (SLLOVENIA) ku nxënësit formojnë degët me anën e informacionit që kuptuan nga njësia që u zhvillua.

Mësimdhënësi luan rolin e “arbitrit” duke cilësuar njohuritë e shprehura si të përshtatshme ose të përshtatshme për njësinë. Puna që zhvillohet në tabelë të përshkruhet edhe në fletoret e klasës.

Nxënësit aktivizohen vullnetarisht ose aktivizohen nga mësimdhënësi.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

DETÝRAT DHE PUNA E PAVARUR

Plotëso fletore pune: 63-65

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:23

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedis** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Evropa Mesme, veçoritë natyrore dhe shoqërore të shteteve

Rezultati i të nxënësit të temës: *Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.*

Rezultatet e të nxënësit për kompetencat kryesore të shkallës: ~~shëno~~:

Rezultatet e fushës së kurrikulës: RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvorjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.1; 2.2

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Austria

Fjalët kyçe: Shtet alpin, Vjena, Danubi, pasuri xeherore, pyjet, blegtoria intensive.

Rezultati/et e të nxënësit për orë mësimore:

1. Vlerëson pozitën gjeografike të Austrisë dhe tregojnë përparësitet dhe dobësitetë në zhvillimin e vendit;
2. Analizon veçoritë ekonomike të Austrisë dhe shpjegojnë ndikimin e tyre në zhvillimin demografik;

Kriteret e suksesit:

1. Identifikon qendrat kryesore të Austrisë;
2. Tregon në hartë se me cilat shtete kufizohet;
3. Tregon tre kulturat bujqësore të vendit;
4. Tregon pesë resurset natyrore kryesore të Austrisë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore: Histori

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e pare: Diskutim/pëershkim me anën e hartës.

Mësimdhënësi hap diskutimin në klasë përmes disa pyetjeve, ku kërkon nga nxënësit të hapin atlastet te pjesa e Evropës Qendrore.

Cili është që kufizohet me Zvicrën, Sllovaninë dhe Gjermaninë?

Në cilin vend të botës prodhohet pija e njohur energjike Red Bull?

Gjeni në hartë kryeqytetin e Austrisw.

Nxirrini të dhënat/faktet për Austrinë nga pjesa e fundit e atlasëve dhe shënoni në tabelë.

Përgjigjet me interesante dhe logjike, shënohen ne dërrasën e zezë. Kështu pasi që identifikohet shteti, mësimdhënësi njofton nxënësit me njësinë që do zhvillohet.

Pjesa e dytë: INSERT punë individuale

Mësimdhënësi udhëzon nxënësit të lexojnë njësinë e re duke i përdorur shenjat e INSERTIT (V- Informacion i njohur, +- informacion i ri, - informacion që ndryshon nga ai që e di, ?- sqarime për informacion- i paqartë).

Pastaj diskutojnë me radhë se cilat informata ishin të njohura, cilat të reja dhe sqarohen pyetje nga mësimdhënësi të shënuara nga nxënësit.

Aktiviteti të pëershkruehet në tabelë (nga nxënësit) si dhe të pëershkruehet në fletoren e klasës.

V	+	-	?
(V- Informacion i njohur)	(+- Informacion i ri)	(- Informacion që ndryshon nga ai që di)	(?-sqarime për informacionin)

Pjesa e tretë: Detyrë me fletoren e punës (punë individuale).


Gjej dhe shëno në hartën memece të Austrisë:

Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që të plotësohet harta memece sipas kërkesave që janë paraqitur.

Puna zhvillohet individualisht.

- a) Kryeqytetin e Austrisë
- b) Shtet me të cilat kufizohet
- c) Malet Alpe
- d) Luginën e lumit IN

Vlerëso punën e nxënësve dhe mbaj shënim.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

DETÝRAT DHE PUNA E PAVARUR

Plotëso fletore pune: 71-74

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:24

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedisi** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Evropa Mesme, veçoritë natyrore dhe shoqërore të shteteve

Rezultati i të nxënësit të temës: *Analizon specifikat natyrore, popullative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç, duke gjetur ngashmëritë dhe dallimet mes tyre.*

Rezultatet e të nxënësit për kompetencat kryesore të shkallës: **reshëno:**

Rezultatet e fushës së kurrikulës: *RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvorjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.1; 2.2*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Zvicra dhe Lihtenshtejni

Fjalët kyçe: Shtet neutral, alpin, principatë, industria precize, shtet federal, kantone.

Rezultati/et e të nxënësit për orë mësimore:

1. Vlerëson pozitën gjeografike të Zvicrës dhe rolin e saj në zhvillimin e vendit;
2. Analizon veçoritë natyrore të Zvicrës dhe arsyetojnë ndikimin në zhvillimin ekonomik;
3. Analizon strukturën e popullsisë në Zvicër dhe tregon shtrirjen e popullsisë sipas kantoneve.

Kriteret e suksesit:

1. Identifikon qendrat kryesore të Zvicrës;
2. Tregon industritë që shquhet Zvicra;
3. Tregon strukturën e popullsisë së Zvicrës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: *Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.*

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore: **HISTORI**

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: "Asociacion" Individualisht ose sipas rreshtit.

Arsimtari formon një asociacion në tabelë si vegës që nxënësit të gjejnë njësinë që do zhvillohet dhe të pyesin për rubrikat se çka asocojnë.

A	B	C	D
Ora	Konfederata Helvetike	Banka	Alpet
ZVICRA			

Mësimdhënësi pasi që zbulohet asociacioni pyet nxënësit përfjalët kyce:

Çka asocojnë me Zvicrën?

Çka kishit shtuar ose si e kishit formuar ju?

Kështu nxënësit njihen me njësinë e re që do zhvillohet pasi që zbulohet asociacioni. Mësimdhënësi tregon pozitën e Zvicrës në hartë dhe tregon shtetet me cilat përkufizohet ose kërkon nga nxënësit të tregojnë nga ataset se me cilat shtete kufizohet.

Pjesa e dytë: Pyetje dhe komente (punë individuale).

Arsimtari udhëzon nxënësit që të lexojnë tekstin në heshtje dhe individualisht.

Deri sa nxënësit lexojnë, arsimtari shënon në tabelë disa pyetje ku nxënësit pas leximit i plotësojnë me ato fragmente që mendojnë se e plotësojnë pyetjen e parashtruar.


Pyetje	Komente (fragmentë nga teksti)
1. Sa është sipërfaqja e Zvicrës?	
2. Sa është sipërfaqja e Lihtenshtejinit dhe sa banorë jetojnë në të?	
3. Cilat janë qendrat më të njohura në Zvicër?	

4. Me cilat industri shquhet Zvicra?	
5. Çfarë shteti është Zvicra dhe çfarë Lihtenshtejni?	
6. Cilat janë malet në territorin e Zvicrës?	
7. Çfarë klime mbizotëron në Zvicër?	

Pjesa e tretë: Detyrë dhe punë e pavarur.

Gjej dhe shëno në hartën memece të Zvicrës:
Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që të plotësohet harta memece sipas kërkesave që janë paraqitur.
Puna zhvillohet individualisht.

- a) Kryeqytetin e Zvicrës
- b) Shtet me të cilat kufizohet
- c) Pllajën e Mitelandit
- d) Liqeni i Bodenit dhe i Gjenevës
- E) Lihtenshtajni



Për nga organizimi shtetëror, çfarë shtete janë Zvicra dhe Lihtenshtejni?

Vlerëso punën e nxënësve dhe mbaj shënim.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

DETÝRAT DHE PUNA E PAVARUR

Përshkrimi i detyrave në tabelë, përdorimi i atlasit/hartës dhe detyra kryesore, Shkrimi i lirë.

Plotëso fletore pune: 66-70

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:25

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedis** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Evropa Mesme, veçoritë natyrore dhe shoqërore të shteteve

Rezultati i të nxënësit të temës: *Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngashmëritë dhe dallimet mes tyre.*

Rezultatet e të nxënësit për kompetencat kryesore të shkallës:

Rezultatet e fushës së kurrikulës: RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.1; 2.2

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Hungaria

Fjalët kyçe: Liqeni i Balatonit, pylli i Bakonjës, Ultësira e Panonisë, ugrofin, Danubi

Rezultati/et e të nxënësit për orë mësimore:

1. Vlerëson pozitën gjeografike të Hungarisë, lidhjen me shtetet tjera dhe rolin e saj në zhvillimin e vendit;
2. Analizon veçoritë natyrore të Hungarisë dhe arsyetojnë ndikimin në zhvillimin ekonomik të vendit;

Kriteret e suksesisit:

1. Identifikon qendrat kryesore të Hungarisë;
2. Identifikon tri tërësítë gjeografike të Hungarisë;
3. Tregon pesë resurset kryesore që shquhet Hungaria.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore: HISTORI

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Diskutim duke përshkruar hartën (punë individuale).

Mësimdhënësi fillon orën mësimore duke u drejtuar nxënësve me pyetje.

Cili është liqeni më i madh në Evropën e Mesme?


Cilët popuj në Evropë i takojnë grupit ugrofin?

Nga cili shtet vinte legjenda e futbollit Franc Pushkash?

Paraqit fjalët kyçe nëse u nevojiten si ndihmë: *Liqeni i Balatonit, pylli i Bakonjës, Ultësira e Panonisë, ugrofin, Danubi...*

Pasi identifikohet shteti, mësimdhënësi së bashku me nxënësit identifikojnë edhe në hartë/atlase dhe tregojnë se me cilat shtete kufizohet, cilat janë faktet dhe statistikat e shtetit në atlas.

-Pyetja e fundit u bëhet se çfarë dini për Hungarinë?



Pjesa e dytë: KLASTER (pune individuale)

Mësimdhënësi udhëzon nxënësit të lexojnë pjesën (tekstin) e njësisë mësimore që do të zhvillohet. Pasi që lexohet, në tabelë formohet KLASTERI, dhe në qendër të tabelës së zezë shënohet (HUNGARIA) ku nxënësit formojnë degët me anën e informacionit që kuptojnë nga leximi i pjesës.

Mësimdhënësi luan rolin e "arbitrit" duke cilësuar njojuritë e shprehura si të përshtatshme ose të pa-përshtatshme për njësinë. Puna që zhvillohet në tabelë të përshkruhet edhe në fletoret e klasës.

Nxënësit aktivizohen vullnetarisht ose aktivizohen nga mësimdhënësi.



Pjesa e tretë: Të nxënët (përbledhja e mësimit)

bëhet sipas lojës në role. Mësimdhënësi ndan nxënësit në grupe me nga 3 pjesëtar. Grupi formon pyetjet (3-5) vetë ose i merr të gatshme nga fletore pune.

A-Intervistuesi

B-Shënesi

C-Personi që intervistohet

Intervistuesi formon 4 pyetje të cilat ia drejton personit që do intervistohet (nxënësit C). Deri sa këta të dy kryenin aktin e tyre, nxënësi B nxjerr shënimë në një fletë dhe i dorëzon tek arsimtari si detyrë e grupit.


VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Plotëso:



ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:26

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedisi** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Evropa Mesme, veçoritë natyrore dhe shoqërore të shteteve

Rezultati i të nxënëtit të temës: *Analizon specifikat natyrore, populitative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngashmëritë dhe dallimet mes tyre.*

Rezultatet e të nxënëtit për kompetencat kryesore të shkallës: **shëno:**

Rezultatet e fushës së kurrikulës: *RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.1; 2.2*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Rumania

Fjalët kyçe: Karpatet, Transilvania, Dobruha, nafta, gjuha latine

Rezultati/et e të nxënëtit për orë mësimore:

1. Vlerëson pozitën gjeografike të Hungarisë dhe arsyetojnë rolin e saj në zhvillimin e vendit;
2. Analizon veçoritë natyrore të Hungarisë dhe arsyetojnë ndikimin në zhvillimin ekonomik të vendit;

Kriteret e suksesit:

1. Identifikon qendrat kryesore të Rumanisë;
2. Identifikon tri tërësítë gjeografike të Rumanisë;
3. Tregon pesë resurset kryesore që shquhet Rumania.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore: HISTORI

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Diskutim duke përdorur hartën.

Mësimdhënësi shënon në tabelë RUMANIA

Pasi identifikohet shteti, mësimdhënësi së bashku me nxënësit identifikojnë edhe në hartë/atlase dhe tregojnë se me cilat shtete kufizohet.

Pasi që nxënësit identifikojnë shtetin për të cilin do mësohet, mësimdhënësi u drejtohet me pyetje për të njohur nivelin e nxënësve se çfarë dinë për këtë shtet.


Çfarë dini për Rumaninë?

Cili është shteti i fundit që kalon Danubi?

Cila pjesë e Rumanisë përfshihet në Gadishullin Ballkanik?

Ne cilin det ka dalje Rumania?

Mësimdhënësi jep shpjegime shtesë pas çdo bisede ose përgjigje nga nxënësit.



Pjesa e dytë: KLASTER (pune individuale)

Mësimdhënësi udhëzon nxënësit të lexojnë pjesën (tekstin) e njësisë mësimore që do të zhvillohet. Pasi që lexohet, në tabelë formohet KLASTERI, dhe në qendër të tabelës së zezë shënohet (Rumania) ku nxënësit formojnë degët me anën e informacionit që kuptojnë nga leximi i pjesës.

Mësimdhënësi luan rolin e "arbitrit" duke cilësuar njohuritë e shprehura si të përshtatshme ose të pa-përshtatshme për njësinë. Puna që zhvillohet në tabelë të përshkruhet edhe në fletoret e klasës.

Nxënësit aktivizohen vullnetarisht ose aktivizohen nga mësimdhënësi.




Mund të shtohen edhe pyetje tjera, gjithnjë duke synuar përfitimin e njohurive nga teksti bazë ose ataset.

Pjesa e tretë: Plotësim i fletore pune (Detyrë individuale).

Emëroni vendet në hartë sipas numrave përkatës (koha 5 min.).

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. Lumi _____



Të vlerësohen shtetet e fundit sipas elementeve të paraqitur

në tabelë dhe të arsyetohet vota e vlerësimit nga nxënësit me një koment të shkurtër.

	Pozita	Relievi	Klima	Ujrat	Ekonomia
Hungaria					
Rumania					

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

DETÝRAT DHE PUNA E PAVARUR

Përshkrimi i detyrave të klasës dhe përdorimi i hartës/atlasit

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:27

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedisi** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Evropa Perëndimore, veçoritë natyrore	Rezultati i të nxënëtit të temës: <i>Vlerëson rëndësinë e pozitës gjeografike të Evropës Perëndimore dhe rolin e saj për Evropën në përgjithësi.</i> <i>Vlerëson se çfarë ishte roli i pozitës gjeografike në ngjarjet historike të Evropës Perëndimore.</i> <i>Arsyeton rëndësinë e detit për jetën dhe në luftën e njerëzve me të.</i> <i>Vlerëson rëndësinë e Oqeanit dhe të rrymës së Golfit në klimë dhe në jetën e njerëzve.</i> <i>Identifikon malet më të njohura molloke, të reja, fushat, polderët dhe luginat lumore.</i> <i>Arsyeton rolin e grykave të lumenjve në formë të hinkës (estuareve) për lundrim.</i>
--	---

Rezultatet e të nxënëtit për kompetencat kryesore të shkallës: **shëno:**

Rezultatet e fushës së kurrikulës: **RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvaret dhe ndërveprimet reciproke; 2.1; 2.2**

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Evropa Perëndimore – veçoritë natyrore

Fjalët kyçe: "Dritare e Evropës në botë", Shtete me zhvillim të lartë ekonomik, Atlantiku, klima oqeanike

Rezultati/et e të nxënëtit për orë mësimore:

1. Vlerëson rëndësinë e Oqeanit dhe të rrymës së Golfit në klimë dhe bregdetin e Evropës Perëndimore;
2. Identifikon malet më të njohura molloke, të reja, fushat, polderët dhe luginat lumore në hartën fiziko-gjeografike të Evropës Perëndimore;
3. Arsyeton rolin e grykave të lumenjve në formë të hinkës (estuareve) për lundrim dhe në ekonomi.

Kriteret e suksesisit:

1. Identifikon shtetet e Evropës Perëndimore.
2. Identifikon detet dhe oqeanet që lagin regjionin.
3. Përshkruan në hartë shtrirjen e maleve të reja dhe të vjetra në Ev. Per.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore: Histori

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Identifikim i hartës.

Mësimdhënësi paraqet hartën e Evropës Perëndimore.

Cilët shtete janë (pa Spanjën dhe Portugalinë) pjesë e Evropës Perëndimore (identifikoni)?

Pyetje për diskutim:

- Gjatë bisedave me shokët ose shoqet, familjarë ose dikush nga nxënësit që keni vizituar këto vendet, cila është përshtypja?
- Nga mësimet paraprake, çfarë klime mbizotëron në këtë hapësirë?

Kështu pasi që nxënësit i identifikojnë, mësimdhënësi i njofton me njësinë që do zhvillohet.

Pjesa e dytë: Punë individuale- Lexim i drejtuar

Mësimdhënësi drejton njërin nga nxënësit ose lexon vetë me zë pjesën e njësisë (mësimit).

- Pas këtij leximi, nxënësve u shtrohen pyetjet varësisht nga natyra e përmrbajtjes:



*Prej cilëve shtete përbëhet Evropa Jugore?
Cilët element natyrore dallohen në reliefin e E.P?*

...

Nxënësit gjatë kësaj kohe përdorin ataset e tyre.

• Fjalët kyçë ose ato referenca interesante, shënohen në tabelë.

• Hapa të njëjtë merren edhe tek leximi i pjesës/paragrafit 2, 3... Para leximit të fundit shtohet edhe pyetja:

Cila është rëndësia e Atlantikut?

Çfarë klime dominon në E. Perëndimore?

Cilët janë malet kryesore në E.P (malet e reja dhe të vjetra)?

Tregoni në hartë ultësirat.

Cili është mali më i lartë në Evropën Perëndimore dhe ku gjendet?

...

• Pas leximit të fundit, nxënësve mësimdhënësi duhet të jap mundësi që ata të flasin me njëri tjetrin e jo përmes ti. Këtë e arrin duke dhënë pyetjet dhe duke miratuar përgjigjet me lëvizje të kokës.

Pjesa e tretë: (punë individuale) Reflektim me fletore të punës.

Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që të plotësojnë në klasë fletoren e punës, pjesën ku i takon Evropës perëndimore. Puna duhet të jetë e pavarur dhe individuale dhe të kryhet për kohë të caktuar.

Nga detyra 82-87. Gjithashtu gjatë punës, ushtronhet me hartën e Evropës perëndimore.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

DETÝRAT DHE PUNA E PAVARUR

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:28

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedis / Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 / Klasa: 7

Tema: Evropa Perëndimore, veçoritë natyrore

Rezultati i të nxenit të temës: Vlerëson rëndësinë e pozitës gjeografike të Evropës Perëndimore dhe rolin e saj për Evropën në përgjithësi.
-Vlerëson se çfarë ishte roli i pozitës gjeografike në ngjarjet historike të Evropës Perëndimore.
-Arsyeton rëndësinë e detit për jetën dhe në luftën e njerëzve me të.

Rezultatet e të nxenit për kompetencat kryesore të shkallës: ~~ashëno~~:

Rezultatet e fushës së kurrikulës: RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.1; 2.2

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrime - Evropa Perëndimore (veçoritë natyrore)

Fjalët kyçe: "Dritare e Evropës në botë", Shtete me zhvillim të lartë ekonomik, Atlantiku, klima oqeanike

Rezultati/et e të nxenit për orë mësimore:

1. Vlerëson rëndësinë e Oqeanit dhe të rrymës së Golfit në klimë dhe në jetën e njerëzve në Evropën Perëndimore;
 2. Identifikon në hartë malet më të njohura molloke, të reja, fushat, polderët dhe luginat lumore;
- Kriteret e suksesit:
1. Identifikon në hartë shtetet e Evropës Perëndimore;
 2. Tregon pesë lumenjtë kryesor;
 3. Përshkruan sipas hartës malet e reja dhe të vjetra.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore:

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Loja me letra ngjitëse (punë në grupe) 4 nxënës.

Mësimdhënësi përgatit disa letra ngjitëse me ngjyra ku në to shënon elemente fiziko-gjeografike që lidhen me Evropën Perëndimore.

I ndan nxënësit në katërshe dhe kërkon nga ata që për një kohe rreth dy minutash të identifikojnë kërkesat që janë shënuar në letra dhe ti vendos (ngjisin) në hartë në pjesën përkatëse. Secilit grup i përgatit letrat me ngjyrën përkatëse.

Grupi 1	Grupi 2	Grupi 3	Grupi 4
Uellsı	Irlanda Veriore	Belgjika	Luksemburgu
Lumi Sena	Bordo	Masivi Qendror	Gjiri Biskajes
Vogezet	Ardenet	Pirinejet	Temza
Kanali LaMansh	Mont Blank	Malet Kambriane	Irlanda
Malet Kaleodone	Lumi Rin	Amsterdami	Korsika

Pjesa e dytë: Shkrim i lirë (15')

Tema: Evropa Perëndimore (përmblehdje pa libër, me atlas)


Gjatë shkrimit të lirë, nxënësit shkruajnë pa u ndalur, me qëllim që të shkruarit e tyre të burojë në mënyrë të tillë që ata të mos kenë frikë nga kritikat dhe korrigjimet

Fletat dorëzohen dhe merren në shtëpi nga arsimtari që t'i vlerësojë.

Pjesa e tretë: Mësimdhënësi përzgjedh disa punime/shkrimet më të mira dhe kërkon nga ata që të lexojnë tekstin e shkruar. Secili punim vlerësohet me notë dhe mbahet shënim në listën e kontrollit.

Nga nxënësit e tjerë kërkon që të reagojnë nëse ka diçka gabim ose edhe të shtojnë diçka nëse kanë për të shtuar.

Detyra: Secili nxënës në mënyrë individuale të përshkruaj rrugën nga pika A deri në pikën B se në cilët shtetet ka kaluar me radhë A-B. (2min).



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

DETÝRAT DHE PUNA E PAVARUR

shëno:

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:29

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedis** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Evropa Veriore dhe Verilindore, veçoritë shoqëroro ekonomike	Rezultati i të nxënëtit të temës: -Analizon shtrirjen gjeografike të Evropës Veriore dhe Verilindore. -Vlerëson ndikimin e detit dhe klimës në këtë region gjeografik. -Arsyeton ndryshimet e mëdha në relief si rezultat i ndikimit të akullnajave. -Përshkruan relievin malor, rrafshnaltat malore, fjordet, fushat dhe pyjet. -Dallon tiparet e klimës dhe dallimet e saja nga Atlantiku e deri te tajgat ruse. -Arsyeton shkaqet e lumenjve të shkurtër, me shumë ujë dhe me fuqi të madhe energetike. -Dallon ndërrimin e bimësisë dhe të kafshëve nga veriu e deri në jug dhe nga perëndimi në drejtim të lindjes.
---	--

Rezultatet e të nxënëtit për kompetencat kryesore të shkallës: shëno:

Rezultatet e fushës së kurrikulës: RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvorjet dhe ndërvëprimet reciproke; 2.1; 2.2

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Evropa Veriore dhe Verilindore (shtetet baltike) – veçoritë natyrore

Fjalët kyçe: Gadishulli Skandinav, Baltiku, fjordet, gejzeret, vullkanet, Aurora borealis (dritat polare)

Rezultati/et e të nxënëtit për orë mësimore:

Sqarim: Rezultati/et e të nxënëtit për orë mësimore nuk paraqitet nëse të njëjtat janë përfshirë te "Rezultatet e të nxënëtit të temës". Kjo bëhet me arsyen që të mos përsëriten/riplëshkruhen dhe të ngarkohet planifikimi. Nëse mësimdhënësi mendon që i duhen edhe rezultate shpeshtë për të specifikuar aktivitetin dhe punën e nxënësve gjatë orës, atëherë ai paraqet "Rezultatet e të nxënëtit për orë mësimore".

Kriteret e suksesit:

Sqarim: Kriteret duhet të përpilojnë së bashku me nxënësit në klasë. Mësimdhënësi mund t'i përpilojë edhe në shtëpi dhe t'i sjellë të gatshme atëherë kur njësia është e gjatë dhe dëshiron të kursejë kohën. Kriteret duhet t'i shërbejnë Rezultateve të orës mësimore.

Shembull:

1. Identifikon shtete e Evropës Veriore dhe Verilindore;
2. Tregon tre specifika të përbashkëta klimatike për shtetet;
3. Identifikon pesë specifika relievore të shteteve;
4. Tregon të paktën pesë të përbashkëta të shteteve skandinave.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore:

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE


Pjesa e parë: Mësimdhënësi paraqet në tabelë fjalët kyçe, si:

Gadishulli Skandinav, Baltiku, fjordet, gejzeret, vullkanet, Aurora borealis (dritat polare)...

Kërkon nga nxënësit të përshkruajnë se cilën fjalë kyçe dhe të identifikojnë regjionin me të cilin asocojnë këto fjalë.

Kështu ngjallet biseda dhe pasi që arrihet të identifikohet regjioni, nxënësve u tregohet se çka do mësojnë saktësish duke kërkuar të gjinden në hartën e punës.

Njëherit, nxënësit identifikojnë shtetet e Ev. Veriore dhe shtetet me të cilët kufizohen ose në cilët dete kanë dalje..



Pjesa e dytë: Mësimdhënësi drejton njërin nga nxënësit ose lexon vetë me zë pjesën e njësisë (mësimit).


- Pas këtij leximi, nxënësve u shtrohen pyetjet varësish nga natyra e përbajtjes:
 - Prej cilëve shtete përbëhet Evropa Veriore (skandinave)? Identifiko me hartë.
 - Cilët element natyrore dallohen në reliefin e E.V?...
- Nxënësit gjatë kësaj kohe përdorin ataset e tyre.
- Fjalët kyçë ose ato referenca interesante (skandinave, vikingët, gadishulli Skandinav, aurora borealis...) shënohen në tabelë.
- Hapa të njëjtë merren edhe tek leximi i pjesës/paragrafit 2, 3... Para leximit të fundit shtohet edhe pyetja:
 - Cila është rëndësia e Atlantikut?
 - Cila është rëndësia e Rrymës së golfit për bregdetin e Norvegjisë?
 - Çfarë klime dominon në E. Veriore sipas shteteve?
 - Çfarë relieve kanë shtetet e Evropës Veriore?
- Pas leximit të fundit, nxënësve mësimdhënësi duhet të jap mundësi që ata të flasin me njëri tjetrin e jo përmes ti. Këtë e arrin duke dhënë pyetjet dhe duke miratuar përgjigjet me lëvizje të kokës.

Pjesa e tretë: Klaster (puna në dyshe).

Mësimdhënësi në tabelë formon një KLASTER, dhe në qendër të tabelës së zezë shënohet (Evropa Veriore) ku nxënësit formojnë degët me anën e informacionit që kuptuan nga njësia që u zhvillua.

Mësimdhënësi luan rolin e "arbitrit" duke cilësuar njohuritë e shprehura si të përshtatshme ose të pa-përshtatshme për njësinë. Puna që zhvillohet në tabelë të përshkruhet edhe në fletoret e klasës.

Nxënësit aktivizohen vullnetarisht ose aktivizohen nga mësimdhënësi.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:30

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedis** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Evropa Veriore dhe Verilindore, veçoritë natyrore	Rezultati i të nxënëtit të temës: <i>Identifikon popujt që e banojnë këtë regjion dhe veçoritë e tyre demografike, kulturore dhe ekonomike.</i> <i>-Vlerëson rolin e pasurive dhe kushteve natyrore me strukturën e ekonomisë së këtyre vendeve.</i> <i>-Nxjerr përfundime pozitive si kanë arritur njerëzit nivelin e lartë të zhvillimit kulturor e ekonomik në kushte të vështira natyrore.</i>
---	---

Rezultatet e të nxënëtit përkompeticat kryesore të shkallës: **shëno:**

Rezultatet e fushës së kurrikulës: *RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvorjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.1; 2.2*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Evropa Veriore dhe Verilindore (Veçoritë shoqërore dhe ekonomike)

Fjalët kyçe: Vikingët, deti Baltik, Gadishulli Skandinav, protestante, shtete sociale, mbretëri...

Rezultati/et e të nxënëtit për orë mësimore:

1. Vlerëson rëndësinë e pasurive natyrore në zhvillimin ekonomik të vendeve
2. Identifikon në hartë shtetet e Evropës Veriore dhe të regjionit Evropës Verilindore;

Kriteret e suksesit:

1. Identifikon shtete e Evropës Veriore dhe verilindore;
2. Identifikon shtetet anëtare në BE-së;
3. Identifikon shtete që janë pjesë e NATO-s;

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore: HISTORI

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Punë në grupe (3-4 nxënës) Galeria e fotografive.

Si fillim, mësimdhënësi paraqet një fotografi ku paraqiten flamuj të shteteve të Evropës Veriore dhe verilindore si dhe fotografi që karakterizojnë ndonjërin nga shtetet. Nga nxënësit kërkohet që në fund të atlasit të gjinden këta flamuj, të tregohet identiteti dhe në pusulla të shënohen faktet për shtetet:

Sipërfaqja, numri i banorëve, dendësia, monedha dhe kryeqyteti.

Nëse dikush din më shumë për shtetet mund të shënohen edhe ato si informacione shtesë.



Mësimdhënësi së bashku me nxënësit paraqesin kriteret në tabelë ose i sjell të gatshme dhe i shënon që nxënësit ti kenë përparrë të përshkruara.

Pjesa e dytë: Pyetje dhe komente (punë individuale).


Arsintari udhëzon nxënësit që të lexojnë tekstin në heshtje dhe individualisht. Deri sa nxënësit lexojnë, arsimtari shënon në tabelë disa pyetje ku nxënësit pas leximit i plotësojnë me ato fragmente që mendojnë se e plotësojnë pyetjen e parashtruar.

Pyetje	Komente (fragmente nga teksti)
1. Cilat janë shtetet e Evropës veriore dhe verilindore?	
2. Renditni shtetet nga më së shumti deri në atë me më pak banorë?	
3. Tregoni origjinën e popujve të Ev. Veriore?	
4. Tregoni specifikat ekonomike që shquhen shtetet?	
5. Cilat janë shtetet Baltike?	
6. Në cilat organizata janë të anëtarësuara vendet e Evropës Veriore e Verilindore ?	
...	

Pjesa e tretë: Plotësim i fletore punës (punë individuale).

Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që të plotësojnë në klasë fletoren e punës. Nga detyra për Evropën Veriore dhe verilindore 89-119. Nëse nuk del koha, mësimdhënësi u jep si detyrë shtëpie të plotësohet pjesa e Evropës Veriore dhe Verilindore.

Gjithashtu gjatë punës, ushtrohet me hartën/atlas e Evropës Veriore dhe Verilindore.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:31

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedis** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Evropa Veriore dhe Verilindore, veçoritë natyrore

Rezultatet e të nxënësit për kompetencat kryesore të shkallës:

Rezultatet e fushës së kurrikulës: *RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.2.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përforcim

Rezultati/et e të nxënësit për orë mësimore:

- Identifikon elementet gjeografike sipas kërkesave që paraqiten gjatë vlerësimit në bashkëpunim me nxënësit e tjerë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Punë individuale duke diskutuar në grup në formën e stuhisë së mendimit. Mësimdhënësi paraqet në projektor një hartë memece të Evropës, ku me të njëjtën i pajis edhe nxënësit me fletë A4 të printuar. Si detyrë realizohet duke bashkëpunuar me shkëmbim të njohurive duke ngjyrosur shtetet me ngjyrën e regionit përkatës. Te identifikoohen shtetet dhe elementet të cilët mësimdhënësi përzgjedh sipas numrit.



2. Shënoni shtetet nëpër të cilat kalon Danubi?

3. Përshkruaj dallimin në mes klimës oqeanike dhe kontinentale.

4. Emri Evropë rrjedh nga fjala asire _____, që do të thotë _____.
Këtë emërtim nga asirët e vjetër e kanë marrë popujt e _____ dhe _____.

5. Nga cilat male ndahet Evropa nga Azia?
6. Cili është mali më i lartë në Evropë dhe cili në Evropën Perëndimore?
7. Cili është lumi më i gjatë i Evropës?
8. Cila është origjina e popujve evropian dhe sa grupeve u takojnë?
9. Grupit të popullsisë sllave, cilët popuj i takojnë?
10. Cilët popuj janë ugrofinë?
11. Cili është dallimi në mes monarkisë dhe republikës?
12. Në cilën pjesë të Evropës ndodhet Masivi Qendrore?
13. Çka paraqesin Tajgat?
14. Çka paraqesin Fjordet?
15. Si quhet ngushtica e cila ndanë Evropën nga Afrika (Maroku)?
16. Çka është Rryma e Golfit?
17. Etna dhe Vezuvi, në cilin gadishull gjinden dhe çka janë?
18. Në Danub ndodhen këto kryeqytete të Evropës së Mesme.
a-Vjena; b-Berlini; c-Varshava; d-Beograd; e-Bratislava; f-Bukureshti;
19. Cili është qyteti më i madh i krahinës së Bavarisë?
20. Sllovenisë i takojnë pjesë të:
 - a) Bregdetit Adriatik
 - b) Karpateve
 - c) Alpeve
 - d) Ultësirës së Panonisë
 - e) Bregdetit Jon

etj...

TESTIM i parë

RREGULLAT GJATË TESTIMIT

•Mos komunikon me shoqen apo shokun; •Kujdes në rrumbullakimin e alternativave; •Vetëm një alternativë është e saktë; •Shëno shkrimin e lexueshëm; Mos e dërmto testin; •Respektoje kohën.

No. 32

Tema: 1: Evropa (40%) 2:Evr. Jugore (10%) 3: Evr.e Mesme (20%) 4:Evropa Perë.(20%) 5: Evr. Veriore(10%)

--SHEMBULL--

Sqarim: Testi shërben vetëm si shembull. Mësimdhënës i mbetet të formulojë një test të tillë duke ia përshtatur temave të tyre.

Klasa – IX		Emri dhe Mbiemri: _____	Pikët				
1	Kontinenti i Evropës e ka marrë emrin nga fjala e vjetër asire “_____” që do të thotë tokë e daljes/perëndimit të Diellit: a) Ereb b) Vereb c) Elbrus d) Everlast		8				
2	Cili region gjeografik i Evropës është paraqitur me ngjyrë të kuqe ne fotografi (hartë)?		8				
3	Bashko me vija vendet sipas logjikës gjeografike: a. Gadishulli Iberik b. Gadishulli Skandinav c. Franca	Evropa Veriore Evropa Jugore Evropa Perëndimore	9				
4	Nëse ndodheni në Gjibraltar, atëherë qyteti i Reikjavikut për ju është në:	a) veri b) perëndim c) lindje	9				
5	Cila nga alternativat e paraqet të saktë kuptimin për POLDERET:	a) Janë male të vjetra të pasura me xehe hekuri; b) Janë formacione bimore në veri të tajgës; c) Janë toka nën nivelin e detit.	9				
6	Përshkruani rrjedhën e lumit Danub gjatë tërë territorit Evropian (shtetet).	_____	10				
7	Analizo grafikun dhe tregoni se çka nuk është në rregull me hartën (dy elemente): _____, _____		11				
8	<i>Rendit elementet përkatëse në regjionin përkatës.</i>	<table style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="width: 30%; vertical-align: top;"> Evropa Perëndim. <i>Alpet Evropiane</i> <i>4808m</i> </td><td style="width: 30%; vertical-align: top;"> Gjermania Sena Masivi Qendoror La Mansh Luksemburgu </td><td style="width: 30%; vertical-align: top;"> Irlanda Temza Shvarcvald Adriatiku Polonia </td><td style="width: 30%; vertical-align: top;"> Evropa e Mesme </td></tr> </table>	Evropa Perëndim. <i>Alpet Evropiane</i> <i>4808m</i>	Gjermania Sena Masivi Qendoror La Mansh Luksemburgu	Irlanda Temza Shvarcvald Adriatiku Polonia	Evropa e Mesme	11
Evropa Perëndim. <i>Alpet Evropiane</i> <i>4808m</i>	Gjermania Sena Masivi Qendoror La Mansh Luksemburgu	Irlanda Temza Shvarcvald Adriatiku Polonia	Evropa e Mesme				
9	<i>Plotëso tabelën duke shfrytëzuar fjalët kyçë që janë dhënë dhe jepi kuptim asocacionit.</i>	Itali-Francë Lumi Arve	12				

10

Vlerësoni rolin e Rrymës se Golfit për klimën dhe aktivitetet njerëzore në Evropë _____

13

Përgindja	0 - 39 %	40% - 59 %	60% - 79%	80% - 89%	90% - 100%	Pikët: ()
Pikët	0 -39 pikë	40 - 59 pikë	60 - 79 pikë	80 - 89 pikë	90 - 100 pikë	
Nota	1	2	3	4	5	()

Shenjat korigjuese: ✓- e saktë, ✗- e pasaktë, ~- e paplotësuar Mësimdhënësi:

► Nëse është mundësia që testi të bëhet me dy fletë, atëherë njëren pjesë e plotësojmë vetëm me harta

Tabela e testit për vlerësim numerik të pyetjeve sipas niveleve - Klasa VII

Fusha/Tema mësimore	Njohja	Të kuptuarit	Zbatimi	Mendimi kritik	Shuma 100%
Kontinenti i Evropës	40%	1 (8p)	1 (9p)	Analizë - 1 (11p) Vlerësim - 1 (13p)	4 (41p)
Evropa Jugore	10%	1 (8p)			1 (8p)
Evropa Perëndimore	20%		1 (9 p)	Sintezë - 1 (12p)	2 (21p)
Evropa e Mesme	20%			1 (10 p) 1 (11 p)	2 (21p)
Evropa Veriore	10%		1 (9 p)		1 (9p)
	16 pikë	27 pikë	21 pikë	36 pikë	100 pikë

Vërejtje: Testi si instrument i paraqitur në librin e mësuesit është vetëm një shembull dhe është i njëjtë në të tri periudhat. Planet ditore janë reshtuar mbi bazën e renditjes së Programit Lëndor (të bëhet korrelacion me lëndët e tjera të fushës) për këtë arsy e nuk është paraqitur test i rregullt (me përjashtim të periudhës së parë) sepse mësimdhënësi është autonom të planifikoj dhe të zgjedh renditjen duke i ndërlidhur pjesët (regjionet, shtetet) natyrore-shoqërore-ekonomike me njëra tjetrën.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:33

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedisi** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Evropa Veriore dhe Verilindore

Rezultati i të nxënët të temës: *Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.*

Rezultatet e të nxënët për kompetencat kryesore të shkallës: ~~shëno~~:

Rezultatet e fushës së kurrikulës: RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvorjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.1; 2.2

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Suedia dhe Norvegjia

Fjalët kyçe: Alpet Skandinave, fjorde, shtete sociale, mbretëri, Çmimi Nobel

Rezultati/et e të nxënët për orë mësimore:

1. Vlerëson pozitën gjeografike të shteteve Skandinave (Norvegjisë dhe Suedisë) dhe tregon ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.
2. Shpjegon nivelin e lartë të zhvillimit ekonomik dhe tregon ndikimin në zhvillimin demografik të vendeve.

Kriteret e suksesit:

1. Identifikon industritë që shquhen të dy vendet;
2. Identifikon pesë qendrat më të mëdha për të dy vendet;
3. Tregon të paktën pesë ngjashmëri për të dy vendet.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndet tjera mësimore dhe/ apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore:

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Identifikimi i hartës (përshkrim i hartës).

Mësimdhënësi paraqet një hartë memece (të shtypur) ose harta tjera para nxënësve dhe kërkon nga ta që të identifikojnë shtetet (sipas ngjyrës që paraqet territorin sovran) për cilët bëhet fjalë.

Gjithashtu, pasi që i identifikojnë, kërkon nga ta që të përkufizohen të dy shtetet dhe të tregojnë se në cilat dete kanë dalje.

Në fund të atlaseve nxënësít tregojnë faktet që shënohen për të dy shtetet.

Sipërfacja, numri i banorëve, dendësia dhe kryeqyteti.




Pjesa e dytë: (Punë në dyshe) Diagrami i Venit.

Mësimdhënësi ndan nxënësit në grupe dyshe (sipas bankës), ku për secilin e ndan nga një njësi mësimore (shtet) dhe kërkon që të lexojë dhe të nxjerr shënimë sipas elementeve gjeografike:

Pozita, Klima, popullsia dhe ekonomia si dhe të dhëna nga atlati.

Në fazën e dytë kërkohet nga nxënësit ti shpjegojnë pjesën e tyre njëri tjetrit dhe të krahasohen dhe të gjejnë të përbashkëtat në mes të këtyre tri shteteve në formën e diagramit të venit ose në formën e shtyllave vertikale ku në fund të ketë një hapësirë horizontale që të shënohen të përbashkëtat.



Pjesa e tretë: Punë individuale (vlerësim kritik)

Mësimdhënësi formon një tabelë sipas elementeve gjeografike për të tre shtetet dhe kërkon nga nxënësit që në mënyrë individuale të vlerësojnë elementet për shtetet duke u bazuar nga informacionet që fituan nga mësimi. Nxënësit vlerësojnë vendet sipas të dhënavë të nxjerra gjatë krahasimit (fletore e klasës), atlasët dhe hartat. Votimi individual.

Mësimdhënës gjatë votimit, gjithnjë duke respektuar kohën, pyet nxënësit se pse mendoni kështu? Çka të bënë të vlerësosh kështu?

Në fund pasi del rezultati: A pajtoheni me rezultatin që fituan (diskutim 1-2min)?

Suedia	Relievi-	Klima-	Pasuritë-	Popullsia-	Ekonomia-
Norvegjia	Relievi-	Klima-	Pasuritë-	Popullsia-	Ekonomia-

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

DETÝRAT DHE PUNA E PAVARUR

Plotëso Fletore pune 97, 98, 99.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:34

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedisi** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Evropa Veriore dhe Verilindore	Rezultati i të nxënëtit të temës: <i>Analizon specifikat natyrore, populitative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.</i>
--------------------------------------	--

Rezultatet e të nxënëtit përkompitet kryesore të shkallës: **ashëno:**

Rezultatet e fushës së kurrikulës: *RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.1; 2.2*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Danimarka

Fjalët kyçe: Gadishull, bujqësi e zhvilluar, ishujt, Skandinavia, vikingët, mjedisi dhe energjia

Rezultati/et e të nxënëtit për orë mësimore:

1. Vlerësojnë pozitën gjeografike të Hungarisë dhe rolin e saj në zhvillimin e vendit;
2. Analizojnë veçoritë natyrore të Danimarkës dhe arsyetojnë ndikimin në zhvillimin ekonomik;

Kriteret e suksesit:

1. Identifikojnë qendrat kryesore të Danimarkës;
2. Identifikojmë tri têrësítë gjeografike të Danimarkës;
3. Tregojnë pesë resurset kryesore që shquhet Danimarka.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndat e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore:

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: "Asociacion"

Arsintari formon një asociacion në tabelë si vegës që nxënësit të gjejnë njësinë që do zhvillohet dhe të pyesin për rubrikat se çka asocojnë.

"Rene Rexhepi është ndër kuzhinierët më të shquar në botë i cili jeton dhe vepron në Danimarkë me restorantin e tij të famshëm NOMA. Rene është me origjinë shqiptare nga Maqedonia"

A	B	C	D
Rene Rexhepi	Jutland	Kategat	Kopenhagëن
DANIMARKA			

Nëse klasa është a pajisur me projektor dhe internet, identifikon elementet e asociacionit që nxënësit ti shohin se përfundojnë rreth këtyre temave.

"Rene Rexhepi:- Kuzhinier i njohur botëror me prejardhje nga viset shqiptare (danez).

Jutland- Gadishulli më i madh në Danimarkë

Kategat - Ngushticë detare që e ndan Danimarkën nga Suedia

Kopenhagën- Kryeqyteti i Danimarkës

Në fund mësimdhënësi i pyet se si do ta formonit ju një asociacion për Danimarkën? Diskutim 2 min.

Pjesa e dytë: Lexohet paragrafi i parë. Kur nxënësit ta përfundojnë leximin e këtij paragrafi mbyllin tekstin.

- Pas këtij leximi, nxënësve u shtrohen pyetjet varësish nga natyra e përbajtjes:

-Cila është pozita gjeografike e Danimarkës? Identifiko në hartë dhe përkufizo.

-Sa është pika më e lartë në Danimarkë?

-Cili është lumi më i gjatë?

-Prej sa ishujsh dhe gadishujsh përbëhet Danimarka?


- Gjatë diskutimit, në tabelë shënohen fjalë kyçe që dalin nga teksti. Përdoren si referencë gjatë diskutimit.
 - Hapa të njëjtë merren edhe tek leximi i pjesës 2,3... etj. Para leximit të fundit shtohet edhe pyetja:
 - Tregoni pozitën gjeografike të Danimarkës?
 - Pse Kopenhaga është port i rëndësishëm për vendet e Evropës Veriore e Verilindore?
 - Çfarë prodhimesh eksporton Danimarka?
- ...

Pjesa e tretë: Klaster (puna në dyshe).

Mësimdhënësi në tabelë formon një KLASTER, dhe në qendër të tabelës së zezë shënohet (DANIMARKA) ku nxënësit formojnë degët me anën e informacionit që kuptuan nga njësia që u zhvillua.

Mësimdhënësi luan rolin e "arbitrit" duke cilësuar njohuritë e shprehura si të përshtatshme ose të pa-përshtatshme për njësinë. Puna që zhvillohet në tabelë të përshkruhet edhe në fletoret e klasës.

Nxënësit aktivizohen vullnetarisht ose aktivizohen nga mësimdhënësi.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

ashëno:

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:35

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedis / Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 / Klasa: 7

Tema: Evropa Mesme, veçoritë natyrore dhe shoqërore të shteteve	Rezultati i të nxënët të temës: <i>Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.</i>
---	--

Rezultatet e të nxënët për kompetencat kryesore të shkallës: ~~ashëno~~:

Rezultatet e fushës së kurrikulës: RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvorjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.1; 2.2

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Finlanda dhe Islanda

Fjalët kyçe: Ishull, liqene, pyje, peshkimi, Nokia, sauna, gejzerët

Rezultati/et e të nxënët për orë mësimore:

1. Vlerëson pozitën gjeografike të shteteve Skandinave (Finlandës dhe Islandës) dhe tregon ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.
2. Shpjegon nivelin e lartë të zhvillimit ekonomik dhe tregojnë ndikimin në zhvillimin demografik të vendit.

Kriteret e suksesit:

1. Identifikon industritë që shquhen të dy vendet;
2. Identifikon qendrat më të mëdha për të dy vendet;
3. Tregon të paktën pesë ngjashmëri për të dy vendet.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore:

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Identifikimi i hartës (përshkrim i hartës).

Mësimdhënësi paraqet një hartë memece (të shtypur) ose harta tjera para nxënësve dhe kërkon nga ta që të identifikojnë shtetet (sipas ngjyrës që paraqet territorin sovran) për cilët bëhet fjalë.

Gjithashtu, pasi që i identifikojnë, kërkon nga ta që të përkufizohen të dy shtetet dhe të tregojnë se në cilat dete kanë dalje.

Në fund të atlaseve nxënësit tregojnë faktet që shënohen për të dy shtetet.

Sipërfaqja, numri i banorëve, dendësia dhe kryeqyteti.

Mësimdhënësi së bashku me nxënësit paraqesin kriteret në tabelë ose i sjell të gatshme dhe i shënon që nxënësit ti kenë përpara të përshkruara.



Pjesa e dytë: (Punë në dyshe) Diagrami i Venit.

Mësimdhënësi ndan nxënësit në grupe dyshe (sipas bankës), ku për secilin e ndan nga një njësi mësimore (shtet) dhe kërkon që të lexojë dhe të nxjerr shënimë sipas elementeve gjeografike:

Pozita, Klima, popullsia dhe ekonomia si dhe të dhëna nga atlati.

Në fazën e dytë kërkohet nga nxënësit ti shpjegojnë pjesën e tyre njëri tjetrit dhe të krahasohen dhe të gjejnë të përbashkëtat në mes të këtyre tri shteteve në formën e diagramit të venit ose në formën e shtyllave vertikale ku në fund të ketë një hapësirë horizontale që të shënohen të përbashkëtat.



Pjesa e tretë: Punë individuale (vlerësim kritik)

Mësimdhënësi formon një tabelë sipas elementeve gjeografik për të tre shtetet dhe kërkon nga nxënësit që në mënyrë individuale të vlerësojnë elementet për shtetet duke u bazuar nga informacionet që fituan nga mësimi. Nxënësit vlerësojnë vendet sipas të dhënavë të nxjerra gjatë krahasimit (fletore e klasës), atlasët dhe hartat. Votimi individual.

Mësimdhënës gjatë votimit, gjithnjë duke respektuar kohën, pyet nxënësit se pse mendoni kështu? Çka të bënë të vlerësosh kështu?

Në fund pasi del rezultati: A pajtoheni me rezultatin që fituam (diskutim 1-2 min)?

Finlanda	Relievi-	Klima-	Pasuritë-	Popullsia-	Ekonomia-
Islanda	Relievi-	Klima-	Pasuritë-	Popullsia-	Ekonomia-
VLERËSIMI I NXËNËSVE					
Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).					
Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).					
DETÝRAT DHE PUNA E PAVARUR					
100-108 plotëso Fletore Pune					

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:36

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedisi** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Evropa Veriore dhe Verilindore	Rezultati i të nxenit të temës: ashëno:
--------------------------------------	--

Rezultatet e të nxenit përk kompetencat kryesore të shkallës: ~~ashëno:~~

Rezultatet e fushës së kurrikulës: *RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvorjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.2.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrime-Shtetet e Evropës Veriore

Fjalët kyçë: Gadishulli Skandinav, Baltiku, fjordet, gejzeret, vullkanet, Aurora borealis (dritat polare)

Rezultati/et e të nxenit për orë mësimore:

1. Përkufizon me hartë shtetet e Evropës Veriore dhe tregon faktet/specifikat kryesore për këto shtete.
2. Shpjegon duke ofruar argumente zhvillimin ekonomik të vendeve të Evropës Veriore.

Kriteret e suksesit:

1. Identifikon shtetet e Ev. Veriore dhe Verilindore me hartë.
2. Tregon tri karakteristikat gjeografike kryesore për secilin shtet.
3. Veçon tri pasuritë natyrore të shteteve.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore:

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXENËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Video prezantim

Ne fillim të orës, mësimdhënësi prezanton një video në të cilën është paraqitur gjeografia e Skandinavisë. Pasi përfundon, mësimdhënësi i pyet:

Cila është përshtypja juaj për këtë vend?

Kështu për një kohë shumë të shkurtër diskutohet me nxenës. Të gjitha të dhënat nga diskutimi shënohen në pikë të shkurta në tabelë dhe përdoren si fjalë kyçë.



Link: <https://www.youtube.com/watch?v=CMxuevR0RMQ>

Pjesa e dytë: Misioni (punë në grupe) 30'.

Mësimdhënësi ndan nxenësit në grupe (3 nxenës) dhe u jep një mision për të përfunduar sipas tabelës dhe kohës së caktuar. Misioni ka të bez me përshkrimin e fjalëve që lidhen me Evropën Veriore.


Mësimdhënësi për të përshpejtuar punën, pajis nxënësit me fleta ku është strukturuar tabela e misionit dhe një hartë të pa shënuar të regjioneve në fjalë. Nxënësit duhet të orientohen nga libri dhe atlesi dhe për kohën e caktuar ta përmbytishin misionin.

Misioni	Përshkrim dhe fakte	Pozicioni
	(fakte nga libri)	(përshkruan pozicionin)
Vikingët		
Deti Baltik		
Ngushtica Kategorat		
Pasuria e detit me peshk		
Liqenet		
Pyjet (tajgat)		
Sami		
Shtetet nordike		
Mbretëri		
Vullkane		
Energjia hidrike		
Në hartën e pa shënuar, plotëso emrat e shteteve dhe paraqit 4 faktet kryesore të shteteve		
<ul style="list-style-type: none"> •Kryeqytetin •Sipërfaqen •Numrin e popullsisë •Dendësinë mesatare të popullsisë 		

Pjesa e tretë: Prezantim i punës (punimeve) MISIONIT.

Mësimdhënësi përzgjedh qiftet që duhet të prezantojnë punën para klasës duke shpjeguar në hartë. Secili qift ka kohë rreth 3 minuta të lexojë/interpretojë punën e “misionit”. Mësimdhënësi që nga fillimi i orës duhet të bën vlerësim të vazduhueshmër të punës individuale dhe bashkëpunuese të nxënësve.

Mësimdhënësi pasi kryhet koha, mbledh fletat me emrat e shënuar të secilës dyshe dhe i ruan në dosje për ti mbajtur si dëshmi. Gjithçka përcillet/eksplikohen me hartë.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:37

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi / Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 / Klasa: 7

Tema: Evropa Veriore dhe Verilindore

Rezultati i të nxënësit të temës: Analizon specifikat natyrore, popullative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngashmëritë dhe dallimet mes tyre.

Rezultatet e të nxënësit për kompetencat kryesore të shkallës: shëno:

Rezultatet e fushës së kurrikulës: RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.2.; 2.1

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Estonia, Letonia dhe Lituania

Fjalët kyçe: Baltiku, territor i ulët, popullsia ruse, arsimimi

Rezultati/et e të nxënësit për orë mësimore:

- Vlerëson rolin e pozitës gjeografike të shteteve Baltike dhe tregojnë ngashmëritë dhe dallimet mes tyre.

Kriteret e suksesit:

- Identifikon shtetet në hartë;
- Tregon të paktën pesë të përbashkëta;
- Tregon strukturën etnike të vendeve Baltike.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore:

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Analiza e hartës (punë individuale).

Mësimdhënësi paraqet një hartë në ekran e cila është e edituar (gabim). Kërkon nga nxënësit që te hapin atlasët në pjesën e regionit ku është paraqitur gabimi, udhëzon që të krahasohet me hartën dhe të identifikojnë gabimin e paraqitur. Diçka nuk është në rregull me hartën, a mund ta vëreni? Gjeni gabimin.

Mësimdhënësi sipas dëshirës paraqet gabime në hartë më shumë për analizë nga nxënësit.

Pasi që e identifikojnë problemin, kërkon nga ta që të identifikohen shtetet me të cilat kufizohen dhe në cilët ujëra kanë dalje këto shtete.

Kështu nxënësit zbulojnë njësinë që do zhvillohet, në të njëjtën kohë ata kuptojnë edhe termin se pse quhen shtetet të Baltikut.

-Mësimdhënësi së bashku me nxënës, shpalos atasin në fund duke i identifikuar flamujt dhe të dhënë faktike për shtetet.

Emri i shtetit...

Sipërfaqja...

Popullsia ...

Dendësia...




Pjesa e dytë: (Punë në dyshe) Diagrami i Venit.

Mësimdhënësi ndan nxënësit në grupe dyshe (sipas bankës), ku për secilin e ndan nga një njësi mësimore (shtet) dhe kërkon që të lexojë dhe të nxjerr shënimë sipas elementeve gjeografike:

Pozita, Klima, popullsia dhe ekonomia si dhe të dhëna nga atlasi.

Në fazën e dytë kërkohet nga nxënësit ti shpjegojnë pjesën e tyre njëri tjetrit dhe të krahasohen dhe të gjejnë të përbashkëtat në mes të këtyre tri shteteve në formën e diagramit të venit ose në formën e shtyllave vertikale ku në fund të ketë një hapësirë horizontale që të shënohen të përbashkëtat.



Pjesa e tretë: Punë individuale (vlerësim kritik)

Mësimdhënësi formon një tabelë sipas elementeve gjeografike për të tri shtetet dhe kërkon nga nxënësit që në mënyrë individuale të vlerësojnë elementet për shtetet duke u bazuar nga informacionet që fituan nga mësimi. Nxënësit vlerësojnë vendet sipas të dhënavë të nxjerra gjatë krahasimit (fletore e klasës), atlasët dhe hartat. Votimi individual.

Mësimdhënës gjatë votimit, gjithnjë duke respektuar kohën, pyet nxënësit se pse mendoni kështu? Çka të bënë të vlerësosh kështu?

Në fund pasi del rezultati: A pajtoheni me rezultatin që fituam (diskutim 1-2min)?

Lituania	Reliev-i	Klima-	Pasuritë-	Popullsia-	Ekonomia-
Letonia	Reliev-i	Klima-	Pasuritë-	Popullsia-	Ekonomia-
Estonia	Reliev-i	Klima-	Pasuritë-	Popullsia-	Ekonomia-

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

DETÝRAT DHE PUNA E PAVARUR

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:38

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedis** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Evropa Veriore dhe Verilindore

Rezultatet e të nxënët për kompetencat kryesore të shkallës: **shëno:**

Rezultatet e fushës së kurrikulës: *RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.2.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Aktivitet: Evropa

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.


PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Enigmë

Mësimdhënësi përgatit një hartë të Evropës në formën e puzzle/ Enigmë.

Me projektor paraqet një hartë "blanko" të pa shënuar mbi një hapësirë të bardhë (hamer) ku me laps vizaton të tërën. Pasi që vizatohet (dy kopje) një pér bazë dhe një pér prerje, njérën me brisk (skallper) e copëton ne vijat që janë shënuar mbi kufijtë e shteteve dhe vijës bregdetare.

Pasi që copëtohet, shtetet ngjyrosen me ngjyra të ndryshme ku secila ngjyrë paraqet territorin sovran të një shteti. Kopja tjetër nuk duhet copëtohet por vetëm hapësira ujore (oceanet dhe detet) ngjyrosen me të kaltër. Kjo kopje shërben si bazë pér ngjitje e cila vendoset në tabelë magnetike ose rrafsh i cili varet në mure. Një mjet (hartë e tillë) mund të ju shërbejë gjatë gjithë vitiit shkollor.



Aktiviteti


Mësimdhënësi e ndan klasën në grupe sipas regjioneve të mësuara (Evropës Perëndimore, Jugore, Veriore-Verilindore, Qendrore).

Në një bankë (në mes të klasës) vendos të gjitha copat (shtetet) dhe kërkon nga grupet që të zgjedhin copat (shtetet) përkatëse të regjionit. Koha e përzgjedhjes duhet të jetë e limituar 3-5 minuta.

Detyrat e grupeve:

Të zgjidhet nxënësi i cili do të ngjisë copat (prirës i grupit).

Grupi duhet që të përzgjedh copat, të plotësojë dhe të furnizoj me copa (shtete) liderin e tyre ku në secilën copë të vendoset një pusullë/etiketë me faktet kryesore të shtetit:
Emri, kryeqyteti, sipërfaqja, numri i banorëve dhe dendësia.



Rregullat e aktivitetit

Koha e përzgjedhjes 3-5 minuta. Koha e kompletimit të puzzles (enigmë) 15 minuta.

Nëse gjenden copa (shtete) të regionit tjeter në grupin tjeter, grupi dënohet me minus një pikë... pika i shtohet grupit që i mungon copa.

përveç liderit, askush tjeter nuk duhet të përzihet në ngjitje të copave. Të tjerët mund ta këshillojnë nga distanca.

Nëse nga grupet vërehet që njëri grup ka bërë gabime në shënimin e fakteve (janë shënuar gabim) grupi i cili e vënë re këtë gabim shpërblehet më një pikë, nëse e plotëson me informacion të saktë shpërblehet edhe me një pikë tjeter. Njëjtë vlen edhe nëse nuk është plotësuar fare.

Pjesa shtesë

Mësimdhënësi i ndan grupeve nga 5-7 letra të vogla ku janë shënuar emrat e deteve, ngushticave, oqeaneve... dhe kërkon nga ata që për kohën rreth 5 minuta ti ngjisin në vendin e caktuar.

Të njëjtat rregulla aplikohen edhe në këtë pjesë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:39

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedisi** / Lënda: **Gjeografi** Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Evropa Lindore me Bashkësitë e Shteteve të Pavarura -veçoritë natyrore	Rezultati i të nxënët të temës: <i>Identifikon në hartë shtetet e Evropës Lindore dhe sqaron Bashkësinë e Shteteve të Pavarura.</i> <i>Analizon deri ku shtrihet Evropa Lindore dhe deri ku Bashkësia e Shteteve të Pavarura si dhe sqaron pozitën transitive socio-ekonomike dhe politike te këtyre shteteve.</i>
--	--

Rezultatet e të nxënët për kompetencat kryesore të shkallës: **shëno:**

Rezultatet e fushës së kurrikulës: **RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.2.**

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Evropa Lindore – veçoritë natyrore (Pozita gjeografike dhe kufijtë)

Fjalët kyçe: Sllavët, ndikimi Rúsie, stepat, klima kontinentale, Kaukazi, Deti i zi dhe Kaspiku.

Rezultati/et e të nxënët për orë mësimore:

1. Tregon në hartë têrësitë e mëdha relievore si, Ultësirën e Evropës Lindore, Ultësirën Perëndimore të Sibirit, të Turanit, vargmalet e Karpatave, Kaukazit të Madh, të Vogël, Malet e Azisë Qendrore deri te lumi Amur dhe Gadishulli Kamçatka.
2. Analizon tipat e klimave prej Evropës Lindore e deri në bregdetin e Pacifikut dhe prej Oqeanit të Ngrirë të Veriut e deri te vargmalet e larta në jug.
3. Identifikon në hartë shtrirjen e shkretëtirave, lumenjve, liqeneve... tregon emrat e tyre.

Kriteret e suksesit:

1. Identifikon shtete e Evropës Lindore;
2. Tregon specifikat klimatike të Evropës Lindore;
3. Identifikon têrësinë relievore më të madhe të Evropës Lindore.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore: **HISTORI**

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Asociacioni me fjalët kyçe.

Mësimdhënësi fillon orën mësimore duke shënuar/paraqitur në tabelë fjalët kyçe, si:

*Rusia, popullsia sillave, Kaspiku, pjesa lindore, Volla, malet Urale, Ukraina, Moldavia, Bjellorusia.
(përcillet me hartë)*



Me cilin region të Evropës asocojnë këto fjalë?

Mësimdhënësi u kërkon nxënësve të përshkruajnë secilën fjalë kyçe në fletore dhe të identifikojnë regionin me të cilin asocojnë këto fjalë. Kështu zhvillohet biseda dhe pasi që arrihet të identifikohet regioni, nxënësve u tregohet se çka do të mësohet saktësisht.

Cilat shtete të shtrihen në pjesën lindore të Evropës?

Rusia	Ukraina	Bjellorusia	Moldavia
-------	---------	-------------	----------

Pjesa e dytë: Pyetje dhe komente (punë individuale). Arsimtari udhëzon nxënësit që të lexojnë tekstin në heshtje dhe individualisht.

Deri sa nxënësit lexojnë, arsimtari shënon në tabelë disa pyetje ku nxënësit pas leximit i plotësojnë me ato fragmente që mendojnë se e plotësojnë pyetjen e parashtruar.

Puna vazhdohet në mënyrë vullnetare. Nëse mësimdhënësi dëshiron ti aktivizojë të tjerët, kërkon që në bashkëpunim me vullnetarët ti plotësojnë pjesët edhe nxënësit jo aktiv.


Pyetje	Komente (fragmente nga teksti)
1. Përshkruaj shtrirjen e pozitës gjeografike të Evropës Lindore?	
3. Cili është lumi më i rëndësishëm i Ev.L.?	
4. Cilët janë elementet kryesore fiziko-gjeografike të Ev.L?	
5. Cila është majë më e lartë e Evropës që gjendet në këtë region?	
6. Identifikoni lumenjtë tjerë të rëndësishëm?	
7. Përshkruaj klimën sipas regjioneve gjeografike?	
8. Cila është hapësira më e madhe e regjionit?	
9. Cili është liqeni më i madh i regjionit.	

Pjesa e tretë: Klaster-Pema e mendimeve (puna në dyshe).

Mësimdhënësi në tabelë formon një KLASTER, dhe në qendër të tabelës së zezë shënohet (Evropa Lindore) ku nxënësit formojnë degët me anën e informacionit që kuptuan nga njësia që u zhvillua.

Mësimdhënësi luan rolin e “arbitrit” duke cilësuar njohuritë e shprehura si të përshtatshme ose të pa-përshtatshme për njësinë. Puna që zhvillohet në tabelë të përshkruhet edhe në fletoret e klasës.

Nxënësit aktivizohen vullnetarisht ose aktivizohen nga mësimdhënësi.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:40

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi / Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 / Klasa: 7

Tema: Evropa Lindore me Bashkësitë e Shteteve të Pavarura -veçoritë natyrore	Rezultati i të nxënët të temës: Analizon specifikat natyrore, popullative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.
--	--

Rezultatet e të nxënët për kompetencat kryesore të shkallës: ~~ashëno~~:

Rezultatet e fushës së kurrikulës: RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvaretet dhe ndërveprimet reciproke; 2.2; 2.1.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përforcim - Evropa Lindore

Fjalët kyçe: Sllavët, ndikimi Rusisë, stepat, klima kontinentale, Kaukazi, Deti i zi dhe Kaspiku.

Rezultati/et e të nxënët për orë mësimore:

1. Tregon në hartë tërësitë e mëdha relievore si, Ultësirën e Evropës Lindore, Ultësirën Perëndimore të Sibirit, të Turanit, vargmalet e Karpatave, Kaukazit të Madh, të Vogël, Malet e Azisë Qendrore deri te lumi Amur dhe Gadishulli Kamçatka.
2. Analizon tipat e klimave prej Evropës Lindore e deri në bregdetin e Pacifikut dhe prej Oqeanit të Ngrijë të Veriut e deri te vargmalet e larta në jug.
3. Identifikon në hartë shtrirjen e shkretëtirave, lumenjve, liqeneve... tregon emrat e tyre.

Kriteret e suksesit:

1. Identifikon shtete e Evropës Lindore;
2. Tregon specifikat klimatike të Evropës Lindore;
3. Identifikon tërësinë relievore më të madhe të Evropës Lindore.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore:

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Video prezantim (projektor).

Në fillim të orës, mësimdhënësi paraqet një video prezantim ku paraqitet Evropa Lindore në aspektin historik dhe gjeografik. Pasi që shikohet dokumentari i shkurtër, nga nxënësit kërkohet që të reflektohet në formën e diskutimit nga ajo që shikuan.

Pasi që mbylljet diskutimi, mësimdhënësi u tregon nxënësve vijimin e orës.

Nëse shkolla është e pajisur me rrjet për kycje në internet, mësimdhënësi për atë pjesë të orës mund të lejon nxënësit të kyçen dhe të kërkojnë informacione për regionin me anën e laptopit ose edhe me vetë asistencë nga ana e mësimdhënësit duke u mundësuar të kyçen nga ai, vetëm duke i dhënë kërkesat.



Pjesa e dytë: Shkrim i lire

Tema: Evropa Lindore

Kriteret: Pozita, shtetet, relieve, ujërat, klima, bota bimore dhe shtazore.

Gjatë punës nxënësve u lejohet të përdorin gjithçka kanë në, duke përfshi tekstet, atlasët, fletore pune, fletore të klasës.... edhe kyçje në internet me anën e kompjuterëve (laptopëve ose tabloidëve).

Pjesa e tretë: Të lexohen disa punime. Punimet tjera mësimdhënësi i lexon gjatë vëzhgimit (shkaku i kohës).

Mësimdhënësi vlerëson nxënësit sipas arritjes së kritereve.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:41

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedisi** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Evropa Jugore	Rezultati i të nxenit të temës: <i>Përkuftizon specifikat natyrore, popullative, kulturore, ekonomike dhe politike të shteteve të Evropës Jugore.</i> <i>Identifikon veçoritë e ujit, klimës, pasurive kulturore dhe elementeve tjera etnike të zonës mesdhetare dhe rolin e tyre turistike-ekonomike.</i> <i>Identifikon popujt që jetojnë në vendet e Evropës Jugore.</i>
---------------------	--

Rezultatet e të nxenit për kompetencat kryesore të shkallës: **ashëno:**

Rezultatet e fushës së kurrikulës: *RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvanjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.2.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Popullsia e Evropës Jugore

Fjalët kyçe: romanët, ilirët, sllavët, italianët, ullirë, turizmi, vreshtaria, duhani

Rezultati/et e të nxenit për orë mësimore:

1. Analizon shpërndarjen hapësinore të popullsisë, shpjegon dallimet në dendësi, në vendet e ndryshme të Evropës Jugore.
2. Identifikon zonat turistike më të njohura në këtë region dhe vlerëson ndikimin e turizmit në ekonominë e shteteve të Evropës Jugore.

Kriteret e suksesit:

1. Identifikon shtete e Evropës Jugore;
2. Tregon popujt e Evropës Jugore;
3. Identifikon specifikat ekonomike rreth Mesdheut.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore:

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXENËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e pare: Stuhi mendimesh (diskutim).

Mësimdhënësi hap diskutimin në klasë përmes disa pyetjeve.

Cili janë tre gadishujt e Evropës Jugore?

Cilët shtete gjinden në Evropën Jugore?

Cilët popujt indoeuropian të Evropës Jugore njihni?

Përgjigjet me interesante dhe logjike, shënohen ne dërrasën e zezë. Kështu pasi që identifikohet shteti, mësimdhënësi njofton nxenësit me njësinë që do zhvillohet.

Mësimdhënësi së bashku me nxenësit paraqesin kriteret në tabelë ose i sjell të gatshme dhe i shënon që nxenësit ti kenë përpara të përshkruara.

Pjesa e dytë: INSERT (punë individuale).

Udhëzohen nxenësit të lexonjnë njësinë e re duke i përdorur shenjat e INSERTIT (V- Informacion i njohur, + informacion i ri, - informacion që ndryshon nga ai që e di, ?- sqarime për informacion- i paqartë). Pastaj diskutojnë me radhë se cilat informata ishin të njohura, cilat të reja dhe sqarohen pyetje nga mësimdhënësi të shënuara nga nxenësit.

V	+	-	?
(V- Informacion i njohur)	(+- Informacion i ri)	(- Informacion që ndryshon nga ai që di)	(?-sqarime për informacionin)

Pjesa e tretë: Puna me fletore të punës (punë individuale).

Arsintari së bashku me nxënësit plotësojnë Fletore Pune. Identifikojnë shtetet (te shtetet shpjegojnë se cilit grup të popujve i takojnë) dhe kryeqytetet përkatëse të Evropës Jugore.

Në vazhdim, plotësohen pyetjet nga 121-122

Shteti	Kryeqyteti	Shteti	Kryeqyteti
Kosova	Prishtina		

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:42

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedisi** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Evropa Jugore	Rezultati i të nxenit të temës: <i>Analizon specifikat natyrore, popullative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur njashmëritë dhe dallimet mes tyre.</i>
---------------------	---

Rezultatet e të nxenit përkompetencat kryesore të shkallës: **shëno:**

Rezultatet e fushës së kurrikulës: *RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvaret dhe ndërveprimet reciproke; 2.2, 2.1*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Italia

Fjalët kyçe: Deti Mesdhe, Gadishulli Apennin, Lombardia, Sicilia, Korsika, Etna, Vezuvi, romakët

Rezultati/et e të nxenit për orë mësimore:

1. Vlerëson pozitën gjeografike të Italisë dhe rolin e saj në zhvillimin e vendit;
2. Analizon veçoritë natyrore të Italisë dhe shpjegon ndikimin e tyre në zhvillimin demografik;
3. Tregon regionet gjeografike dhe shpjegojnë dallimet në mes tyre në aspektin ekonomik.

Kriteret e suksesit:

1. Identifikon qendrat kryesore të Italisë;
2. Identifikon malet, lumenjtë dhe ultësirat kryesore të vendit;
3. Tregon në hartë se me cilat shtete kufizohet.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/ apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore:

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXENËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: "Asociacion"

Arsintari formon një asociacion në tabelë si vegës që nxënësit të gjejnë njësinë që do zhvillohet dhe të pyesin përrubrikat se çka asocojnë.

A	B	C	D
"Çizme"	Po	Lombardia	Piza
ITALIA			

Nëse klasa është a pajisur me projektor dhe internet, identifikon elementet e asociacionit që nxënësit ti shohin se për çfarë bëhet fjalë. Ose formon sipas dëshirës një asociacion.

"Çizme"- Forma e Italisë.

Po- Lumë në Lombardi

Lombardia – Ultësirë

Pizza (pica)- Ushqim shumë i njohur italian

Në fund mësimdhënësi i pyet se si do ta formonit ju një asociacion për Italinë? Diskutim 2 min.



Mësimdhënësi së bashku me nxënësit paraqesin kriteret në tabelë ose i sjell të gatshme dhe i shënon që nxënësit ti kenë përparrë të përshkruara.



Pjesa e dytë: Harta e të pyeturit (punë individuale).

Ars. Kërkon nga nxënësit të lexojnë tekstin në heshtje dhe individualisht. Pasi shkruan në tabelë temën dhe çështjet kryesore, vizaton hartën e të pyeturit në formën e diagramit. Gjatë leximit që bëjnë nxënësit, mësimdhënësi shënon disa pyetje në hartën e të pyeturit ku nxënësit pas leximit duhet ti japid përgjigje/plotësojnë hapësirat.

- Sa është sipërfaqja e Italisë? Sa tërësi gjeografike dallohen në Itali?
- Çfarë klime mbizotëron në Itali (përshkruaj)? Ku ndodhet "Trekëndëshi industrial Italian"?
- Cilat janë portet më të mëdha italiane? Tregoni të paktën pesë veçori për Romën?
- Cili është regjioni më i industrializuar në Itali dhe që shquhet edhe në botë?
- Dy vullkanet aktive? Lijkenet më të njohura?
- Lumenjtë më të njohur? Me cilat prodhime bujqësore shquhet Italia?
- Ishujt më të mëdhenj të Italisë?



Pjesa e tretë: Duke e përdorur atlasin/hartën dhe Fletore Pune, plotëso pyetjet nga 123 – 128.

Në hartën memece të Italisë janë vendosur numrat që nxënësit në fjalët e përshkruara më poshtë tu bashkëngjisnin numrat përkatës:

- Kryeqyteti _____ (me fjalë)
- Lumi Po _____ dhe Lombardia _____
- Malet Apenine _____ dhe Alpet _____
- Ishujt: Sicilia _____ dhe Sardenja _____
- Kanali Otrantos _____ dhe Deti Adriatik _____

DETÝRAT DHE PUNA E PAVARUR

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**No:43**Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedis** / Lënda: **Gjeografi**Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Evropa Jugore

Rezultati i të nxënët të temës: Përkufizon specifikat natyrore, popullative, kulturore, ekonomike dhe politike të shteteve të Evropës Jugore.

Rezultatet e të nxënët për kompetencat kryesore të shkallës: ashëno:

Rezultatet e fushës së kurrikulës: RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvorjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.2.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrime - ITALIA

Fjalët kyçe: Deti Mesdhe, Gadishulli Apenin, Lombardia, Sicilia, Korsika, Etna, Vezuvi, romakët

Rezultati/et e të nxënët për orë mësimore:

1. Përshkruan pozitën gjeografike të Italisë dhe identifikon elementet kryesore fiziko-gjeografike;
2. ashëno:

Kriteret e suksesit:

1. Identifikojnë qendrat kryesore të Sllovenisë;
2. Identifikon lumenjtë më të rëndësishëm të vendit;
3. Tregojnë në hartë se me cilat shtete kufizohet.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore: HISTORI

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**Pjesa e parë:** Punë në dyshe (vetëm me atlas/hartë) dhe fletore klase.

Vërejtje: Fletore e klasës lejohet si shkas që nxënësit të janë të vëmendshëm që gjatë të gjitha orëve të marrin shënimë.

Mësimdhënësi në fillim u tregon punën/aktivitetin se si do zhvillohet në klasë.

Ndan nxënësit në dyshe dhe i pajis me nga një fletë A4 e cila është e strukturuar me një tabelë "Misioni" ku nxënësit duhet të plotësojnë hapësirat që të përmbushet misioni i tyre.

Në fletë vendoset identiteti i nxënësve, data dhe klasa.

Pjesa e dytë: Mësimdhënësi ndan nxënësit në dyshe dhe u jep atyre nga ½ të fletës A4 me detyrat e një misioni. Në fletë duhet të jetë e bashkangjitur edhe harta fiziko-gjeografike e Italisë në të cilën janë pozicionuar disa numra (pika) për identifikim.

Detyrë e tyre është që të identifikojnë vendet në hartë

Misioni	Përshkrimi
1- Malet (shembull)	Alpet në pjesën e Italisë shtrihen në veri të saj.
2- Ultësira	
3- Ishulli	
4- Ishulli	
5- malet	
6- Lumi	

7- Deti

8- Deti

9- Deti

10- Kryeqyteti

Detyrë:

Italia ka gjithsej 301.318km²

Popullsia 60.960.000 banorë

Gjeni dendësinë mesatare.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:44

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedis** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Evropa Jugore, veçoritë shoqërore ekonomike

Rezultati i të nxënësit të temës: *Analizon specifikat natyrore, popullative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngashmëritë dhe dallimet mes tyre.*

Rezultatet e të nxënësit për kompetencat kryesore të shkallës: ~~reshëno~~:

Rezultatet e fushës së kurrikulës: *RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvorjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.2.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vatikani, San Marino dhe Malta

Fjalët kyçe: Shtete të vogla, ishuj, romanët, turizmi, republika, italishtja

Rezultati/et e të nxënësit për orë mësimore:

1. Vlerëson pozitën gjeografike të tri shteteve të vogla dhe tregon ngashmëritë dhe dallimet dhe tw përbashkëtat mes tyre.

Kriteret e suksesit:

1. Identifikon shtetet në hartë;
2. Tregon të paktën pesë të përbashkëta;
3. Identifikon nga tre specifika kryesore në natyrën e vendeve.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndet tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore:

PËRSHKRIMI I METODOLOGISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që të hapin atlasët në fund dhe të identifikojnë flamujt që mësimdhënësi paraqet para tyre.

-*Tregoni faktet dhe të dhënat e shteteve?*



-*Cilat janë këto shtete dhe ku gjinden (të gjinden me ndihmën e mësimdhënësit në atlaët e tyre)?*

-*Me cilat shtete kufizohen dhe në cilët dete kanë dalje?*

-*Komentoni faktet dhe të dhënat për shtetet në fund të atlaës.*

Të gjitha të dhënat u bashkëngjiten flamujve përkatës me anën e letrave ngjitime.

-*Çfarë dini tjetër për shtetet?*



Sipërfaqja: **0.44 km²**

Popullsia: **832**

Kryeqyteti: **Vatikan**

Sipërfaqja: **61 km²**

Popullsia: **32.000**

Kryeqyteti: **San Marino**

Sipërfaqja: **315 km²**

Popullsia: **410.000**


Kryeqyteti: **Valeta**

Pjesa e dytë: (Punë në grupe)

Mësimdhënësi ndan nxënësit në grupe treshe, ku për secilin e ndan nga një njësi mësimore (shtet) dhe kërkon që të lexojë dhe të nxjerr shënimë sipas elementeve gjeografike:

Pozita, Klima, popullsia dhe ekonomia si dhe të dhëna nga atlasi.

Në fazën e dytë kërcohët nga nxënësit të krahasohen dhe të gjejnë të përbashkëtat në mes të këtyre tri shteteve në formën e diagramit të venit ose në formën e shtyllave vertikale ku në fund të ketë një hapësirë horizontale që të shënohen të përbashkëtat.



Pjesa e tretë: Punë individuale (vlerësim kritik)

Mësimdhënësi formon një tabelë sipas elementeve gjeografike për të tre shtetet dhe kërkon nga nxënësit që në mënyrë individuale të vlerësojnë elementet për shtetet duke u bazuar nga informacionet që fituan nga mësimi. Nxënësit vlerësojnë vendet sipas të dhënavë të nxjerra gjatë krahasimit (fletore e klasës), atlasët dhe hartat. Votimi individual.

Mësimdhënës gjatë votimit, gjithnjë duke respektuar kohën, pyet nxënësit se pse mendoni kështu? Çka të bënë të vlerësosh kështu?

Në fund pasi del rezultati: A pajtoheni me rezultatin që fituan (diskutim 1-2min)?

Malta	Pozita	Popullsia	Sipërfaqja	Klima	Gjuha	Specifikat
San Marino						
Vatikani						

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:45

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedisi** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Evropa Jugore	Rezultati i të nxenit të temës: <i>Analizon specifikat natyrore, popullative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur njashmëritë dhe dallimet mes tyre.</i>
---------------------	--

Rezultatet e të nxenit për kompetencat kryesore të shkallës: **shëno:**

Rezultatet e fushës së kurrikulës: *RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.2.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Spanja

Fjalët kyçe: Evropa Jugore, deti Mesdhe, Gadishulli Pirinej, shtete koloniale, monarki, turizmi, struktura etnike

Rezultati/et e të nxenit për orë mësimore:

1. Vlerëson pozitën gjeografike të Spanjës dhe identifikojnë elementet kryesore fiziko-gjeografike në hartën e Spanjës;
2. Analizon veçoritë natyrore të Spanjës dhe shpjegojnë ndikimin e tyre në zhvillimin demografik;
3. Arsyeton zhvillimin turistik të Spanjës dhe tregojnë benefitet (dabitë) në zhvillimin ekonomik.

Kriteret e suksesit:

1. Identifikon qendrat kryesore të Spanjës;
2. Tregon me hartë lumenjtë më të rëndësishëm të vendit;
3. Tregojnë në hartë se me cilat shtete kufizohet.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore:

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXENËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: "Asociacion" Diskutim me tri grupe (rreshta).

Arsintari formon një asociacion në tabelë si vegës që nxenësit të gjejnë njësinë që do zhvillohet dhe të pyesin për rubrikat se çka asocojnë.

A	B	C	D
"La Furia Roja"	Mbretëri	"Korida"	Juan Karlos

Nëse klasa është a pajisur me projektor dhe internet, identifikon elementet e asociacionit që nxenësit ti shohin se përfundojnë udhëzona t'i mbyllin teksten. Kërkoni nga ta që gjatë diskutimit të marrin shënimë shkurtimisht, të kursetet kohës.

"La Furia Roja" Furia e kuqe- Ekipi kombëtar i Spanjës

PAELLA- Ushqim tradicional spanjoll me origjinë nga Valencia

"Korida" - Lufta me dema

Juan Karlos- Mbreti aktuali Spanjës

Në fund mësimdhënësi i pyet se si do ta formonit ju një asociacion për Spanjën? Diskutim 2 min.

Pjesa e dytë: Lexim i organizuar (punë individuale)

Mësimdhënësi kërkon nga nxenësit të lexohet paragrafi i parë. Kur nxenësit ta përfundojnë udhëzona t'i mbyllin teksten. Kërkoni nga ta që gjatë diskutimit të marrin shënimë shkurtimisht, të kursetet kohës.

- Pas këtij leximi, nxenësve u shtrohen pyetjet varësisht nga natyra e përbajtjes:

-Cila është pozita gjeografike e Spanjës?

-Sa është sipërfaqja e Spanjës?

-Sa banorë jetojnë sot në Spanjë?

-Përshkruaj klimën e Spanjës?

-Cilat janë prodhimet bujqësore kryesore në Spanjë?

- Hapa të njëjtë merren edhe tek leximi i pjesës 2, 3...

-Përshkruaj pozitën gjeografike të Spanjës?

-Përmend tërësitë kryesore relieve të Spanjës?

-Cilët popuj jetojnë në Spanjë?

-Përshkruaj turizmin në Spanjë?

-Cilat janë qendrat më të njohura në Spanjë (identifiko)?


-Me cilat kultura bujqësorë Spanja zë ndër vendet e para në botë?

Pjesa e tretë: Klaster (puna në dyshe).

Mësimdhënësi në tabelë formon një KLASTER, dhe në qendër të tabelës së zezë shënohet (SPANJA) ku nxënësit formojnë degët me anën e informacionit që kuptuan nga njësia që u zhvillua.

Mësimdhënësi luan rolin e "arbitrit" duke cilësuar njohuritë e shprehura si të përshtatshme ose të pa-përshtatshme për njësinë. Puna që zhvillohet në tabelë të përshkruhet edhe në fletoret e klasës.

Nxënësit aktivizohen vullnetarisht ose aktivizohen nga mësimdhënësi.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

DETÝRAT DHE PUNA E PAVARUR

Plotëso fletore pune në klasë: 129-135 (pyetja 125 është pyetje logjike që duhet shikohet në hartë. Tri qytete kanë dalje në dete, një përjashtohet).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:46

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedis** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Evropa Jugore

Rezultati i të nxënësit të temës:

-Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.

Rezultatet e të nxënësit për kompetencat kryesore të shkallës: **reshëno:**

Rezultatet e fushës së kurrikulës: *RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvorjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.2.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Andorra dhe Gjibraltari

Fjalët kyçe: Shtete të vogla, Pirenejet, Ndikimi britanik, Gjibraltari, blegtoria,

Rezultati/et e të nxënësit për orë mësimore:

1. Vlerëson pozitën gjeografike të tri vendeve dhe arsyeton rolin e saj në zhvillimin e vendit;
2. Analizon veçoritë natyrore të vendeve dhe shpjegon ndikimin e tyre në zhvillimin e turizmit;

Kriteret e suksesit:

1. Identifikon shtetet në hartë;
2. Identifikon vendet që kufizohen;


Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

PËRSHKRIMI I METODOLOGISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Galeria (punë individuale me diskutim).



Mësimdhënësi paraqet një hartë memece ose hartë të rëndomtë së bashku me flamujt e shteteve para nxënësve dhe kërkon nga ta që të identifikojnë shtetet përcilët bëhet fjalë. Mësimdhënësi mundet që ti paraqes në projektor të gjitha së bashku.



Sipërfaqja: 2.6 km²

Popullsia: 30.000

Kryeqyteti: Gjibraltar



Sipërfaqja: 468 km²

Popullsia: 85.000

Kryeqyteti: Andora La Vella

Pasi që i identifikojnë, kërkon nga ta që të përkufizohen të dy shtetet dhe të gjinden në atlassen e tyre faktet për shtetet (në fund të atlasit).

Si pjesë e përsëritjes, mësimdhënësi pyet nxënësit se:

-Ç 'kuptoni me shtete monarki?

-A e dini se pjesë (nën administrimin) e cilit vend është Gjibraltar?

-Ku ndodhet Andorra?

Pjesa e dytë: (Punë në dyshe) Diagrami i Venit.

Mësimdhënësi ndan nxënësit në grupe dyshe (sipas bankës), ku për secilin e ndan nga një njësi mësimore (shtet) dhe kërkon që të lexojë dhe të nxjerr shënimë sipas elementeve gjeografike:

Pozita, Klima, popullsia dhe ekonomia si dhe të dhëna nga atlati.


Në fazën e dytë kërcohët nga nxënësit ti shpjegojnë pjesën e tyre njëri tjetrit dhe të krahasohen dhe të gjejnë të përbashkëtat në mes të këtyre tri shteteve në formën e diagramit të venit ose në formën e shtyllave vertikale ku në fund të ketë një hapësirë horizontale që të shënohen të përbashkëtat.



Pjesa e tretë: Puna me fletore pune (punë individuale në bashkëpunim).

Pjesa e tretë e orës vazhdohet duke e plotësuar fletore punën, pjesën e detyrave e cila u dedikohet Evropës Jugore (faqe 125-139)

Gjithçka përcillet/eksplikohen me hartë individualisht.



Vërejtje: me që mësimi është i shkurtër, koha/ora përdoret për të përforcuar njësitë e mëparshme.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:47

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedis** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Evropa Jugore	Rezultati i të nxënëtit të temës: -Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngashmëritë dhe dallimet mes tyre.
---------------------	---

Rezultatet e të nxënëtit për kompetencat kryesore të shkallës: **ashëno:**

Rezultatet e fushës së kurrikulës: *RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvorjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.2.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Portugalia

Fjalët kyçe: Madeira, Sera de Estrela, tapa, verërat cilësore, Asturias

Rezultati/et e të nxënëtit për orë mësimore:

1. Vlerëson pozitën gjeografike të Portugalisë dhe rolin e saj në zhvillimin e vendit;
2. Analizon veçoritë natyrore të Portugalisë dhe arsyetojnë ndikimin në zhvillimin ekonomik;

Kriteret e suksesisit:

1. Identifikon qendrat kryesore të Portugalisë;
2. Identifiko lumenjtë kryesor të Portugalisë;
3. Tregon pesë gjëra/produkte/resurse që shquhet Portugalia.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore: HISTORI

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Diskutim

Mësimdhënësi sjell një fletë A4 te printuar me hartën memece te PORTUGALISE te cilën e ngjit ne tabelë. Kërkon nga nxënësit te identifikojnë shtetin ne harte. Si ndihmesë u tregon diçka nga pozita gjeografike ose ndonjë informacion qe lidhet me vendin.

Cili shtet është më perëndimor në Evropën Jugore?

Pasi të identifikohet shteti, mësimdhënësi pyet nxënësit më shume për të kuptuar stadin e njohurive qe kane për shtetin/njësinë mësimore që do të zhvillohet.

Çfarë dini për Portugalinë?

Pasi flitet/diskutohet duke i shtetur të gjitha njohuritë, hapet atlesi në fund dhe tregohen/shënohen në tabelë faktet dhe statistikat për vendin.



Pjesa e dytë: Ars. Kërkon nga nxënësit të lexojnë tekstin në heshtje dhe individualisht. Pasi shkruan në tabelë temën dhe çështjet kryesore, vizaton hartën e të pyeturit në formën e diagramit. Gjatë leximit që bëjnë nxënësit, mësimdhënësi shënon disa pyetje në hartën e të pyeturit ku nxënësit pas leximit duhet ti japin përgjigje/plotësojnë hapësirat.



Mund të shtohen edhe pyetje tjera, gjithnjë duke synuar përfitimin e njohurive nga teksti bazë (që lexohet).


Pjesa e tretë: Të nxëninit (përbledhja e mësimit) bëhet sipas duke performuar në role. Mësimdhënësi ndan nxënësit në grupe me nga 3 pjesëtar/nxënës. Pyetjet (maksimumi 5 pyetje) mund të formohen vetë ose të merren nga fletore pune.

A-Intervistuesi

B-Shënesi

C-Personi që intervistohet

Intervistuesi formon 4 pyetje (përdor edhe Fletoren e punës) të cilat ia drejton personit që do intervistohet (nxënësit C). Deri sa këta të dy kryenin aktin e tyre, nxënësi B nxjerr shënimë në një fletë dhe i dorëzon tek arsimtari si detyrë e grupit në bashkëpunim.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:48

Fusha kurrikulare: Shqëria dhe mjedis / Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 / Klasa: 7

Tema: Evropa Jugore

Rezultati i të nxenit të temës: Analizon specifikat natyrore, populitative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.

Rezultatet e të nxenit për kompetencat kryesore të shkallës: shëno:

Rezultatet e fushës së kurrikulës: RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvorjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.2; 2.1

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Greqia

Fjalët kyçe: Helada, Olimpi, Kreta, arkipelag, turizmi, ulliri, duhani,

Rezultati/et e të nxenit për orë mësimore:

- Vlerëson pozitën gjeografike të Greqisë dhe rolin e saj në zhvillimin e vendit;
- Analizon specifikat e natyrës, popullsisë dhe ekonomisë së Greqisë;

Kriteret e suksesit:

- Identifikon malet kryesore të Greqisë;
- Tregon pesë produktet bujqësore që kultivohen në Greqi;
- Identifikon të paktën pesë ishujt më të mëdhenj të Greqisë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndet tjera mësimore dhe/ apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Histori

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXENËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: "Asociacion"

Arsimtari formon një asociacion në tabelë si vegës që nxenësit të gjejnë njësinë që do zhvillohet dhe të pyesin për rubrikat se çka asocojnë.

A	B	C	D
Sparta	Helada	Odisea	Olimpi
GREQIA			

Nëse klasa është a pajisur me projektor dhe internet, identifikon elementet e asociacionit që nxenësit ti shohin se për çfarë bëhet fjalë. Ose formon sipas dëshirës një asociacion.

Sparta- Qytet-shtet në Greqinë e lashtë

Helada- Emri i lashtë i Greqisë

Odiseja – është një nga dy poezitë kryesore antike epike greke që i atribuohen Homerit.

Federal- është mal i lartë në Greqi.

Në fund mësimdhënësi i pyet se si do ta formonit ju një asociacion për Greqinë? Diskutim 2 min.

Mësimdhënësi së bashku me nxenësit paraqesin kriteret në tabelë ose i sjell të gatshme dhe i shënon që nxenësit ti kenë përparrë të pëershruara.

Pjesa e dytë: Pyetje dhe komente (punë individuale).

Arsimtari udhëzon nxenësit që të lexojnë tekstin në heshtje dhe individualisht.


Deri sa nxenësit lexojnë, arsimtari shënon në tabelë disa pyetje ku nxenësit pas leximit i plotësojnë me ato fragmente që mendojnë se e plotësojnë pyetjen e parashtruar.

Pyetje	Komente (fragmente nga teksti)
1. Sa është sipërfaqja e Greqisë?	
2. Me cilat shtete kufizohet Greqia?	
3. Cilat janë qendrat më të njoitura në Greqisë?	
4. Si e ka arritur Greqia shkallën e lartë të homogjeniitetit etnik?	
5. Në sa dete ka dalje Greqia?	
6. Si quhet mali Olimp në mitologjinë grekë?	
7. Çfarë klime mbizotëron në Greqi?	

Pjesa e tretë: Plotësim i fletore pune (punë individuale).

1. Në hartën memece të Greqisë gjiej dhe shëno:

- a) Kryeqytetin e Greqisë
- b) Shtetet me të cilat kufizohet
- c) Detet ku del ajo
- d) Ishujt e mëdhenj



2. Rretho përgjigjet e sakta.

Sipas pozitës gjeografike Greqia është shtet:

- a) Pirinej
- b) Mesdhetar
- c) Danubian
- d) Ballkanik

3. Ç 'kuptoni me arkipelag?

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

DETÝRAT DHE PUNA E PAVARUR

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:49

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedisi** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Evropa Jugore, veçoritë shoqëroror ekonomike	Rezultati i të nxënësit të temës: <i>Analizon specifikat natyrore, popullative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngashmëritë dhe dallimet mes tyre.</i>
--	--

Rezultatet e të nxënësit përk kompetencat kryesore të shkallës: **ashëno**:

Rezultatet e fushës së kurrikulës: *RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvaret dhe ndërveprimet reciproke; 2.2; 2.1.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Bullgaria

Fjalët kyçe: Vend i trëndafilave, turizmi, malet Rodope, malet Ballkan, fusha e Maricës, popullsia sllave

Rezultati/et e të nxënësit për orë mësimore:

1. Vlerëson pozitën gjeografike të Bullgarisë dhe identifikojnë elementet kryesore fiziko-gjeografike në hartë;
2. Analizon veçoritë natyrore të Bullgarisë dhe arsyetojnë ndikimin në zhvillimin ekonomik të vendit;
3. **ashëno**:

Kriteret e suksesit:

1. Identifikon qendrat kryesore të Bullgarisë;
2. Identifikon tri tërësítë gjeografike të Bullgarisë;
3. Tregon pesë resurset kryesore që shquhet Bullgaria.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore: HISTORI

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Diskutim dhe përshkrim i hartës (punë individuale në bashkëpunim).


Mësimdhënësi fillon orën duke u drejtuar nxënësve me pyetje. Së pari kërkon nga ata që të hapin atlassen te harta e Evropës.

Pyetje:

Njihet si vendi i trëndafilave. Për cilin shtet bëhet fjalë?

Ka dalje në detin e zi. Kufizohet me Rumaninë, Serbinë, Maqedoninë, Greqinë dhe Turqinë.

Cili është ky vend?



Pasi identifikohet shteti, mësimdhënësi së bashku me nxënësit tregojnë komente shtesë në lidhje me Bulgarinë dhe shënohen disa në tabelë, gjithnjë duke respektuar njohuritë dhe mendimet e nxënësve dhe të dhënat që nxjerrin nga atlassen (fakte dhe statistika).

Fjalë kyçe: malet Rodope, Ballkanike, Danubi, Deti i Zi, Thrakia, Marica...

Gjithashtu mund të sjell kriteret e orës mësimore të gatshme ose ti formoj së bashku me nxënësit, gjithnjë duke i synuar Rezultatet e të nxënësit të orës mësimore. Të shënohen në tabelë që nxënësit ti kenë parasysh.

Pjesa e dytë: Harta e të pyeturit (punë individuale).

Ars. Kërkon nga nxënësit të lexojnë tekstin në heshtje dhe individualisht. Pasi shkruan në tabelë temën dhe çështjet kryesore, vizaton hartën e të pyeturit në formën e diagramit. Gjatë leximit që bëjnë nxënësit, mësimdhënësi shënon disa pyetje në hartën e të pyeturit ku nxënësit pas leximit duhet ti jep përgjigje/plotësojnë hapësirat.



Mund të shtohen edhe pyetje tjera, gjithnjë duke synuar përfitimin e njohurive nga teksti bazë (që lexohet).


Pjesa e tretë: Të nxënët (përbledhja e mësimit) bëhet sipas duke performuar në role. Mësimdhënësi ndan nxënësit në grupe me nga 3 pjesëtar/nxënës. Pyetjet (maksimumi 5 pyetje) mund të formohen vetë ose të merren nga fletore pune.

A-Intervistuesi

B-Shënesi

C-Personi që intervistohet

Intervistuesi formon 4 pyetje (përdor edhe fletoren e punës) të cilat ia drejton personit që do intervistohet (nxënësit C). Deri sa këta të dy kryenin aktin e tyre, nxënësi B nxjerr shënimë në një fletë dhe i dorëzon tek arsimtari si detyrë e grupit në bashkëpunim.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:50

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedis / Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 / Klasa: 7

Tema: Evropa Jugore

Rezultati i të nxenit të temës:

-Analizon specifikat natyrore, popullative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.

Rezultatet e të nxenit për kompetencat kryesore të shkallës: shëno:

Rezultatet e fushës së kurrikulës: RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvorjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.2.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Republika e Maqedonisë Veriore

Fjalët kyçë: Helenët, maqedonas, ilirët, grekët, Vardari,

Rezultati/et e të nxenit për orë mësimore:

- Vlerëson pozitën gjeografike të Maqedonisë dhe identifikojnë elementet kryesore fiziko-gjeografike në hartë;
- Analizon veçoritë natyrore të Maqedonisë dhe arsyetojnë ndikimin në zhvillimin ekonomik;
- Analizon specifikat e natyrës, popullsisë dhe ekonomisë së Maqedonisë;

Kriteret e suksesit:

- Tregon shtetet të cilat kufizohet Republika e Maqedonisë Veriore;
- Identifikon fushat me të mëdha të Maqedonisë;
- Identifikon qendrat me dominim të popullsisë shqiptare të Maqedonisë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi, atlatset, hartat, globi, revista

Lidhja me lendet tjera mësimore dhe/apo çështjet ndër kurrikulare: Histori

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXENËS GJATË ORËS MËSIMORE

Faza e parë: Stuhi mendimesh 5'

Së pari kërkon nga ata që të hapin atlatset te harta e Evropës.

Mësimdhënësi fillon orën duke u drejtuar nxenësve me pyetje.

Pyetjet u drejohten të gjithë nxenësve, kush e di një përgjigje e ngrit dorën dhe flet.

Pyetjet duhet të janë të lehta përfëmijët që të kenë një përgjigje.

- Me cilat shtete kufizohet Maqedonia?
- Në cilat treva jashtë Kosovës jetojnë shqiptar?
- Pse tani quhet Republika e Maqedonisë Veriore?
- Çfarë dini për Maqedoninë?

Shënimë të shkurta në formën e fjalëve kyçë të shkruhen në tabelë: Shkupi, Tetova, Vardari, L. Ohrit, L. Prespës, malet e Sharrit, sllave...



Gjithashtu mësimdhënësi mund të sjell kriteret e orës mësimore të gatshme ose ti formoj së bashku me nxenësit, gjithnjë duke i synuar Rezultatet e të nxenit të orës mësimore. Të shënohen në tabelë që nxenësit ti kenë parasysh.

Pjesa e dytë: Lexim i drejtuar (punë individuale)

Mësimdhënësi kërkon që të lexohet paragrafi i parë. Kur nxënësit ta përfundojnë leximin e këtij paragrafi mbyllin tekstin.

- Pas këtij leximi, nxënësve u shtrohen pyetjet varësisht nga natyra e përbajtjes:

Sa është sipërfaqja e Maqedonisë?

Sa banorë jetojnë në Maqedoni?

Me cilat shtete kufizohet Maqedonia?

Në cilën pjesë shtrihen malet e Sharrit?


Cilat male shtrihen në perëndim të Maqedonisë?

Trego për strukturën etnike të Maqedonisë?

Përmendi qendrat kryesore turistike?

- Hapa të njëjtë merren edhe tek leximi i pjesës/paragrat 2, 3...

- Pas leximit të fundit, nxënësve mësimdhënësi duhet të jap mundësi që ata të flasin me njëri tjetrin e jo përmes ti. Këtë e arrin duke dhënë pyetjet dhe duke miratuar përgjigjet me lëvizje të kokës.



Pjesa e tretë: Shkrim i lire (10 min.)

Tema: Republika Maqedonisë Veriore

Kriteret: Pozita, relieve, ujërat, klima, ekonomia (2-3 rreshta më së shumti për secilën pjesë).

Të lexohen disa punime. Punimet tjera mësimdhënësi i lexon gjatë vëzhgimit (shkaku i kohës).

Mësimdhënësi i merr me vete për ti vlerësuar nëse nuk del koha. Të njëtat u kthen që ti vendosin në dosjen e lëndës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

DETÝRAT DHE PUNA E PAVARUR

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:51

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedis** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Evropa Jugore	Rezultati i të nxënësit të temës: <i>Analizon specifikat natyrore, popullative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngashmëritë dhe dallimet mes tyre.</i>
---------------------	--

Rezultatet e të nxënësit përkompitet kryesore të shkallës: **reshëno:**

Rezultatet e fushës së kurrikulës: *RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvorjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.2.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Serbia

Fjalët kyçe: Vojvodina, shumadia, sllave, de populimi, gropat tektonike-karstike

Rezultati/et e të nxënësit për orë mësimore:

1. Vlerëson pozitën gjeografike të Serbisë dhe rolin e saj në zhvillimin e vendit;
2. Analizon veçoritë natyrore të Serbisë dhe arsyetojnë ndikimin në zhvillimin ekonomik;
3. Analizon specifikat e natyrës, popullsisë dhe ekonomisë së Serbisë;

Kriteret e suksesit:

1. Tregon shtetet të cilat kufizohet Serbia;
2. Identifikon trevat e banuara me shqiptar;
3. Tregoni resurset natyrore të Serbisë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore: HISTORI

PËRSHKRIMI I METODOLOGISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Diskutim dhe puna me hartë.

Mësimdhënësi paraqet hartën e Evropës dhe u drejtohet nxënësve me një shpjegim në formën e një kërkese.

Kufizohet me Kosovën, Malin e zi, Bosnjën, Kroacinë, Hungarinë, Rumaninë, Bullgarinë dhe Maqedoninë. Për cilin shtet bëhet fjalë?

Çfarë dini për Serbinë?

Cilat treva shqiptare shtrihen në jug të Serbisë?

Cilit grup të popujve u takojnë serbët?

Nga erdhën serbët në këto hapësira ku sot jetojnë?

Shënimë të shkurta në formën e fjalëve kyçe të shkruhen në tabelë: *Vojvodina, shumadia, sllave, de populimi, gropat tektonike-karstike, Beograd, "Molla e Kuqe"...*



Gjithashtu mësimdhënësi mund të sjell kriteret e orës mësimore të gatshme ose ti formoj së bashku me nxënësit, gjithnjë duke i synuar Rezultatet e të nxënësit të orës mësimore. Të shënohen në tabelë që nxënësit ti kenë parasysh.

Pjesa e dytë: Pyetje dhe komente (punë individuale)

Arsimtari udhëzon nxënësit që të lexojnë tekstin në heshtje. Derisa nxënësit lexojnë, arsimtari shënon në tabelë disa pyetje ku nxënësit pas leximit i plotësojnë me ato fragmente që mendojnë se e plotësojnë pyetjen e parashtruar.

Pyetjet duhet të formohen si të tilla që të përmbledhin të tërë njësinë mësimore.

Pyetje	Komente (fragmente nga teksti)
1. Sa është sipërfaqja e Serbisë?	
2. Me cilat shtete kufizohet Serbia?	
3. Cilat janë komunat me shumicë shqiptare në Serbi?	
4. Çka është "Mortaja e Bardhë" dhe pse ndodh ajo?	
5. A ka Serbia dalje në det?	
6. Çfarë klime mbizoteron në Serbi?	
7. Cili është lumi kryesor në Serbi?	
8. Në cilin grup të popujve bëjnë pjesë Serbët?	
9. Me cilat xehë është e pasur Serbia?	


Pjesa e tretë: Tryeza rrethore

Merret një letër dhe një laps, nxënësit ulen në mënyrë rrethore në grupe ose në një grup të madh. Zgjidhet krahu nga do të lëvizë letra dhe lapsi.

Arsimtari kërkon që nxënësit të shkruajnë një ide rreth një problemi ashtu si ata mendojnë në atë moment për problemin/njësinë **"SERBIA"** dhe kështu letra dhe lapsi lëvizin nga njëri tek tjetri.

Çdo nxënës pasi e shkruan idenë e tij, vendos firmën e tij (emrin) e palos letrën me qëllim që shoku pranë tij të mos e lexojë. Dalëngadalë formohet një letër në formë fizarmonike.

Mund të përdoren edhe lapsa me ngjyra të ndryshme... në fund pasi ka mbaruar edhe nxënësit i fundit së shkruari komentin e e vet arsimtari lexon komentet para nxënësve duke bërë një rezyme të asaj se çka mësuan.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:52

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedis / Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 / Klasa: 7

Tema: Evropa Jugore	Rezultati i të nxenit të temës: Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngashmëritë dhe dallimet mes tyre.
---------------------	--

Rezultatet e të nxenit përk kompetencat kryesore të shkallës: shëno:

Rezultatet e fushës së kurrikulës: RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvorjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.2.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kroacia dhe Mali i zi

Fjalët kyse: Adriatiku, Sllovenia, ilirët, Dalmacia, Dinariket, turizmi, pyjet

Rezultati/et e të nxenit për orë mësimore:

1. Vlerëson pozitën gjeografike të dy shteteve dhe rolin e saj në zhvillimin e vendeve;
2. Analizon veçoritë natyrore të Kroacisë dhe Malit të Zi dhe shpjegojnë ndikimin e tyre në zhvillimin demografik;
3. Krahason dy shtetet dhe identifikojnë të përbashkëtat.

Kriteret e suksesit:

1. Identifikon malet kryesore të dy vendeve;
2. Identifikon lumenjtë më të rëndësishëm të dy vendeve;
3. Përshkruan të paktën pesë elemente të përbashkëta për të dy shtetet.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore: HISTORI

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXENËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Punë me hartë në formën e diskutimit.

Mësimdhënësi paraqet një hartë memece (ballkanike) para nxenësve dhe kërkon nga ta që të identifikojnë shtetet për cilët bëhet fjalë shteti 1 dhe shteti 2 dhe të ngjyrosin hapësirat sovrane të shteteve. Gjithashtu, pasi që i identifikojnë, kërkon nga ta që të përkufizohen të dy shtetet.

- Me cilit shtete kufizohen?
- Në cilët dete kanë dalje?
- Cilin nga shtete e ka më afër Kosova?
- Cilit grup të popujve Evropian u takojnë popullsia e këtyre dy shteteve?

...

Shënimë të shkurtë në formën e fjalëve kyçe të shkruhen në tabelë: Adriatiku, Sllovenia, ilirët, Dalmacia, Dinariket, turizmi, pyjet...

Gjithashtu mësimdhënësi mund të sjell kriteret e orës mësimore të gatshme ose ti formoj së bashku me nxenësit, gjithnjë duke i synuar Rezultatet e të nxenit të orës mësimore. Të shënohen në tabelë që nxenësit ti kenë parasysh.



Pjesa e dytë: "Diagrami i venit" (Punë në grupe)

Mësimdhënësi ndan nxënësit në grupe dyshe, ku për secilin e ndan nga një njësi mësimore (shtet) dhe kërkon që të lexojë dhe të nxjerr shënimë sipas elementeve gjeografike:

Pozita, Klima, popullsia dhe ekonomia si dhe të dhëna nga atlasi.

Në fazën e dytë kërkohet nga nxënësit të krahasohen dhe të gjejnë të përbashkëtat në mes të këtyre tri shteteve në formën e diagramit të venit ose në formën e shtyllave vertikale ku në fund të ketë një hapësirë horizontale që të shënohen të përbashkëtat.

Kroacia	Mali i Zi
Të përbashkëtat	



Pjesa e tretë: Punë individuale (vlerësim kritik)

Mësimdhënësi formon një tabelë sipas elementeve gjeografik për të tre shtetet dhe kërkon nga nxënësit që në mënyrë individuale të vlerësojnë elementet për shtetet duke u bazuar nga informacionet që fituan nga mësimi. Nxënësit vlerësojnë vendet sipas të dhënavë të nxjerra gjatë krahasimit (fletore e klasës), atlasët dhe hartat. Votimi individual.

Mësimdhënës gjatë votimit, gjithnjë duke respektuar kohën, pyet nxënësit se pse mendoni kështu? Çka të bënë të vlerësosh kështu?

Në fund pasi del rezultati: A pajtoheni me rezultatin që fituam (diskutim 1-2 min)?

Kroacia	Relievi-	Klima-	Pasuritë-	Popullsia-	Ekonomia-
Mali i zi	Relievi-	Klima-	Pasuritë-	Popullsia-	Ekonomia-

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

DETÝRAT DHE PUNA E PAVARUR

Plotëso fletore pune: 151-160

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:53

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedis** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Evropa Jugore	Rezultati i të nxënësit të temës: <i>Analizon specifikat natyrore, popullative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.</i>
---------------------	---

Rezultatet e të nxënësit përkompeticat kryesore të shkallës: ~~reshëno~~:

Rezultatet e fushës së kurrikulës: *RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvorjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.2.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Bosna dhe Hercegovina

Fjalët kyçe: Lufta në Bosnie, kroatët, serbët, Dejtoni, pasuritë minerale, reliivi shkëmbor.

Rezultati/et e të nxënësit për orë mësimore:

1. Vlerëson pozitën gjeografike të Bosnjës dhe rolin e saj në zhvillimin e vendeve;
2. Analizon veçoritë natyrore të Bosnjës dhe shpjegojnë ndikimin e tyre në zhvillimin demografik;
3. Përshkruan strukturën etnike të Bosnjës dhe Hercegovinës.

Kriteret e suksesit:

1. Identifikon malet kryesore të vendit;
2. Identifikon resurset natyrore të Bosnjës;
3. Tregon popujt që jetojnë në Bosnie dhe shtrirjen e tyre në zona administrative.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore:

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Fjalët kyçe (diskutim).

Mësimdhënësi para se ti njoftoj nxënësit me orën/njësinë mësimore, në tabelë shkruan disa fjalë kyçe që asocojnë me shtetin për të cilin do zhvillohet njësia.


Srebrenica, kroatët, serbët, Dejtoni, pasuritë minerale, reliivi shkëmbor

Për secilën fjalë që nxënësit nuk kanë njoħuri, mësimdhënësi jep shpjegime.

Pasi identifikohet shteti i Bosnjës dhe Hercegovinës, kërkohet nga nxënësit të përkufizojnë atë dhe të tregojnë faktet dhe statistikat nga ataset për shtetin.

Nxënësit japid komentet e tyre se çka dinë, ndërsa mësimdhënësi paraqet atonë tabelë.

Gjithashtu mësimdhënësi mund të sjell kriteret e orës mësimore të gatshme ose ti formoj së bashku me nxënësit, gjithnjë duke i synuar Rezultatet e të nxënësit të orës mësimore. Të shënohen në tabelë që nxënësit ti kenë parasysh.



Pjesa e dytë: Pyetje dhe komente (punë individuale)

Arsintari udhëzon nxënësit që të lexojnë tekstin në heshtje. Derisa nxënësit lexojnë, arsimtari shënon në tabelë disa pyetje ku nxënësit pas leximit i plotësojnë me ato fragmente që mendojnë se e plotësojnë pyetjen e parashtruar.

Pyetjet duhet të formohen si të tilla që të përmbledhin të tërë njësinë mësimore.

Pyetje	Komente (fragmente nga teksti)
1. Sa është sipërfaqja e Bosnjës?	
2. Me cilat shtete kufizohet Bosnja?	
3. Cilat janë qendrat më të njoitura në Bosnje?	
4. Përshkruani strukturën etnike të Bosnjës?	
5. A ka dalje në det Bosnja?	
6. Identifikoni lumenjtë më të njoitur?	
7. Çfarë klime mbizotëron në Bosnje?	

fragmentet që mendojnë se e plotësojnë pyetjen e parashtruar.



Pjesa e tretë: Plotësim i fletore punës (punë individuale).

Gjëj dhe shëno në hartën memece të Bosnie dhe Hercegovinës

- a) Kryeqytetin e B dhe H
- b) Shtetet me të cilat kufizohet
- c) Malet Dinara, Kozara, Bjelashnica

160

Lidh lumenjtë me pelljet detare të cilëve i përkasin.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:54

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedisi** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Evropa Jugore, veçoritë shoqëroro ekonomike

Rezultatet e të nxënët për kompetencat kryesore të shkallës: **Shëno:**

Rezultatet e fushës së kurrikulës: *RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvorjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.2.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrime për TESTIM

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Paraprakisht mësimdhënësi njofton nxënësit me llojin e testit (pyetjet) se si do të jenë, kategoritë... Cilat janë kriteret dhe koha. Gjithashtu njofton nxënësit për kriteret dhe mjetet që do ti kenë me vete (atlas, stilolaps, harta...).

1 dhe 2. Lidh elementet përkatëse mes vete.

Polderet•	•Finlanda
Fjordet•	•Norvegjia
Vullkanet•	•Holanda
Liqene•	•Islanda

56.542 km ²	Dalmacia
Alpet Dinarike	Liqenet e Plitvices
Shëno shtetin: _____	

3. Rryma e Golfit është rrymë oqeanike e cila ka ndikim në klimë formimin e Evropës. Tregoni dy ndikime të kësaj dukurie në formimin e klimës: _____, _____.

4. Relievi i Danimarkës është:

- a) Malor b) Kodrinor c) Fushor


5.

Lugina të ngushta e të rrëpirëta të krijuara nga akullnaja quhen fjorde.	S	P
Danimarka është vendi më malor në Evropën Veriore.	S	P
Lituania, Letonia dhe Estonia njihen si vende Baltike.	S	P
Në veri të Evropës Veriore jetojnë ponët (sami).	S	P
Islanda dhe Norvegjia kanë dalje në gjirin Botnik.	S	P

6. Përmend veprimtaritë më të rëndësishme ekonomike të Evropës Jugore.

7. Plotëso hartat:

- a)_____
b)_____
c)_____



Testim i dytë

RREGULLAT GJATË TESTIMIT

•Mos komunikon me shoqen apo shokun; •Kujdes në rrumbullakimin e alternativave; •Vetëm një alternativë është e saktë; •Shëno shkrimin e lexueshëm; Mos e dërmto testin; •Respektoje kohën.

No. 55

Tema: 1: Evropa (40%) 2:Evr. Jugore (10%) 3: Evr.e Mesme (20%) 4:Evropa Perë.(20%) 5: Evr. Veriore(10%)

--SHEMBULL--

Sqarim: Testi shërben vetëm si shembull. Mësimdhënës i mbetet të formulojë një test të tillë duke ia përshtatur temave të tyre.

Klasa – IX		Emri dhe Mbiemri: _____	Pikët			
1	Kontinenti i Evropës e ka marrë emrin nga fjala e vjetër asire “_____” që do të thotë tokë e daljes/perëndimit të Diellit: a) Ereb b) Vereb c) Elbrus d) Everlast		8			
2	Cili region gjeografik i Evropës është paraqitur me ngjyrë të kuqe ne fotografi (hartë)?		8			
3	Bashko me vija vendet sipas logjikës gjeografike: a. Gadishulli Iberik b. Gadishulli Skandinav c. Franca	Evropa Veriore Evropa Jugore Evropa Perëndimore	9			
4	Nëse ndodheni në Gjibraltar, atëherë qyteti i Reikjavikut për ju është në:	a) veri b) perëndim c) lindje	9			
5	Cila nga alternativat e paraqet të saktë kuptimin për POLDERET:	d) Janë male të vjetra të pasura me xehe hekuri; e) Janë formacione bimore në veri të tajgës; f) Janë toka nën nivelin e detit.	9			
6	Përshkruani rrjedhën e lumit Danub gjatë tërë territorit Evropian (shtetet).	_____	10			
7	Analizo grafikun dhe tregoni se çka nuk është në rregull me hartën (dy elemente): _____, _____		11			
8	<i>Rendit elementet përkatëse në regjionin përkatës.</i>	<table style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="width: 30%; vertical-align: top;"> Evropa Perëndim. "Alpet Evropiane" 4808m </td> <td style="width: 30%; vertical-align: top;"> Gjermania Sena Masivi Qendoror La Mansh Luksemburgu </td> <td style="width: 30%; vertical-align: top;"> Irlanda Temza Shvarcvald Adriatiku Polonia </td> </tr> </table>	Evropa Perëndim. "Alpet Evropiane" 4808m	Gjermania Sena Masivi Qendoror La Mansh Luksemburgu	Irlanda Temza Shvarcvald Adriatiku Polonia	11
Evropa Perëndim. "Alpet Evropiane" 4808m	Gjermania Sena Masivi Qendoror La Mansh Luksemburgu	Irlanda Temza Shvarcvald Adriatiku Polonia				
9		Itali-France	12			
	Plotëso tabelën duke shfrytëzuar fjalët kyçë që janë dhënë dhe jepi kuptim asociacionit.					

10

Vlerësoni rolin e Rrymës se Golfit për klimën dhe aktivitetet njerëzore në Evropë _____

13

<i>Përgindja</i>	0 - 39 %	40% - 59 %	60% - 79%	80% - 89%	90% - 100%	Pikët: ()
<i>Pikët</i>	0 -39 pikë	40 - 59 pikë	60 - 79 pikë	80 - 89 pikë	90 – 100 pikë	
<i>Nota</i>	1	2	3	4	5	()
<i>Shenjat korigjuese:</i> ✓- e saktë, ✗- e pasaktë, ~- e paplotësuar						Mësimdhënësi: _____

► Nëse është mundësia që testi të bëhet me dy fletë, atëherë njëren pjesë e plotësojmë vetëm me harta

Tabela e testit për vlerësim numerik të pyetjeve sipas niveleve - Klasa VII

Fusha/Tema mësimore	Njohja	Të kuptuarit	Zbatimi	Mendimi kritik	Shuma 100%
	20%	30%			
Kontinenti i Evropës	40%	1 (8p)	1 (9p)	Analizë - 1 (11p) Vlerësim - 1 (13p)	4 (41p)
Evropa Jugore	10%	1 (8p)			1 (8p)
Evropa Perëndimore	20%		1 (9 p)	Sintezë - 1 (12p)	2 (21p)
Evropa e Mesme	20%			1 (10 p) 1 (11 p)	2 (21p)
Evropa Veriore	10%		1 (9 p)		1 (9p)
	16 pikë	27 pikë	21 pikë	36 pikë	100 pikë

Vërejtje: Testi si instrument i paraqitur në librin e mësuesit është vetëm një shembull dhe është i njëjtë me testin e parë. Planet ditore janë reshtuar mbi bazën e renditjes së Programit Lëndor (të bëhet korrelacion me lëndët e tjera të fushës) për këtë arsy nuk është paraqitur test i rregullt sepse mësimdhënësi është autonom të zgjedh renditjen duke i ndërlidhur pjesët (regionet, shtetet) natyrore-shoqërore-ekonomike me njëra tjetrën.

Aktivitet ndërlëndor 9 Maji - Dita e Evropës

Nxënësit duhet të njoftohen më herët (rreth një javë) para ditës së galerisë "Dita e Evropës". Mësimdhënësi organizon punën, delegon detyrat te grupet e caktuara ose klasat, njofton me securinë dhe materialet që duhet të përdoren duke marr edhe mendimin e nxënësve dhe kolegëve nga Fusha Kurrikulare (shoqëria dhe mjedisi). Më poshtë është dhënë një shembull i një aktiviteti nderlëndor i mund ti shërbejë mësimdhënësit si model edhe për ditët tjera të shënuara.

Emri i mësimdhënësит	Xxxxxx Yyyyyyy
Titulli i aktivitetit	GALERIA - Dita e Evropës
Klasa	VI, VII, VIII, IX
Kohëzgjatja e aktivitetit	Një ditor
Qëllimi i aktivitetit	Kosova si shtet Evropian
Fusha	Fusha shoqëria dhe mjedisi
Bashkëpunimi lëndor	Gjeografi, Histori, Ed. Qytetare
Rezultatet që duhen arritur RNK	<p>Shkalla 3: I-4,5,6; II-3,5,6; III-1,3; IV-1,2,4,6; VI-5,6. Shkalla 4: I-1,3,5; II-1,2,4,7; III-1,2,3,5; IV-2,4,6; VI-4,7.</p> <p>Vërejtje: Mësimdhënësit mund ti synojnë edhe rezultatet tjera ose ti mungojnë ato varësisht lëndës, hapësirës dhe kohës.</p>
Rezultatet e fushës	<p>Shkalla 3: 1- 1.1; 2- 2.1, 2.2; 3- 3.2; 5- 5.1; 6- 6.1, 6.2. Shkalla 4: 1- 1.1, 1.3; 2- 2.1, 2.2; 3- 3.1, 3.2; 5- 5.1; 6- 6.1, 6.2.</p>
Mjetet për realizim	Laptop, projektor/TV, hamer, fletushka, ngjyra, fleta A4, harta, globi...
Përvizim i aktivitetit	<p>Aktiviteti realizohet në bashkëpunimin nder lëndor ku mësimdhënësit gjatë takimeve në aktivin profesional vendosin për aktivitetin dhe mbarëvajtjen e tij.</p> <p>Lënda e gjeografisë: Udhëzon nxënësit (grupe ose klasa) që për nderë të Ditës së Evropës të punojnë punime si: Hamer, fletushka dhe PowerPoint Prezantim.</p> <p>Klasat e gjashta: Udhëzohen të punojnë fletushka me thënie/shënimë punim dore (shprehje për Evropën, statistika, foto mesazhe...) tw formatit 6x4cm dhe të vendosen në një pano që të ekspozohen. Fletushkat të kenë emrin e autorit/nxënësit.</p> <p>Klasat e shtata: Punim në HAMER (Kontinenti i Evropës) sipas elementeve gjeografike: Pozita gjeografike, reliivi, klima, ujërat, bota bimore dhe shtazore, popullsia, ekonomia si dhe një hamer me shtetet me statistika.</p> <p>Klasat e teta: Udhëzohen të vizatojnë/printojnë flamujt e shteteve të Evropës në fletë A4 (një flamur, një fletë) ku poshtë shënohen faktet kryesore të shteteve (emri, sipërfaqja, numri i popullsisë, dendësia dhe kryeqyteti).</p> <p>Klasat e nënta: Të formojnë një prezantim në Power Point sipas udhëzimeve:</p> <p>Tema: Bashkimi Evropian Deri në 5 slajde për lëndë. Të përfshihen fotografi, të dhëna statistikore, shtetet, harta... si dhe në fund të jatin përgjigje pyetjes:</p>

Pse Kosova duhet të jetë pjesë e Bashkimit Evropian.

Kështu veprojnë edhe lëndët e tjera por duke synuar promovimin dhe arritjen e rezultateve nga këndi i tyre lëndor.

Përshkrim i organizimit

Në një hapësirë të shkollës vendosen tri banka (klasa shtatë, tetë dhe nëntë) punuese, ku në secilën bankë të jenë nga 3 nxënës (një për gjeografi, një histori, një Ed. Qytetare). Secili nga nxënësit (me radhë) të prezanton pjesën e tij/saj për vizitorët. Në pjesën prapa nxënësve në mure të vendosen punimet dhe ekrani i TV që do të prezantohen.

Mësimdhënësit duhet të kujdesën që nxënësit të ndërrohen që të mos prezantojnë vetëm një ose dy por më shume dhe që aktiviteti të realizohet në ditë pune që është afër me Ditën e Evropës (në kohë jashtë orëve mësimore).

Flamujt e shteteve të vendosen në një hapësirë që vizitorët ti shohin. Po ashtu edhe fletushkat nga nxënësit e klasave të gjashta.

Mbi flamujt e shteteve të Evropës (në një kënd të fletës) të vendosen një letër ngjitime e prerë si harta e Kosovës si simbol që vendi (shteti) e ka njojur Kosovës si shtet të pavarur. Po ashtu në një kënd tjetër të fletës të vendoset një flamur i vogël i Bashkimit Evropian që tregon se shteti është pjesë e BE-së.

Shembull



ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:56

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi / Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 / Klasa: 7

Tema: Evropa Perëndimore, veçoritë shoqëroro ekonomike	Rezultati i të nxënët të temës: Vlerëson rëndësinë e shumë kanaleve që lidhin lumenjtë mes veti. -Identifikon pesë limanet më të njohura të Evropës Perëndimore. -Analizon shtrirjen gjeografike dhe rëndësinë ekonomike të vendburimeve të qymyrit, naftës, gazit, hekurit dhe metaleve të tjera. -Analizon aspekte tjera të ndërlidhura me pozitën e që i kanë mundësuar zhvillim ekonomik dhe turistik këtij regjioni. -Identifikon popujt e Evropës Perëndimore sipas shteteve. -Radhitë shtetet e Evropës Perëndimore sipas numrit të banorëve si dhe të ardhurave për kokë banori.
--	--

Rezultatet e të nxënët për kompetencat kryesore të shkallës: **shëno:**

Rezultatet e fushës së kurrikulës: RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.2.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Veçoritë shoqërore-ekonomike të Evropës Perëndimore – Popullsia

Fjalët kyçe: Shtete të zhvilluara, nivel i ulët i analafabetizmit, pasuritë natyrore, kolonitë, mbretëri

Rezultati/et e të nxënët për orë mësimore:

1. Përkufizon hapësirën e Evropës Perëndimore dhe identifikojnë shtetet që shtrihen në këtë regjion.
2. Identifikon popujt sipas shteteve që banojnë në hapësirën e Evropës Perëndimore.
3. Arsyeton ndikimin e resurseve natyrore në zhvillimin ekonomik të Evropës Perëndimore.

Kriteret e suksesit (formohen në klasë së bashku me nxënës):

1. Identifikon shtetet e Evropës Perëndimore;
2. Identifikon popujt kryesor të këtij regjioni;
3. Tregon zonat/vendet me dendësinë më të madhe të popullsisë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore: HISTORI

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Harta PUZZLE/enigmë (pune individuale në bashkëpunim).


Mësimdhënësi paraqet një hartë memece (A3) ose hartë të rëndomtë para klasës dhe kërkon nga nxënësit që të identifikojnë shtetet e Evropës Perëndimore duke i etiketuar me letër ngjitëse me ngjyra. Secili rresht pajiset me një ngjyrë të veçantë.

Pasi identifikohen shtetet, kërkohet të shënojnë çka kanë njohuri përvendet (shtete) e Evropës Perëndimore ose Evropën Perëndimore si regjioni?

Mësimdhënësi i lexon informacionet e shënuara. Eliminon ato që nuk janë të sakta për regjionin ose shtete (të gabuarat) dhe lejon të shihen se cila ngjyrë nga letrat ngjitëse është më dominuese.

Para se të vazhdohet me pjesën e dytë, mësimdhënësi u drejtohet me një pyetje:

Cili është mendimi juaj, a është regjioni më i zhvilluar ekonomik i Evropës?



Pjesa e dytë: Mësimdhënësi drejton njërin nga nxënësit ose lexon vetë me zë pjesën e njësisë (mësimit).

- Pas këtij leximi, nxënësve u shtrohen pyetjet varësish nga natyra e përbajtjes:

Prej cilëve shtete përbëhet Evropa Perëndimore?

Cilët element natyror dallohen në reliefin e E.M?...

Nxënësit gjatë kësaj kohe përdorin atlastet e tyre.

- Fjalët kyçë ose ato referenca interesante, shënohen në tabelë.

- Hapa të njëjtë merren edhe tek leximi i pjesës/paragrafit 2, 3... Para leximit të fundit shtohet edhe pyetja:

Cila është rëndësia e Alpeve?

Çfarë klime dominon në E.M?

Cilët janë malet kryesore në E.M?

- Pas leximit të fundit, nxënësve mësimdhënësi duhet të jap mundësi që ata të flasin me njëri tjetrin e jo përmes ti. Këtë e arrin duke dhënë pyetjet dhe duke miratuar përgjigjet me lëvizje të kokës.

Pjesa e tretë:

Shkrim i lirë

Tema: **Evropa Perëndimore**- Veçoritë natyrore dhe shoqërore (pa libër, me atlas).

Gjatë shkrimit të lirë nxënësit shkruajnë pa u ndalur, me qëllim që të shkruarit e tyre të burojë në mënyrë të tillë që ata të mos kenë frikë nga kritikat dhe korrigimet

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

DETÝRAT DHE PUNA E PAVARUR

☞ Plotëso:

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**No:57**Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedisi** / Lënda: **Gjeografi**Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Evropa Perëndimore

Rezultati i të nxënësit të temës: *Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.*

Rezultatet e të nxënësit për kompetencat kryesore të shkallës: **reshëno:**Rezultatet e fushës së kurrikulës: *RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvorjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.2.***ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: Britania e Madhe

Fjalët kyce: Ishull, mbretëri, kanali detar, Komonuelthi, klima oceanike, malet e ulëta të vjetra.

Rezultati/et e të nxënësit për orë mësimore:

1. Përkufizon hapësirën e Britanisë dhe identifikon shtetet që përbëjnë atë.
2. Përshkruan regionet e Britanisë sipas specifikave natyrore dhe shoqërore.
3. Arsyeton zhvillimin ekonomik të Britanisë.

Kriteret e suksesit (formohen në klasë së bashku me nxënës):

1. Tregon shtetet që përbëjnë Britaninë e madhe;
2. Identifikon Lumenjtë e Britanisë së Madhe dhe tregon cilët qytete janë ngritur në këta lumenj;
3. Tregon popujt që jetojnë në BM.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: *Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.*Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore: **HISTORI****PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE****Pjesa e parë: "Asociacion"**

Arsimtari formon një asociacion në tabelë si vegës që nxënësit të gjejnë njësinë që do zhvillohet dhe të pyesin për rubrikat se çka assocojnë.

A	B	C	D
Ishull	Union Jack	Mbretëri	England
BRITANIA E MADHE			

Mësimdhënësi pasi që zbulohet asociacioni pyet nxënësit përfundimisht kyce:

Çka assocojnë me B. Madhe?**Çka kishit shtuar ose si e kishit formuar ju?**

Nëse klasa është a pajisur me projektor dhe internet, identifikon elementet e asociacionit që nxënësit ti shohin se përfshirë bëhet fjalë. Ose formon sipas dëshirës një asociacion.

"Ishull"- Ishulli me të njëjtin emër.**Union Jack- Flamuri i Britanisë së Madhe.****"Mbretëri" – Organizimi shtetëror i BM.****England (Anglia)- Shteti më i madh në Britaninë e Madhe.****Në fund mësimdhënësi i pyet se si do ta formonit ju një asociacion përfundimisht?**

Kështu nxënësit njihen me njësinë e re që do zhvillohet pasi që zbulohet asociacioni. Mësimdhënësi tregon pozitën e B. Madhe në hartë dhe tregon shtetet me cilat përkufizohet ose kërkon nga nxënësit të tregojnë nga atlastet se në cilët dete ka dalje dhe nga cilët shtete përbahet.

Mësimdhënësi së bashku me nxënësit paraqesin kriteret në tabelë ose i sjell të gatshme dhe i shënon që nxënësit ti kenë përparrë të përshkruara.

Pjesa e dytë: Grupet e ekspertëve (puna në grupe).

Nxënësit ndahen ne pese grupe, ku secili nxënës ka një numër 1,2,3,4

Pas nxënësit kanë përcaktuar numrat bashkohen njëshat bashkë, dyshat bashkë, treshat bashkë, katrat bashkë, pesat bashkë dhe kështu me radhë.

Mësimdhënësi iu jep secilit grup nga një detyrë të caktuar dhe punojnë duke u bërë ekspertë të çështjes për të cilën janë caktuar. Pjesën në fund të tekstit "Me rëndësi të dihet" e lexojnë të gjitha grupet.

Grupi 1

- Në sa dete ka dalje Britania. Cilët dete?
- Nga cili kanal ndahet nga Evropa Kontinentale?
- Përkruaj specifikat natyrore të Britanisë?
- Sa është sipërfraaja e Britanisë?
- Identifiko qytetet që janë ngritur në lumenjtë e B. Madhe?

Grupi 2

- Për nga rregullimi shtetëror, çfarë shteti është B. Madhe?
- Sa është dendësia mesatare e B. Madhe?
- Cilët popuj e përbëjnë populsinë në B. Madhe?
- Tregoni disa ish koloni të B. Së Madhe?
- Nga cilët vende ka më së shumti migrues drejt B. Madhe?

Grupi 3

- Sa është përqindja e populsisë jetojnë në qytete?
- Me cilat lloje të industrisë shquhet B. Madhe?
- Cilat janë qytetet universitare më të njohura botërisht në B.M?
- Përmend disa monumente kulturo-historike të B. Madhe?

Grupi 4

- Cili është qyteti më i madh në B. Madhe dhe sa ka banorë?
- Me cilat monumente dhe përmendore të famshme shquhet Londra?
- Cilat qendra tjera të njohura industriale ndodhën në B. Madhe?
- Nga kush u themelua Londoniumi antik?

Përfaqësuesit e grupeve u përgjigjen pyetjeve dhe debatojnë lidhur me to.

Pjesa e tretë: Reflektim i punës në grupe.

Pasi kryejnë detyrën në grupet e reja që janë krijuar (njëshat, dyshat treshat e kështu me radhë) kthehen dhe riformohen përsëri grupet bazë (amë) në të cilët çdo nxënës ka një detyrë specifike të cilën do ta prezantojë pjesën e tij.

Të gjithë se bashku marrin pjesë me pyetje dhe komente duke e qartësuar problemin deri në fund dhe duke e përcjellë me hartë.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:58

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi / Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 / Klasa: 7

Tema: Evropa Perëndimore	Rezultati i të nxënët të temës: -Analizon specifikat natyrore, popullative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur njashshmëritë dhe dallimet mes tyre.
--------------------------	--

Rezultatet e të nxënët përkompetencat kryesore të shkallës: ~~ashëno~~:

Rezultatet e fushës së kurrikulës: RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvorjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.2.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrime - Britania e madhe

Fjalët kyçe: Ishull, mbretëri, kanali detar, Komonuelthi, klima oceanike, malet e ulëta të vjetra.

Rezultati/et e të nxënët për orë mësimore:

1. Përkufizon hapësirën e Britanisë dhe identifikon shtetet që përbëjnë atë.
2. Përshkruan regionet e Britanisë sipas specifikave natyrore dhe shoqërore.
3. Arsyeton zhvillimin ekonomik të Britanisë.

Kriteret e suksesit (formohen në klasë së bashku me nxënës):

1. Tregon shtetet që përbëjnë Britaninë e Madhe;
2. Identifikon lumenjtë e Britanisë së Madhe dhe tregon cilët qytete janë ngritur në këta lumenj;
3. Tregon popujt që jetojnë në BM.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore: HISTORI

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Punë në dyshe (vetëm me atlas/hartë) dhe fletore klase.

Vërejtje: Fletore e klasës lejohet si shkas që nxënësit të jenë të vëmendshëm që gjatë të gjitha orëve të marrin shënimë.

Mësimdhënësi në fillim u tregon punën/aktivitetin se si do zhvillohet në klasë.

Ndan nxënësit në dyshe dhe i pajis me nga një fletë A4 e cila është e strukturuar me një tabelë "Misioni" ku nxënësit duhet të plotësojnë hapësirat që të përmbushet misioni i tyre.

Në fletë vendoset identiteti i nxënësve, data dhe klasa.

Pjesa e dytë: Mësimdhënësi ndan nxënësit në dyshe dhe u jep atyre nga ½ të fletës A4 me detyrat e një misioni. Në fletë duhet të jetë e bashkangjitur edhe harta fiziko-gjeografike e Italisë në të cilën janë pozicionuar disa numra (pika) për identifikim.

Detyrë e tyre është që të identifikojnë vendet në hartë

Misioni	Përshkrimi
1- Vend (shteti)	
2- malet	
3- vend (shteti)	
4- vend (shteti)	
5- malet	

<p>6- vendi (shteti)</p> <p>7- Deti</p> <p>8- malet</p> <p>9- Lumi</p> <p>10- Kryeqyteti</p>	
<p>Detyrë:</p> <p>B. Madhe ka gjithsej 243.610km^2</p> <p>Popullsia 63.000.000 banorë</p> <p>Gjeni dendësinë mesatare?</p>	<p>VLERËSIMI I NXËNËSVE</p> <p>Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual). Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (nivel i lartë), pjesërish të saktë (nivel i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (nivel i ulët).</p>

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**No:59**Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedis** / Lënda: **Gjeografi**Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Evropa Perëndimore, veçoritë shoqërore ekonomike	Rezultati i të nxënësit të temës: <i>Analizon specifikat natyrore, popullative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngashmëritë dhe dallimet mes tyre.</i>
--	---

Rezultatet e të nxënësit për kompetencat kryesore të shkallës: ~~reshëno~~:Rezultatet e fushës së kurrikulës: *RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.2; 2.1.***ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: Franca

Fjalët kyçe: Republikë, Alpet, shamanja, alzasi, Pirinejet, turizmi, Deti Mesdhe, klima oceanike

Rezultati/et e të nxënësit për orë mësimore:

1. Përkufizon hapësirën e Francës dhe identifikon shtetet që kufizohen me të sipas anëve të horizontit.
2. Përshkruan regjionet e Francës sipas specifikave natyrore dhe shoqërore.
3. Arsyeton zhvillimin ekonomik të Francës.

Kriteret e suksesit (formohen në klasë së bashku me nxënës):

1. Tregon detet që lagin Francën;
2. Identifikon lumenjtë e Francës dhe tregon cilët qytete janë ngritur në këta lumenj;
3. Identifikon regjionet gjeografike të Francës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore: HISTORI

PËRSHKRIMI I METODOLOGjisë DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**Pjesa e parë: "Asociacion"**

Arsimtari formon një asociacion në tabelë si vegës që nxënësit të gjejnë njësinë që do zhvillohet dhe të pyesin për rubrikat se çka asocojnë.

A	B	C	D
Kapela	Xhelat	Shamanja	Bukë
FRANCA			

Nëse klasa është a pajisur me projektor dhe internet, identifikon elementet e asociacionit që nxënësit ti shohin se përfshirë bëhet fjalë. Ose formon sipas dëshirës një asociacion.

*Kapela- Kapelë franceze.**"Xhelat"- Nofka e Ekipit kombëtar të futbollit.**Shamanja – Regjion në Francë.**Kroasanti – Lloj buke (kifle) me origjinë nga Franca**Në fund mësimdhënësi i pyet se si do ta formonit ju një asociacion për Francën? Diskutim 2 min.*

Mësimdhënësi së bashku me nxënësit paraqesin kriteret në tabelë ose i sjell të gatshme dhe i shënon që nxënësit ti kenë përparrë të përshkruara.

Pjesa e dytë:

Nxënësit ndahen ne pese grupe, ku secili nxënës ka një numër 1,2,3,4

Pas nxënësit kanë përcaktuar numrat bashkohen njëhat bashkë, dyhat bashkë, treshat bashkë, katrat bashkë, pesat bashkë dhe kështu me radhë.

Mësimdhënësi iu jep secilit grup nga një detyrë të caktuar dhe punojnë duke u bërë ekspertë të çështjes për të cilën janë caktuar. Pjesën në fund të tekstit “Me rëndësi të dihet” e lexojnë të gjitha grupet.

Grupi 1

- Në sa dete ka dalje Franca. Cilët dete?
- Nga cili kanal ndahet nga Britania?
- Përshkruaj specifikat natyrore të Francës?
- Sa është sipërfaqja e Francës?
- Identifiko qytetet që janë ngritur në lumenjtë e Francës?

Grupi 2

- Për nga rregullimi shtetëror, çfarë shteti është Franca?
- Sa është dendësia mesatare e Francës?
- Cilët shtete të vogla gjinden në territorin francez?
- Tregoni disa ish koloni të Francës?

Grupi 3

- Sa është përqindja e popullsisë jetojnë në qytete?
- Me cilit lloje të industrisë shquhet Franca?
- Cilat resurset natyrore që shquhet Franca?
- Përmend disa monumente kulturo-historike të Parisit?


Grupi 4

- Cili është qyteti më i madh në Francë?
- Me cilit monumente dhe përmendore të famshme shquhet Parisi?
- Cilat qendra tjera të njohura industriale ndodhën në Francë?
- Regionet gjeografike të Francës?

Përfqaqësuesit e grupeve u përgjigjen pyetjeve dhe debatojnë lidhur me to.

Pjesa e tretë: Prezantim (reflektim) i punës në grupe.

pasi kryejnë detyrën në grupet e reja që janë krijuar me njëshat, dyshat treshat e kështu me radhë kthehen dhe riformohen përsëri grupet bazë në të cilët çdo nxënës ka një detyrë specifike të cilën do ta prezantojë. Të gjithë se bashku marrin pjesë me pyetje dhe komente duke e qartësuar problemin deri në fund dhe duke e përcjellë me hartë.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

DETÝRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: Punim për Franca vs Britaninë e Madhe.

Punimi në Power Point

Mësimdhënësi u jep nxënësve kriteret e shënuara (shtypura) në letër.

Kriteret nga gjeografia:

Pjesët e punimit: Pozita gjeografike, reliivi, klima, ujërat, ekonomia, popullsia.

Kriteret teknike:

deri në 7 slide. 1-3 foto më së shumti për slide. Titulli me font 48, teksti me font 20, bashkangjitur hartat dhe flamujt e shteteve.

Deri në 7 reshta shkrim. Të theksohen fjalët kyçë (BOLD).

Të paraqiten burimet të besueshme dhe edukative.

Artikulimi të jetë sipas standardit gjuhësor dhe rregull estetik.

Emrat e nxënësve që punuan.

Punimi:

Punimi në dyshe dhe të dorëzohet (data) pas një javë mësimore në email / googleclassroom.

Prezantimi sipas dëshirës së mësimdhënësit.

Kriteret duhet të bazohen në rezultatet e kompetencave që synohen të arrihen gjatë punimit.

I-5: Shkruan tekstu deri në 500 fjalë, sipas detyrës së dhënë, si: letër, kërkesë, ese etj., duke respektuar rregullat e organizimit/strukturimit të shkrimit dhe standardin gjuhësor.

I-6: Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

III-1: Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.

III-6 Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe jo shkollore në fusha të ndryshme të dijes.

IV-5 Përdor programet kompjuterike për përgatitjen e materialeve të nevojshme (si: grafikë, ilustrime të nevojshme, dizajnim të ftesave, pamfleteve, njoftimeve apo publikimeve të tjera) për nevoja të klasës dhe të shkollës.

IV-7 Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:60

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedisi** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Evropa Perëndimore, veçoritë shoqëroro ekonomike	Rezultati i të nxënëtit të temës: <i>Analizon specifikat natyrore, popullative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngashmëritë dhe dallimet mes tyre.</i>
--	--

Rezultatet e të nxënëtit përkompeticat kryesore të shkallës: **shëno:**

Rezultatet e fushës së kurrikulës: *RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvorjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.2; 2.1.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Prezantim - Franca dhe Britania e Madhe

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7, Llap topi, projektori.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/ apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore: HISTORI

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Prezantim i punimeve në dyshe, në Power Point.

Punimi duhet t'u përbahet kritereve që mësimdhënësi i ka paraqitur me detyrën, disa orë (dy javë) më herët.

Vlerësimi i punës

Për të nxjerrë notën vepojmë kështu (shembull):

$$3 \times 0.20 + 5 \times 0.20 + 4 \times 0.10 + 5 \times 0.30 + 3 \times 0.20 = 0.60 + 1 + 0.40 + 1.5 + 0.60 = 4.1 \text{ pra nota është 4}$$

Emri i nxënësit	Ilustrimet 20%	Burimet 20%	Artikulimi 10%	Shpjegim 30%	Bashkëpunimi 20%	Nota
1	3	5	4	5	3	4
2						
3						
4						

Mësimdhënësi mund të formojë një instrument sipas kritereve të veta ose t'i paraqesë kriteret së bashku me nxënësit.

Instrumenti 3 - Prezantim me gojë (30%). Nxënësi vlerësohet sipas standardeve të vlerësimit, të përshkruara në: UA, Kurrikulen bërthamë dhe Udhëzuesin për vlerësim.

Nota 5. Nxënësi i cili bashkëbisedon me arsimtarin dhe ofron fakte, argumente dhe e analizon detyrën para se të përgjigjet. Ka shprehje të rrjedhshme dhe logjike. Bashkëbisedimin e përcjell me gjestikulacion për eksplikim të rasteve. Oftron faktet gjeografike, njeh objektet gjeografike; shpjegon dukuritë dhe proceset gjeografike si dhe raportet që janë në lidhshmëri me njësitet e përpunuara hapësinore; analizon lidhshmëritë dhe ligjshmëritë gjeografike që shprehen dhe veprojnë brenda këtyre njësive; paraqet aftësitetë, shkathtësitetë e shprehitë, të dinë të shërbehen me to dhe të përvetësojnë mënyrën e të menduarit gjeografik.

Nota 4. Nxënësi i cili bashkëbisedon me arsimtarin, ofron fakte dhe e analizon detyrën para se të përgjigjet. Ka shprehje të rrjedhshme dhe logjike, me ngecje në informacion. Bashkëbisedimin e përcjell me gjestikulacion për eksplikim të rasteve, jo në formë shumë të saktë. Oftron faktet gjeografike, njeh objektet gjeografike; shpjegon dukuritë dhe proceset gjeografike si dhe raportet që janë në lidhshmëri me njësitet e përpunuara hapësinore; analizon lidhshmëritë dhe ligjshmëritë gjeografike që shprehen dhe veprojnë brenda këtyre njësive; paraqet aftësitetë, shkathtësitetë e shprehitë, të dinë të shërbehen me to dhe të përvetësojnë mënyrën e të menduarit gjeografik jo shumë të saktë.

Nota 3. Nxënësi i përgjigjet pyetjeve të arsimtarit, por jo mjaftueshmë. Ka shprehje të rrjedhshme dhe deri diku të logjikshme, me ngecje në informacion. Bashkëbisedimin e përcjell më me ngecje nga mungesa e leximit të

mjaftueshëm. Ofron faktet gjeografike, njeh disa objekte gjeografike; shpjegon dukuritë dhe proceset gjeografike (ato që i di) si dhe raportet që janë në lidhshmëri me njësitë e përpunuara hapësinore; Paraqet aftësitë, shkathtësitë e shprehitë, të dinë të shërbehen me to.

Nota 2. Nxënësi mundohet të bisedojë, ofron fakte gjatë bisedës, por shumë pak. Vërehet mungesa e leximit, nuk i plotëson as 30% të kritereve të lartpërmendura.

Nota 1. Nxënësi nuk u përgjigjet pyetjeve, nuk bashkëbisedon. Nuk i plotëson kriteret e lartpërmendura as 20%.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:61

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedis / Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 / Klasa: 7

Tema: Evropa Perëndimore, veçoritë shoqëroro ekonomike

Rezultati i të nxënëtit të temës: Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngashmëritë dhe dallimet mes tyre.

Rezultatet e të nxënëtit për kompetencat kryesore të shkallës: ~~reshëno~~:

Rezultatet e fushës së kurrikulës: RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvanjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.2; 2.1.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Monako

Fjalët kyçe: Principatë, turizmi, Mente Karlo, popullsi franceze

Rezultati/et e të nxënëtit për orë mësimore:

- Identifikon në hartën e punës principatën e Monakos dhe shpjegon pozitën gjeografike të vendit;
- Veçon tri faktet numerike (gjeografike) për hapësirën dhe popullsinë e Monakos.

Kriteret e suksesisit:

- Identifikon në hartën e punës principatën e Monakos;
- Tregon me cilin shtet kufizohet;
- Tregon faktet numerike për Monakon.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore:


PËRSHKRIMI I METODOLOGISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Përshkrim i fakteve (punë individuale).

Pjesa e parë realizohet në formën diskutimit sipas të dhënave nga atlastet. Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit të gjejnë në listë shtetin e Monakos dhe të shprehin faktet dhe statistikat për shtetin e vogël. Të njëjtat së bashku me komentet/fjalë kyçe më të logikshme shënohen në tabelë.

Çfarë dini për Monakon?

Sipërfaqja: 1,9 km²
Popullsia: 36.3 mijë
Kryeqyteti: Monako



Pjesa e dytë: Lexohet paragrafi i parë. Kur nxënësit ta përfundojnë leximin e këtij paragrafi mbyllin tekstin.

- Pas këtij leximi, nxënësve u shtrohen pyetjet varësisht nga natyra e përbajtjes:

Cila është pozita gjeografike e Monakos?

Çfarë shteti është Monako?

Kush është kryeqyteti?

Në cilën pjesë të Francës ndodhet dhe në cilin det ka dalje?


- Gjatë diskutimit, komentet më të logjikshme shënohen në tabelë/*flipchart* dhe të shpjegohet me hartë.
- Hapa të njëjtë merren edhe tek leximi i pjesës 2,3... etj. Para leximit të fundit shtohet edhe pyetja:
Çfarë mendoni, a keni ndryshuar mendje nga përgjigjet e parë?

Pjesa e tretë: Plotësim i fletore punës (punë individuale).

Ushtrime me hartën e Evropës Perëndimore dhe plotësim i Fletore pune 161-171

Identifikoni lumenjtë që kalojnë në qendrat më të njoitura të Evropës Perëndimore dhe plotëso hartën duke u përgjigjur numrave.

Me që njësia është e shkurtër, mësimdhënësi mund ta përdor edhe për plotësimin/kontrollimin e detyrave ose dosjeve dhe si përforcim.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:62

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedis** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Evropa Perëndimore, veçoritë shoqëroro ekonomike	Rezultati i të nxënësit të temës: <i>-Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur njashmëritë dhe dallimet mes tyre.</i>
--	--

Rezultatet e të nxënësit përkompitet kryesore të shkallës: **shëno:**

Rezultatet e fushës së kurrikulës: *RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvorjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.2; 2.1.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Belgjika

Fjalët kyçë: Valonët, flamanët, shtete të BENELUKSIT, Flandria, "Anglia e zezë" Brukseli

Rezultati/et e të nxënësit për orë mësimore:

1. Vlerëson pozitën gjeografike të Belgikës dhe rolin e saj në zhvillimin e vendeve;
2. Analizon veçoritë natyrore të Belgikës dhe shpjegon ndikimin e tyre në zhvillimin demografik;
3. Përshkruan strukturën etnike të Belgikës.

Kriteret e suksesit:

1. Identifikon popujt që jetojnë në Belgjikë;
2. Identifikon resurset minerale që shquhet Belgjika;
3. Tregon në hartë qendrat më të mëdha të Belgikës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndër kurrikulare dhe situata jetësore: HISTORI

PËRSHKRIMI I METODOLOGISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Përshkrim i faktave (punë individuale).

Pjesa e parë realizohet në formën diskutimit sipas të dhënavë nga atletat. Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit të gjejnë në listë shtetin e Monakos dhe të shprehin faktet dhe statistikat për shtetin e vogël. Të njëjtat së bashku me komentet/fjalë kyçë më të logjikshme shënohen në tabelë.

Çfarë dini për Monakon?

Mësimdhënësi së bashku me nxënësit paraqesin kriteret në tabelë ose i sjell të gatshme dhe i shënon që nxënësit ti kenë përpara të përshkruara.



Sipërfaqja: 30.510 km²

Popullsia: 10.8 milionë

Kryeqyteti: Brukseli



Pjesa e dytë: Pyetje dhe komente (punë individuale).

Arsimtari udhëzón nxënësit që të lexojnë tekstin në heshtje dhe individualisht.

Deri sa nxënësit lexojnë, arsimtari shënon në tabelë disa pyetje ku nxënësit pas leximit i plotësojnë me ato fragmente që mendojnë se e plotësojnë pyetjen e parashtruar.

Pjetje	Komente (fragmente nga teksti)
1. Sa është sipërfaqja e Belgikës?	
2. Me cilat shtete kufizohet Belgjika?	



3. Cilat janë qendrat më të njohura në Belgjikë?	
4. Çka është Beneluksi dhe kur është krijuar ai?	
5. Çfarë male janë Ardenet dhe ku shtrihen ato?	
6. Cilat janë gjuhët zyrtare në Belgjikë?	
7. Cili është porti më i madh i Belgjikës?	

Pjesa e tretë: Plotësim i hartës në fletore pune (punë individuale).

Gjej dhe shëno në hartën memece të Belgjikës:

- a) Kryeqytetin e Belgjikës
- b) Shtetet me të cilat kufizohet
- c) Malet Ardene

Shpjego hartën:



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No:63

Fusha kurrikulare: **Shoqëria dhe mjedis** / Lënda: **Gjeografi**

Shkalla e kurrikulës: **3** / Klasa: **7**

Tema: Evropa Perëndimore, veçoritë shoqëroro ekonomike

Rezultati i të nxënësit të temës: *Analizon specifikat natyrore, popullative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngashmërëtë dhe dallimet mes tyre.*

Rezultatet e të nxënësit për kompetencat kryesore të shkallës: **shëno:**

